



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në Entin Rregullator të Ujit

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

MBI

AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË

Tiranë, prill 2026

NR.	Përmbajtja	Faqe
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4-9
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe Rekomandimeve	6-7
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	8-9
II	HYRJA	10-13
1	Objektivat dhe qëllimi	10
2	Identifikimi i çështjes	10
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	10
4	Përgjegjësitë e audituesve	11-12
5	Kriteret e vlerësimit	12
6	Standardet e auditimit	12
7	Metodat e auditimit	12-13
8	Dokumentimi i auditimit	13
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	14-88
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	12
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	14
2.1	Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe Njesisë së Auditit të Brendshëm.	14-21
2.2	Hartimi dhe zbatimi i programit ekonomik - financiar.	22-33
2.3	Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.	34-37
2.4.	Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave	38-42
2.5	Mbi përputhshmërinë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen e zbatimit e kontratave.	43-53
2.6	Të tjera, që lidhen me vlerësimin e rregullshmërisë në nxjerrjen e akteve të brendshme rregullatore, që i shërbejnë kryerjes së veprimtarisë së ERRU, si dhe çështje që mund të dalin gjatë auditimit.	54-76
IV	REKOMANDIMIE	77-87

Lista e shkurtimeve

ERRU	Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura
UK	Ujësjetllës Kanalizime
UKR	Ujësjetllës Kanalizime Rajonale
KKRR	Komisioni Kombëtar Rregullator
KVPTM	Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
KM	Këshilli i Ministrave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
SHA	Shoqëri Aksionere
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
AKUK	Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve
IËA	Shoqata Ndërkombëtare e Ujit
SHUKALB	Shoqata Ujësjetllës Kanalizime e Shqipërisë
TKP	Treguesit Kryesorë të Performancës
ITUN	Implant i Trajtimin të Ujërave të Ndotura
O&M	Kosto Operative dhe Mirëmbajtjeje
ISHSH	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor
UPA	Uji Pa të Ardhura

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit:

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1052/1 prot., datë 03.11.2025, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 03.11.2025 deri në datën 29.11.2025, në subjektin “Enti Rregullator i Ujit”, (në vijim ERRU), u krye auditimi i Përputhshmërisë për periudhën e auditimit nga data 01.01.2024 deri më datë 31.10.2025.

Enti Rregullator i Ujit (ERRU) është një institucion publik i pavarur në Shqipëri, krijuar me Ligjin nr.8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", me qëllim rregullimin e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve.

Misioni i tij është të garantojë dhe të mbrojë interesat publike, duke krijuar një mjedis rregullator të qartë, transparent dhe të qëndrueshëm.

ERRU ushtron një sërë funksionesh dhe kompetencash për të siguruar një shërbim cilësor dhe të besueshëm për qytetarët:

- Licensimi i operatorëve: Jepen leje për persona fizikë ose juridikë që ofrojnë shërbime ujësjellës-kanalizime për përfitim publik.

- Sigurimi i cilësisë së shërbimit: Monitorohen operatorët që të ofrojnë shërbime efikase dhe me çmime të arsyeshme për konsumatorët.

- Përcaktimi i tarifave: Tarifat vendosen në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria financiare e operatorëve dhe përballueshmëria nga klientët.

- Mbikëqyrja e performancës: Analizohet performanca e operatorëve dhe vendosen objektiva efikas për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve.

- Mbrotja e interesit publik dhe mjedisit: Sigurohet që operatorët të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme ndaj konsumatorëve dhe mjedisit.

- Trajtimi i ankesave të konsumatorëve: Konsumatorët mbështeten në zgjidhjen e problemeve me operatorët.

- Pjesëmarrja në politikë bërje: ERRU jep komentet e saj në proceset e rëndësishme të sektorit, përfshirë strategjitë, politikat dhe legjislacionin kombëtar.

- Publikimi i informacionit: Hartohen raporte të rregullta mbi sektorin, si raportet vjetore dhe të performancës, të cilat janë të disponueshme për të gjithë aktorët dhe publikun.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.

Rëndësia e auditimit të përputhshmërisë të ERRU për periudhën e aktivitetit 2024 - Tetor 2025, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore të cilat janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien, në funksion të rritjes së performancës së performancën e sektorit të ujit.

c. Qëllimi i auditimit

Në kuadër të auditimit të përputhshmërisë mbi aktivitetin e ERRU brenda periudhës së auditimit qëllimi i auditimit është të vlerësohet shkalla në të cilën subjekti i audituar ka zbatuar ligjet, rregulloret, politikat dhe kushtet kontraktuale që rregullojnë veprimtarinë e tij, përdorimin e burimeve dhe respektimin e kuadrit ligjor, duke u mbështetur në analizën e praktikave të menaxhimit financiar dhe të sistemeve të kontrollit të brendshëm, me qëllim identifikimin dhe vlerësimin e nivelit të riskut në subjekt.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit, e cila shërben për kryerjen e auditimit me eficiencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku.

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin¹. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerësojnë si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

e. Numri i gjetjeve dhe Rekomandimeve.

Grupi i auditimit ka rezultuar në 18 (tetëmbëdhjetë) gjetje dhe ka dhënë 19 (nëntëmbëdhjetë) rekomandime, të cilat klasifikohen në 17 masa organizative dhe 1 (një) masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike si dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.

1. Nga auditimi i praktikave të miratimit të tarifave rezultoi se niveli i lartë i Ujit Pa të Ardhura (UPA), i cilësuar në disa raste si “i papranueshëm”, mbetet problem strukturor që nuk trajtohet me masa detyruese proporcionalisht me peshën e tij në kosto dhe në padrejtësinë ekonomike ndaj konsumatorit korrekt, duke krijuar rrezikun që tarifa të përdoret si instrument mbulimi i pasojave të joeficiencës dhe jo si instrument reformues. Kjo problematikë evidentohet veçanërisht në UK Rajonale Lezhë (UPA rreth 74.14%), UK Rajonale Shkodër (UPA rreth 67.01%), UK Rajonale Fier (UPA rreth 69.59%), si edhe në raste të tjera me humbje të larta, ku tarifa rritet pa u shoqëruar me kushte të forta zbatimi për reduktimin real të humbjeve, eliminimin e lidhjeve të paligjshme, reduktimin e nënfaturimit dhe ndërhyrjet në rrjete. Veprime në mospërputhje me nenet 13, 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539 datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime”.

2. Nga auditimi rezultoi se monitorimi i kushteve të licencës nuk dokumentohet në mënyrë sistematike dhe mungon lidhja e qartë ndërmjet raporteve periodike të operatorëve dhe vlerësimit formal të përmbushjes së kushteve të licencës, duke e bërë licencën më shumë akt formal sesa instrument rregullator i lidhur me performancën.

Veprime në mospërputhje me ligjin nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, VKM nr. 958, datë 06.05.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”, si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar.

3. Nga auditimi rezultoi se Enti Rregullator i Ujit nuk ka ushtruar kompetencën dhe detyrimin ligjor për kryerjen e kontrolleve/inspektimeve të kushteve të licencës, çka dobëson përdorimin e licencës si instrument rregullator me qëllim nxitjen apo dhe kushtëzimin e përmirësimit të performancës së operatorëve. Veprime në mospërputhje me ligjin nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, VKM nr. 958, datë 06.05.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”, si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave

¹ ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar.

4. Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare, rezultoi se gjatë periudhës objekt auditimi, personat e autorizuar të ERRU kanë tërhequr dhe depozituar në arkën e institucionit mjete monetare në Lekë, Euro dhe USD, për paradhënie dhe pagesa cash për dieta dhe shpenzime transporti, brenda dhe jashtë vendit.

Konkretisht, u evidentuan 6 raste me 1,402,468 lekë, 12 raste me 24,458 euro dhe 3 raste me 1,565 USD. Nga shqyrtimi i ditarit të bankës dhe dokumentacionit të arkës rezultoi se gjendja cash nuk është depozituar në llogaritë bankare të ERRU pas realizimit të transaksioneve, por është mbajtur në arkë si gjendje e akumuluar. Nuk është respektuar limiti ditor dhe javor i arkës. Gjithashtu, ERRU nuk ka hartuar dhe miratuar rregullore të brendshme që përcaktojnë rregullat për administrimin, ruajtjen dhe sigurinë fizike të mjeteve monetare. Pagesat për dieta dhe transport brenda vendit janë kryer jashtë sistemit bankar. Këto veprime lidhen me mungesën e një sistemi të formalizuar për administrimin e arkës, duke përfshirë rregulloret për dokumentimin, ruajtjen dhe kontrollin e mjeteve monetare.

Si pasojë, veprimet e konstatuara rrisin rrezikun e përdorimit joefektiv dhe të pasigurt të fondeve të institucionit, duke cenuar transparencën, kontrollin dhe sigurinë e mjeteve monetare, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, dhe rregullat për administrimin e arkës në institucionet publike.

5. Nga auditimi i procedurave të prokurimit të përzgjedhura mbi bazë risku, rezultoi se në 6 procedura me vlerë të vogël, autoriteti kontraktor ERRU nuk ka respektuar kërkesat ligjore dhe nënligjore lidhur me llogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike, përbërjen e komisioneve, si dhe administrimin dhe dokumentimin e procesit të marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, të paraqitura si më poshtë

- *Për procedurat e prokurimit "Materiale Pastrimi" (2024) dhe "Kancelari" (2025).*

Nga auditimi i procedurës "Materiale Pastrimi" për vitin 2024, me OE fitues XH... dhe vlerë oferte 197,000 lekë, si dhe i procedurës "Kancelari" për vitin 2025, me OE fitues L.D dhe vlerë oferte 135,000 lekë, rezultoi se:

Në komisionin e marrjes në dorëzim nuk është përfshirë punonjësi me përgjegjësi materiale, në kundërshtim me pikën 43 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Gjithashtu, mungon fleta e hyrjes së mallrave e nënshkruar nga përgjegjësi material.

- *Për Procedurën "Pajisje kompjuterike" (2024) dhe "Blerje pajisje informatike (monitorë dhe njësi qendrore)" – 2024.*

Për procedurat e prokurimit "Pajisje kompjuterike" (viti 2024) dhe "Blerje pajisje informatike (monitorë dhe njësi qendrore)" (viti 2024):

Nga auditimi i procedurës së prokurimit "Pajisje kompjuterike" për vitin 2024, me operator ekonomik fitues "I.S.T" në vlerën 511,380.00 lekë, si dhe i procedurës "Blerje pajisje informatike (monitorë dhe njësi qendrore)" për vitin 2024, me operator ekonomik fitues "G.." në vlerën 139,000 lekë, u konstatua se:

Kërkesat për këto pajisje dhe specifikimet teknike nuk janë hartuar nga një specialist i fushës së IT-së. Ofertat e siguruara në kuadër të studimit të tregut janë marrë në mungesë të specifikimeve teknike të mirëpërcaktuara. Gjithashtu, për këto procedura, KBVV nuk i është referuar burimeve/udhëzimeve të AKSHI-t lidhur me çmimet dhe specifikimet teknike për pajisjet informatike.

Në vijim, u konstatua se procesverbalet e marrjes në dorëzim nuk pasqyrojnë verifikimin e plotë të specifikimeve teknike, si marka, lloji dhe brendi i pajisjeve.

- *Për Procedurën "Licenca software për server":*

Për këtë procedurë, nga K.B.V.V. është shpallur fitues operatori ekonomik “A.I” në vlerën 720,000 lekë. Nga auditimi rezultoi se:

Në përbërje të K.B.V.V.-së nuk është përfshirë specialist i fushës së IT-së, në kundërshtim me nenin 74, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Gjithashtu, mungon argumentimi për vendosjen e kriterëve të kualifikimit për operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Ofertat e operatorëve ekonomikë, të përdorura për përlllogaritjen e fondit limit, nuk përcaktojnë versionin e “Windows Server” për të cilin do të realizohet përditësimi me licencën përkatëse, çka tregon se oferta financiare është hartuar në mungesë të specifikimeve teknike të qarta.

Në lidhje me plotësimin e kriterëve të veçanta, rezulton se diploma e z. D.T është në fushën e inxhinierisë elektronike dhe komunikimit dixhital dhe jo në fushën e IT-së, në kundërshtim me kërkesat e autoritetit kontraktor të përcaktuara në ftesën për ofertë. Po ashtu, nuk plotësohet kriteri për disponimin e gjithsej 4 specialistëve IT, pasi në dokumentacionin e paraqitur dhe atë të ngarkuar në SEP evidentohen vetëm 2 specialistë IT, ku njëri prej tyre, sipas auditimit, nuk përmbush kriterin e kërkuar në bazë të diplomës bachelor dhe master.

Në këto kushte, operatori ekonomik “A.I” duhej të ishte skualifikuar nga K.B.V.V. për mosplotësim të kriterëve të veçanta të përcaktuara në ftesën për ofertë.

- *Për procedurën “Materiale Pastrimi” (2025)*

Për këtë procedurë, nga K.B.V.V. është shpallur fitues operatori ekonomik “E.D.D” në vlerën prej 155,100 lekë. Nga auditimi rezultoi se:

Autoriteti kontraktor, në ftesën për ofertë, ka kërkuar cilësi të lartë të produkteve, por pa përcaktuar kriterë të veçanta dhe pa kërkuar paraqitjen e dokumenteve provuese për garantimin e cilësisë (certifikata cilësie), duke krijuar paqartësi në procesin e vlerësimit të ofertave.

Gjithashtu, në përbërje të komisionit të marrjes në dorëzim nuk është përfshirë punonjësi me përgjegjësi materiale, në kundërshtim me pikën 43 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Në vijim, konstatohet se mungon fleta e hyrjes së mallrave e nënshkruar nga punonjësi me përgjegjësi materiale.

6. Nga auditimi zbatimit të dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, në lidhje me dokumentacionin shoqërues dhe praktikës së pagesës së dietave brenda vendit rezultoi se:

Në të gjitha urdhërat e pagesës për stafin e ERRU, që kanë përfituar trajtim financiar për shërbime jashtë qendrës së punës brenda vendit, mungonte autorizimi përkatës i titullarit të institucionit, ku duhej të përcaktohej koha e zgjatjes së shërbimit dhe qëllimi i tij.

Ky veprim është në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar, pika V, germa a.ii). Gjithashtu, sipas Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 12, pika 3. Në rastin konkret, nëpunësit zbatues kanë pranuar dhe urdhëruar pagesat pa dokumentacion të plotë dhe të autorizuar sipas VKM nr. 997, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar.

Vlera totale 1,374,655 lekë përbën përdorim të fondeve të ERRU pa efektivitet, duke mos respektuar parimet e përdorimit me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike.

h. Paraqitja e Rekomandimeve kryesore:

1 Enti Rregullator i Ujit të marrë masa që, në vendimmarrjet tarifore për operatorët me treguesin Uji Pa të Ardhura (UPA) të lartë, të vendosë kushte të detyrueshme performance (jo vetëm objektiva deklarative), të shoqëruara me plan veprimi të verifikueshëm dhe monitorim periodik, duke përcaktuar qartë indikatorët, afatet, provat që operatori duhet të dorëzojë, si dhe pasojat rregullatore në rast mospërmbushjeje .

2. Enti Rregullator i Ujit të marrë masa që të krijojë dhe të zbatojë një mekanizëm monitorimi të dokumentuar me regjistër të kushteve të licencës, raportime periodike, vlerësime vjetore të përputhshmërisë dhe vendimmarrje korrigjuese, ku gjetjet e monitorimit të shoqërohen me veprime konkrete rregullatore brenda kompetencave.
3. Enti Rregullator i Ujit të marrë masa që të planifikojë e dokumentojë kontrolle/inspektime periodike për verifikimin e kushteve të licencës, duke krijuar lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet gjetjeve të monitorimit/inspektimit dhe vendimmarrjeve rregullatore (kushtëzime, masa administrative, ose rishikime të kushteve), me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë dhe efektivitetit rregullator.
4. Komisioni Kombëtar Rregullator, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Enti Rregullator i Ujit, të hartojë dhe miratojë një rregullore të veçantë për administrimin e vlerave monetare, ku të përcaktohen qartë mënyra e kryerjes së pagesave nga arka e institucionit, limitet e mbajtjes së vlerave monetare cash dhe masat për ruajtjen dhe sigurinë fizike të tyre.
5. Titullari i Institucionit të Entit Rregullator të Ujit, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, të rishikojë dhe të standardizojë procedurat e brendshme të planifikimit të nevojave dhe të zhvillimit të procedurave të prokurimit, duke siguruar që kërkesat për blerje të inicohen nga strukturat përkatëse dhe specialistët e fushës, specifikimet teknike të hartohen në mënyrë të plotë, të argumentuar dhe në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore në fushën e prokurimeve publike, studimi i tregut të kryhet mbi oferta të bazuara në specifikime teknike të miratuara.
6. Titullari i ERRU, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, të sigurojë që çdo praktikë shërbimi dhe pagesë përkatëse të mbështetet në dokumentacion të plotë dhe të rregullt ligjor, përfshirë autorizimin e titullarit, programin e punës të miratuar paraprakisht, duke realizuar pagesat për dieta dhe transport brenda vendit vetëm në llogaritë bankare të personave përfutues përkatës, si dhe të analizojë shkaqet dhe të nxjerrë përgjegjësitë për përdorimin pa efektivitet dhe pa efikasitet të fondeve publike në shumën 1,374,655 lekë.

1.1. Konkluzionidhe Opinioni i auditimit.

Opinion për auditimin e përputhshmërisë (i kualifikuar)

Mbështetur në, ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit Enti Rregullator i Ujit me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Entit Rregullator të Ujit, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar² të përputhshmërisë”.

Baza për opinionin e përputhshmërisë.

Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për përgatitjen e opinionit të kualifikuar.

Raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuar janë si më poshtë:

-Nga auditimi i praktikave të miratimit të tarifave rezultoi se, shoqëritë ujësjellës-kanalizime paraqesin nivele të larta të treguesit të performancës “Uji Pa të Ardhura” (UPA), i cili vijon të

² **Opinion i modifikuar/ kualifikuar:** Referuar Manualit të Përputhshmërisë të KLSH-së (vendim nr. 24, datë 29.12.2022 fq.104) Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura”.

mbetet një problem i rëndësishëm dhe nuk po trajtohet me masa konkrete dhe detyruese në përpjesëtim me ndikimin që ka në rritjen e kostove ndaj konsumatorëve të rregulltë në pagesa. Në këto kushte, rritja e tarifave më së shumti përdoret për të mbuluar pasojat e mosmenaxhimit dhe joeficiencës së këtyre shoqërive, dhe jo si një instrument për përmirësimin e performancës së tyre. Kjo situatë konstatohet në disa shoqëri rajonale, si UK Rajonale Lezhë (UPA rreth 74.14%), UK Rajonale Shkodër (UPA rreth 67.01%) dhe UK Rajonale Fier (UPA rreth 69.59%), ku kërkesa për rritjen e tarifave nuk është shoqëruar me masa të qarta, të matshme dhe detyruese për uljen e humbjeve në rrjet, eliminimin e lidhjeve të paligjshme, përmirësimin e procesit të faturimit dhe realizimin e investimeve në infrastrukturë.

- Nga auditimi i proceseve të licencimit/rinovimit të licencave, rezultoi se arsyetimi mbi aftësitë tekniko-profesionale, kapacitetin financiar, përvojën dhe mbrojtjen e konsumatorëve është kryesisht deklarativ dhe nuk shoqërohet me tregues të qartë të sintetizuar apo dokumente të verifikueshme, të cilat do të mundësonin testimin dhe kontrollin e vendimeve të marra.

Problematika u evidentua në rastet e licencimit/rinovimit të UK Korçë, licencimit të UK Vlorë dhe rinovimit të UK Vorë, ku konstatohet paqartësi në terminologjinë “licencim” kundrejt “rinovim”, mungesë e vlerësimit të performancës historike për rinovimet, mungesë konkretizimi të “aftësisë financiare” së operatorëve, si dhe standard i pa-balancuar i verifikimit të drejtuesve, ku drejtuesi ligjor figuron vetëm nominalisht, pa vërtetim real të kompetencave. Nga auditimi rezultoi se procesi i licencimit dhe rinovimit të licencave nuk është i mjaftueshëm i dokumentuar dhe i verifikueshëm, duke krijuar rrezikun që vendimet të bazohen më shumë në deklarata sesa në prova konkrete të aftësive dhe performancës së shoqërive.

- Nga auditimi rezultoi se Enti Rregullator i Ujit nuk ka ushtruar kompetencën dhe detyrimin ligjor për të kryer kontrollet dhe inspektimet e nevojshme mbi kushtet e licencës. Kjo praktikë dobëson funksionin e licencës si instrument rregullator, i cili ka për qëllim nxitjen dhe kushtëzimin e përmirësimit të performancës së operatorëve të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve.

-Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël rezultoi se, nuk janë respektuar kërkesat ligjore dhe nënligjore lidhur me planifikimin, hartimin e specifikimeve teknike, përbërjen e komisioneve, studimin e tregut, si dhe administrimin dhe dokumentimin e procesit të marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve.

- Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare, rezultoi se gjatë periudhës së objektit të auditimit, personat e autorizuar të ERRU kanë tërhequr dhe depozituar në arkën e institucionit mjete monetare në Lekë, Euro dhe USD, për paradhënie dhe për kryerjen e pagesave cash për dieta dhe shpenzime transporti, brenda dhe jashtë vendit. Konkretisht, u evidentuan 6 raste me 1,402,468 lekë, 12 raste me 24,458 euro dhe 3 raste me 1,565 USD.

Nga shqyrtimi i ditarit të bankës dhe dokumentacionit të arkës rezultoi se gjendja cash nuk është depozituar në llogaritë bankare të ERRU pas realizimit të transaksioneve, por është mbajtur në arkë si gjendje e akumuluar. Nuk është respektuar limiti ditor dhe javor i arkës, dhe ERRU nuk ka hartuar dhe miratuar rregullore të brendshme që përcaktojnë rregullat për administrimin, ruajtjen dhe sigurinë fizike të mjeteve monetare.

- Nga auditimi rezultoi se pagesat për dietat e stafit të ERRU brenda vendit janë kryer pa autorizimin e titullarit të institucionit dhe pa dokumentacion të plotë sipas dispozitave ligjore në fuqi. Vlera totale prej 1,374,655 lekë përbën përdorim të fondeve pa efektivitet, duke shkelur parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit të fondeve publike.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1052/1 prot., datë 03.11.2025, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 03.11.2025 deri në datën 29.11.2025, në subjektin “Enti Rregullator i Ujit”, (në vijim ERRU), u krye auditimi i Përputhshmërisë për periudhën e auditimit nga data 01.01.2024 deri më datë 31.10.2025.

Auditimi u krye nga:

1. A.L, përgjegjës grupi
2. O.L, auditues
3. K.P, auditues

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti dhe qëllimi i auditimit:

Objekti i auditimit të përputhshmërisë synon të vlerësojë shkallën në të cilën subjekti i audituar ka zbatuar ligjet, rregulloret, politikat, kushtet kontraktuale që rregullojnë veprimtarinë e tij, duke synuar të ofrojë një vlerësim mbi përdorimin e burimeve dhe respektimin e kuadrit ligjor, duke u mbështetur në analizën e praktikave të menaxhimit financiar dhe të sistemeve të kontrollit të brendshëm, me qëllim identifikimin dhe vlerësimin e nivelit të riskut në subjekt.

2. Identifikimi i çështjes:

Auditimi i përputhshmërisë në Entin Rregullator të Ujit (ERRU) ka për qëllim të vlerësojë nëse aktivitetet dhe funksionet e institucionit janë në përputhje me kuadrin ligjor, rregulloret dhe politikat e miratuara. Ky auditim përfshin vlerësimin e fushave kryesore si: Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli i Brendshëm: duke shqyrtuar strukturat dhe procedurat për të garantuar përdorimin ekonomik, eficient dhe efektiv të burimeve financiare publike; Planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, Prokurimet publike, si dhe trajtimi i ankesave të qytetarëve dhe të gjitha proceset e tjera që ndikojnë në ofrimin e shërbimeve ndaj komunitetit.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

Struktura drejtuese e ERRU, është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara, si dhe rregullimin e sektorit ujësjellës kanalizime për të siguruar garantimin dhe mbrojtjen e interesave publike dhe për të krijuar një mjedis rregullator transparent

4. Përgjegjësitë e audituesve:

Objekti i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurtisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një konkluzion dhe/ose opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij; Audituesit në të gjithë llojet e auditimit, kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik", paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit:

Ligji nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për Kuadrin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura”, i ndryshuar;

Ligji nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”;

Ligji nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për Pagat, Shpërblimet dhe Strukturat e Institucioneve të Pavaruara dhe Institucioneve të tjera Kushtetuese”, i ndryshuar;
Ligji nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”, i ndryshuar;
VKM nr. 958, datë 06.05.2009 “Për Miratimin e Kategorive të Licencave dhe të Proçedurave të Aplikimit për Licencë të Personave Fizikë dhe Juridikë, që ushtrojnë Veprimtari në Sistemet e Furnizimit me Ujë dhe të Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura”;
VKM nr. 73, datë 7.2.2018 “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, 2018 – 2027”;
Vendim nr. 326, datë 29.5.2024 “Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2024–2030”;
Rregullore e Licencimit ” Për Procedurat e Dhënies dhe Rinovimit të Licencave Profesionale për Subjektet Juridike e Fizike që ushtrojnë Veprimtari në Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura”, miratuar me vendim të KKRR Nr. 29, datë 08.12.2009, e ndryshuar;
Kodi i Integritetit të Entit Rregullator të Ujit miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendim nr. 18 datë 04.07.2012;
Kushtet e Licencës, miratuar me vendimin nr. 50, datë 30.12.2013 të KKRR;
Rregullore e Inspektimit dhe Monitorimit të Veprimtarisë së Ofruesve të Shërbimit në Sektorin Ujësjellës Kanalizime (UK), miratuar me vendim të KKRR Nr. 58 datë 29.12.2017;
Akte të tjera ligjore apo nënligjore që do të jenë të nevojshme gjatë auditimit;

6. Standardet e auditimit:

ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”,
NTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm”;
ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”, si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”;

7. Metodatat e auditimit:

Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin³. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerësojnë si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- Kontrolli aritmetik. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes

³ ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

- Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- Kontrolli i vlerësimit. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- Konfirmim nga të tretët. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- Kontrolli sipas një treguesi. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- Verifikimi i transaksioneve, është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- Intervistimi - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- Raporte dhe informacione - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

- Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm.

8. Dokumentimi i auditimit:

Mbi bazën e pyetësorëve dhe testeve përkatëse të miratuara në manualët e auditimit të përputhshmërisë, audituesit përgatitën dokumentacionin përkatës të auditimit, të mjaftueshëm për të mundësuar kuptimin e natyrës, kohës dhe shtrirjes së procedurave të kryera, në përputhje me standardet përkatëse si dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi.

Në vijim të këtyre procedurave dhe bazuar në evidencat e mbledhura, u hartuan Akt-Konstatimet. Pas shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i audituar, u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Opinioni i Auditimit.

Rezultatet e procedurave të zbatuara, evidencat e mbledhura dhe çështjet e tjera me rëndësi të identifikuar gjatë procesit të auditimit janë reflektuar në përfundimet përkatëse, të cilat janë nxjerrë përmes gjykimit dhe skepticizmit profesional të ushtruar nga audituesit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm:

Në subjektin “Enti Rregullator i Ujit”, (në vijim ERRU), u krye auditimi i Përputhshmërisë për periudhën nga data 01.01.2024 deri më datë 31.10.2025.

ERRU është një institucion publik i pavarur në Shqipëri, krijuar me ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996, me qëllim rregullimin e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve. Misioni i tij është të garantojë dhe të mbrojë interesat publike, duke krijuar një mjedis rregullator të qartë, transparent dhe të qëndrueshëm.

ERRU ushtron një sërë funksionesh dhe kompetencash për të siguruar një shërbim cilësor dhe të besueshëm për qytetarët:

- Licensimi i operatorëve: Jepen leje për persona fizikë ose juridikë që ofrojnë shërbime ujësjellës-kanalizime për përfitim publik.
- Sigurimi i cilësisë së shërbimit: Monitorohen operatorët që të ofrojnë shërbime efikase dhe me çmime të arsyeshme për konsumatorët.
- Përcaktimi i tarifave: Tarifat vendosen në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria financiare e operatorëve dhe përballueshmëria nga klientët.
- Mbikëqyrja e performancës: Analizohet performanca e operatorëve dhe vendosen objektiva efikase për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve.
- Mbrojtja e interesit publik dhe mjedisit: Sigurohet që operatorët të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme ndaj konsumatorëve dhe mjedisit.
- Trajtimi i ankesave të konsumatorëve: Konsumatorët mbështeten në zgjidhjen e problemeve me operatorët.
- Pjesëmarrja në politikëbërje: ERRU jep komentet e saj në proceset e rëndësishme të sektorit, përfshirë strategjitë, politikat dhe legjislacionin kombëtar.
- Publikimi i informacionit: Hartohen raporte të rregullta mbi sektorin, si raportet vjetore dhe të performancës, të cilat janë të disponueshme për publikun.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe Njësisë së Auditit të Brendshëm.

Ky auditim u krye për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollat, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare të ketë mundësuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”

Ky komponent përfshin integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikën e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve.

Parimi 1 - Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike.

Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i Entit Rregullator të Ujit në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se Enti Rregullator i Ujit nuk ka përditësuar Rregulloren e Brendshme referuar ndryshimeve strukturore të vitit 2025, në bazë të ligjit Nr.8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar; “Për miratimin e rregullores së organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të administratës së Entit Rregullator të Ujit”. Në këtë dokument përcaktohen parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për çdo strukturë të institucionit në përputhje me strukturën organizative.

Është miratuar Kodi i Integritetit në përputhje me kërkesat pikës “a”, nenit 20 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar.

Rregullorja e Brendshme është e afishuar në faqen zyrtare të Entit Rregullator të Ujit.

ERRU ka procedura të shkruara për raportimin e shkeljeve të rregullave mbi etikën dhe për marrjen e masave.

-Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se për vitin 2024, ERRU nuk ka përcaktuar procedura për mbrojtjen ndaj sinjalizuesve dhe nuk ka mekanizma të cilat i dedikohen ankesave për korrupsion. Gjithashtu rezultoi se nuk ka evidenca që të tregojnë aftësinë e njësisë publike për të kryer një hetim të brendshëm të drejtë dhe të ndershëm.

Parimi 2 -Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se nuk ka raportime periodike mbi monitorimin e planit të veprimit për Bordin Drejtues.

Nga Drejtoritë dhe Sektorët nuk janë hartuar planet mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Bordit Drejtues lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve.

Në Rregulloren e Brendshme me Vendimin e KKRR, nr. 582, datë 02.12.2022 “Për miratimin e rregullores së organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të administratës së Entit Rregullator të Ujit” është përcaktuar përgjegjësia menaxheriale e drejtuesve të të gjitha strukturave të ERRU të cilët janë përgjegjës dhe raportojnë e i japin llogari, sipas shkallës hierarkike, eprorit direkt deri tek Kryetari ose tek nëpunësit të cilëve kryetari u ka deleguar përgjegjësinë, për: Hartimin dhe monitorimin e planeve vjetore dhe periodike në përputhje me objektivat strategjike, afatmesme si dhe urdhrat dhe udhëzimet e Kryetarit, menaxhimin/administrimin e risqeve/problemeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë (nëpërmjet identifikimit, vlerësimit dhe kontrollit periodik të zbatimit të masave për zvogëlimin e risqeve), informacionin në kohë dhe në formën e kërkuar për rezultatet e arritura gjatë përmbushjes së përgjegjësisë të tyre, për risqet dhe defektet serioze në veprimtarinë e strukturave që drejtojnë, si dhe për masat e marra e të zbatuara për riparimin e këtyre defekteve

Për vitin 2024, nuk është dërguar pranë MFE-së “Pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”, si dhe “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm” dhe “Raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësisë publike që mbulon”, në kundërshtim me Ligjin nr.10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; dhe Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016; për vitin e mëparshëm.

Parimi 3 - Titullari / NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë

Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organigramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësiwe funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit të delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit / Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.

Institucioni vepron mbi bazën e rregullores së brendshme të miratuar me Vendimin e KKRR, nr. 582, datë 02.12.2022 “Për miratimin e rregullores së organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të administratës së Entit Rregullator të Ujit” e cila përmban përshkrimin e vendeve të punës sipas funksioneve duke filluar nga specialistët deri tek Drejtorët e Drejtorive, në përputhje me strukturën organizative aktuale.

Nga auditimi rezultoi se:

- ERRU nuk ka hartuar rregulloren e brendshme në përputhje me ndryshimet e strukturës organike
- ERRU nuk ka hartuar një dokument të veçantë për deklaratën e misionit.

Struktura organizative e ERRU

Struktura e ERRU është miratuar VKM Nr. 33/2022, datë 14.04.2022 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Entit Rregullator të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujrave të Ndotura (ERRU)”.

Në përbërje të strukturës së ERRU-së janë gjithsej 29 punonjës:

- 1 (një) Kryetar Komisioni,
- 4 (katër) Anëtar të Komisionit Kombëtar të Rregullimit (KKRR).
- 1 (një) Sekretar i Përgjithshëm.
- 1 (një) Sekretar i Komisionit dhe Kryetarit
- 9 (nëntë) punonjës në Drejtorinë Teknike – Ekonomike,
- 5 (pesë) punonjës në Drejtorinë Juridike dhe e Konsumatorit,
- 8 (tetë) punonjës në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.

Parimi 4 -Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave

Ky parim vlerëson angazhimin e njësive publike për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësive.

-Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale e cila ka mangësi në të dhënat për marrëdhëniet e punës, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë.

Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ERRU nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

Nga Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit nuk është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxheret e programeve për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.

Nga vetë institucioni nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

Parimi 5 -Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale

Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësiwe dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm.

Nga auditimi i kryer rezultoi se ERRU ka të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale në dokumentin e rregullores së brendshme. Njësia publike nuk ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë dhe nuk ka autorizime për delegimin e detyrave.

Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe përfaqësimi i rregullt në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të rezultatoira.

Për vitin 2024, me Vendimin e KKRR nr. 37 prot. 359/3, datë 07.10.2024, KKRR ka nxjerrë Urdhrin “Për krijimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik” (GMS) Në këtë urdhër, komisioni ka në përbërje 6 anëtarë dhe Kryetar grupi është Sekretari i Përgjithshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se takimet e GMS, dokumentohen me procesverbale. GMS luan një rol kyç për sa i takon integritetin të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 20;

-Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2.1 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK” a, b, c, d, pika 2.3.1;

-VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, Kreu II. “Dosja e Personelit”;

-“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.1, Kapitulli IV “Plani i veprimit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit”, Kapitulli V, Aneksat.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”, për periudhën 2024-2025.

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Parimi 6 – Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva

Ky parim paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët / NA / Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.

Nga auditimi i kryer rezultoi se, ERRU nuk ka përgatitur Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), në të cilin evidentohen objektivat dhe prioritetet e institucionit, së bashku me programet që këto objektiva i përkasin.

Në planin vjetor të punës çdo njësi publike do të zhvillojë objektivat dhe aktivitetet të cilat duhet të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike për të cilat ata janë përgjegjës.

Parimi 7 – Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave

Megjithëse analiza e riskut mund të fillojë nga niveli i lartë menaxherial ose në një funksion operativ, çelësi është ekzistenca e një procesi të përgjithshëm për të përcaktuar se si identifikohen dhe menaxhohen risqet në të gjithë njësinë publike.

Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi rezultoi se njësia publike nuk ka krijuar mekanizma të organizuar dhe funksionale të procesit të menaxhimit të riskut.

Nuk janë identifikuar dhe vlerësuar risqet përmes një procesi të strukturuar dhe sistematik që përfshin vlerësimin e rëndësisë potenciale dhe priorizimin e risqeve të përputhshmërisë.

Parimi 8 – Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve

Mashtimi ekziston (ose mund të ndodhë) në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistrit të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtimit duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv.

Nga auditimi i kryer rezultoi se ERRU-ja ka hartuar procedurat antikorrupsion dhe anti-mashtim të cilat të bazohen në:

- Ligjin Nr. 9508, datë 03.04.2006 “Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit”,

- Ligjin për MFK-në, i ndryshuar, si dhe

- Ligjin Nr. 10294, datë 01.07.2010 “Për Inspektimin Financiar Publik”, i ndryshuar me ligjin nr. 112/2015 e të tjera akte ligjore në fuqi.

Parimi 9- Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme

Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme dhe të jashtme, si dhe të vlerësojnë risqet dhe qasjet për të minimizuar riskun në kohë.

Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se sistemi kontrollit të brendshëm është pjesërishtë efektiv.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 21, pika 2;

- Udhëzimi nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 3 “Përgjegjësitë dhe detyrat e KR”, pika 3.2.1 “Titullari i njësisë publike” pika 4 “Hapat për ngritjen e sistemit të MR”

- “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.2, Kapitulli V, Anekset.

III. Komponenti: Aktivitetet e Kontrollit, për periudhën 2023-2024.

Veprimtaritë e Kontrollit përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

Parimi 10 – Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.

Nuk ka "zgjedhje ideale" në zgjedhjen e aktiviteteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit, ose një kombinim i aktiviteteve të kontrollit (politikat, procedurat dhe përgjegjësitë) duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm. As menaxhimi dhe as auditimi i brendshëm nuk duhet të fillojnë një analizë të aktiviteteve të kontrollit me një listë të kontrolleve dhe të identifikojnë nëse janë të pranishëm apo jo. Përkundrazi, kontrollet duhet të vlerësohen në raport me risqet që duhet të minimizohen.

Në vijim të auditimit të kryer, rezultoi mungesa e hartave apo manualeve të proceseve të punës që sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësiave. Vlen të theksojmë se përgatitja e një harte me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij.

Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

Listë prezencat plotësohen nga përgjegjësi i sektorit përkatës dhe listë pagesa përpilohet nga specialisti i pagave, të dhënat hidhen çdo muaj në librin e pagave.

Në zbatim të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ERRU ka hartuar procedurat për organizimin e prokurimeve, kanë komisione për prokurim, komisione për hartimin e specifikimeve teknike, komisionin e vlerësimit të ofertave, komisionin për pranimin e mallit etj.. Komisionet propozohen nga drejtorët e drejtorive sipas natyrës së objektit të prokurimit (punë, mall, shërbim etj.)

Në zbatim të Udhëzimit nr. 01 datë 05.01.2018 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të PP.... dhe krijimi i tyre në sistemin e PP” është hartuar dhe miratuar regjistri i prokurimeve. Ky regjistër është publikuar në faqen e APP dhe përditësohet sa herë ka ndryshime.

Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat. Aktualisht punohet me sistemin online AFMIS i përdorur për pagesat i cili ruan në sistem praktikat e pagesave të kryera me Degën e Thesarit dhe në Bankën e Shqipërisë.

Parimi 11 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë

Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e softuerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollet e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.

ERRU nuk ka sisteme funksionale të IT-së të ndryshme nga ato fikse (pra përveç sistemeve qeveritare si APP, SIFQ, PBA, HRMIS etj.) dhe nuk ka një procedurë të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up- it.

Ndarja e detyrave në funksionimin e sistemeve të IT- së bëhet duke hapur llogari personale për të gjithë punonjësit sipas funksionit që kanë në çdo proces. ERRU nuk ka plan për menaxhimin e riskut IT për rikuperimin e të dhënave në rast fatkeqësie natyrore.

Parimi 12 – Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave.

Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.

ERRU nuk ka procedura të shkruara dhe politika të brendshme për ndarjen e përgjegjësiave për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar.

Gjurma e auditimit.

Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësive publike dokumentohen në atë formë.

Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se, për vitin 2023 ERRU-ja ka hartuar, miratuar, arkivuar gjurmën e auditimit në zbatim të Ligjit Nr. 110/2015 datë 15.10.2015, neni 16 dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të

Financave dhe Ekonomisë Nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.3 “Aktivitetet e Kontrollit.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu II, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1;

-Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 5.2.7 “Monitorimi dhe Raportimi”;

-“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

IV. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”, për periudhën 2024-2025.

Informimi dhe komunikimi përfshin identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.

Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara.

Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.

Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Në vijim të auditimit, rezultoi se ERRU nuk i kushton rëndësinë e duhur përcjelljes së informacionit dhe raportimit.

ERRU ka një sistem komunikimi dhe raportimi, si brenda dhe jashtë institucionit por ky sistem i raportimit nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj, kjo për të dy vitet objekt auditimi 2024-2025..

Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit. Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër. Nuk ka sistem për kontabilizimin e të dhënave në ERRU.

Parimi 14 - Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm

Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

ERRU përgatit raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e njësisë në lidhje me shërbimet publike.

Në faqen zyrtare të institucionit pasqyrohen vendimet dhe projektet e ERRU. Drejtuesit e institucionit njoftohen nëpërmjet shkresave apo në rrugë elektronike sa herë që ka alokime fondesh.

Parimi 15 - Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.

ERRU është në marrëdhënie ndërvepruese të përditshme, duke përcjellë informacione të ndryshme në rrugë zyrtare, në format shkresore dhe evidentohet që punonjësit përdorin adresat zyrtare të e-mailit. Institucioni siguron qasje publike nëpërmjet publikimit faqes së internetit të njësisë të informacionit lidhur me: Planet vjetore të prokurimit, proceset e hapura të prokurimit,

kontratat e lidhura, statistika mbi prokurimet; Raporti i auditimit të jashtëm për njësinë mbi pasqyrat financiare dhe aktivitetin e vitit paraardhës.

Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Çdo sugjerim nga aktorët kryesor diskutohet për të reflektuar ndryshimet e duhura në buxhet.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 23, “Informacioni dhe Komunikimi” pika 2;

-“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

V. Komponenti: “Monitorimi” për periudhën 2024-2025.

Monitorimi realizohet përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.

Nga auditimi i kryer, rezultoi se institucioni ka përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, ndërkohë që ende nuk janë hartuar manualët e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.

Progresi lidhur me arritjen e objektivave dhe analizimi i shkaqeve për dështimet e mundshme monitorohet nëpërmjet raportimeve periodike. Institucioni ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit të miratuar për monitorimin e MFK-së.

Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë.

Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi.

Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 24, “Monitorimi” pika 1;

-“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.5, Kapitulli V, Anekset.

2.1.1. Organizimi i Njësisë së Auditit të Brendshëm

Në zbatim të programit të auditimit, u konstatua se pranë Entit Rregullator të Ujit nuk është ngritur NJAB, pasi në zbatim të VKM nr. 83/2016 “Për miratimin e kriterëve të Krijimit të Njësisë të Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik”, si dhe Referuar rregullores së brendshme të ERRU nr. 582, datë 02.12.2022, neni 16, pika 2 germa dh, ERRU nuk e plotëson asnjë nga kriteret ligjore për ngritjen e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, konkretisht:

ERRU ka rreth 30 punonjës, shumë më pak se kufiri minimal prej 300 punonjës;

Të ardhurat financiare të institucionit janë shumë më të ulëta se kufiri minimal prej 400 milion lekësh për tre vite radhazi;

Institucioni nuk mund të krijojë një strukturë me të paktën 3 auditues të brendshëm;

ERRU nuk bën pjesë në kategoritë e përcaktuara në pikën 1/a të VKM nr. 83/2016 “Për miratimin e kritereve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik”

Në këto kushte, ERRU klasifikohet në kategorinë e njësive publike të parashikuara nga pika 6 e VKM nr. 83/2016 “Për miratimin e kritereve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik”, të cilat nuk janë të detyruara të krijojnë NJAB, por mund të sigurojnë shërbimin e auditimit të brendshëm përmes marrëveshjeve ose kontraktimit, vetëm nëse vlerësohet e nevojshme.

Konkretisht është lidhur një kontratë shërbimi ndërmjet palëve;

Enti Rregullator I Sejtorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotur (ERRU) dhe Operatori ekonomik Studio “A..”, për auditimin e përputhshmërisë për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024.

Për rrjedhojë dokumentet, (Karta e Auditimit, Plani Strategjik, Planifikimet vjetore, Dosjet operative dhe përherëshme të auditimit, dokumentacioni i rekrutimit dhe trajnimit të auditorëve) nuk ekzistojnë.

Konkluzion i përgjithshëm

Enti Rregullator i Ujit ka ngritur një sistem jo efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm rezultoi se nuk është rishikuar rregullorja e brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore. Gjithashtu, nuk është dërguar pranë MFE-së “Pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”, si dhe “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm” dhe “Raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësisë publike që mbulon”, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe me Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980/2010 dhe nr. 108/2016, për vitin e mëparshëm.

2.2. Hartimi dhe zbatimi i programit ekonomik – financiar

Referuar nenit 10 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” i ndryshuar parashikohet se, burimet e financimit të Entit Rregullator përbëhen nga:

1. Pagesat e rregullimit, të vendosura nga ajo vetë për operatorët, që operojnë në sistemet e furnizimit me ujë, të kanalizimeve të ujërave të zeza dhe trajtimit të tyre,
2. Pagesat e licencave.
3. Donacione të ndryshme

Në vijim të nenit 11 të ligjit të sipërcituar, janë parashikuar afatet e hartimit dhe miratimit të Buxhetit, si më poshtë vijon:

1. Jo më vonë se 3 (tre) muaj para fillimit të vitit fiskal, Enti Rregullator do të ndërtojë një fond të shpenzimeve të parashikuar operative për t’ia paraqitur për miratim Këshillit të Ministrave
2. Enti Rregullator do të mbajë llogari të plota dhe të sakta të shpenzimeve faktike në përputhje me legjislacionin shqiptar të kontabilitetit.
3. Të gjithë të ardhurat e tepërta mbi shpenzimet e Entit Rregullator do të kalohen në Buxhetin e Shtetit.

Në referim të nenit 16 pika 1 germa “i”, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Entit Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, parashikohet se:

KKRR miraton Projekt Buxhetin e ERRU për vitin e ardhshëm, sipas legjislacionit në fuqi.

Në vijim të nenit 16 pika 2 germa “b” parashikohet ngritja e grupit të menaxhimit strategjik të institucionit nga KKRR.

Nga auditimi rezultoi se:

a. KKRR me vendimin nr.37 datë 01.12.2015 “Për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit” në Entin Rregullator të Ujit” ka ngritur grupin e menaxhimit strategjik (GMS) të përbërë nga:

- Kryetari
- Zëvendës Kryetari
- Drejtori i Drejtorisë Teknike Ekonomike
- Përgjegjësit e sektorëve

Veprimtaria e grupit të menaxhimit strategjik ka qenë në fuqi deri në daljen e vendimit nr. 37, datë 07.10.2024 “Për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të entit Rregullator të Ujit”, pasi në pikën 2 të këtij vendimi është shfuqizuar vendimi nr.37, datë 01.12.2015.

b. Me vendimin nr. 37 datë 07.10.2024 “Për ngritjen e grupit të menaxhimit Strategjik të Entit Rregullator të Ujit” është ngritur grupi i menaxhimit Strategjik (GMS) të përbërë nga:

- Kryetari i Entit Rregullator të Ujit-Kryetari
- Zëvendës Kryetari i ERRU- Anëtar
- Sekretari i Përgjithshëm (nëpunës Autorizues) – Anëtar
- Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse (nëpunës Zbatues) -Anëtar
- Drejtori i Drejtorisë Teknike-Ekonomike-Anëtar
- Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Konsumatorit-Anëtar

Referuar vendimeve të KKRR për ngritjen e GMS, Nëpunësi zbatues është përcaktuar në pozicionin e sekretarit të GMS.

c. Në referim të rregullores së brendshme të institucionit (ERRU) neni 40 pika 3, parashikohet se: *Projekt Buxheti hartohet dhe paraqitet përpara KKRR nga grupi Strategjik i Menaxhimit. Përbërja e grupit strategjik të menaxhimit përcaktohet me një vendim të veçantë të KKRR*

Konkluzion

Për periudhën nga data 01.01.2024 deri 31.10.2025, Enti Rregullator i Ujit në zbatim të akteve ligjore dhe rregullore ka ngritur GMS, respektivisht për periudhën 01.01.2024 deri 07.10.2024 me anëtarë të grupit të menaxhimit strategjik të cilët i përkasin pozicioneve të strukturës dhe emërtesës të përcaktuar në vendimin nr. 37, datë 01.12.2015 dhe për periudhën 07.10.2024 deri më datë 31.10.2025 i përkasin përcaktimit të vendimit nr. 37, datë 07.10.2024. Për periudhën objekt auditimi, Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimet e sipërcituara ka ngritur grupin e menaxhimit strategjik në zbatim të nenit 8 germa “b” të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Buxheti i vitit 2024

Për vitin 2024, projekt plani i shpenzimeve është planifikuar dhe paraqitur nga Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse znj. S.Ç njëkohësisht edhe nëpunës zbatues nëpërmjet shkresës nr. 318 prot., datë 11.09.2023 me objekt “Projekt Plani i shpenzimeve Operative të ERRU për vitin 2024” e ndarë sipas zërave të shpenzimeve:

1. 600 (paga) në Shumën 54,760,050 lekë
2. 601 (sigurime) në Shumën 7,507,600 lekë
3. 602 (shpenzime Operative) në shumën 13,957,000 lekë

4. 230/231 (investime/projektim) në shumën 2,000,000 lekë.
5. Totali i shpenzimeve : 78,224,650 lekë.

Nga auditimi rezultoi se, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH, gjatë fazës së hartimit të planit të shpenzimeve nga ERRU, kërkesat për shpenzime për vitin 2024 nuk pasqyrojnë kërkesat/nevojat e sektorëve/drejtorive, por janë hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse mbi bazën e kërkesave të viteve të mëparshme, pa përcaktuar qartë nevojat reale të institucionit, duke u bazuar në shpenzime historike ndër vite.

GMS nuk është përfshirë në projekt-planin e shpenzimeve për vitin 2024, për të analizuar dhe konsoliduar nevojat e institucionit, të cilat duhej të paraqiteshin nga sektorët/drejtoritë dhe më pas për t'u paraqitur për miratim në KKRR, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 40, pika 3, të rregullores së brendshme të ERRU.

Gjithashtu, nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe nga verifikimet në zyrën e protokollit të project planit të shpenzimeve të vitit 2024 rezultoi mungesë e detajimit të shpenzimeve për zërin shpenzime operative (602) dhe për investimet (230/231)

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi anëtarët përkatës të GMS për periudhën 01.01.2024–31.12.2024, konkretisht: Kryetari i Entit Rregullator të Ujit, z. N.SH (01.01.2024–24.06.2024); Zëvendëskryetarja e Entit Rregullator të Ujit, znj. E.B (01.01.2024–22.09.2024); znj. E.SH (23.09.2024–31.12.2024); Drejtori i Drejtorisë Teknike-Ekonomike, z. S.K (01.01.2024–31.12.2024); si dhe përgjegjësit e sektorëve, znj. E.D (01.01.2024–31.12.2024) dhe znj. N.S (01.01.2024–31.12.2024), të cilët nuk kanë hartuar projektbuxhetin për vitin 2024 në përputhje me përcaktimet e nenit 8, germa “b”, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 3, të Rregullores së Brendshme të institucionit (ERRU).

Miratimi i planit të shpenzimeve të vitit 2024 nga KKRR

-KKRR me Vendimin nr.36, datë 13.09.2023 “Për miratimin e projektplanit të shpenzimeve operative të ERRU për vitin 2024” ka miratuar projekt planin e shpenzimeve të ERRU në shumën totale 78,724,650 lekë.

-Referuar propozimit të bërë nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse me shkresën nr. 318 prot., datë 11.09.2023 me objekt “Projekt Plani i shpenzimeve Operative të ERRU për vitin 2024”, KKRR ka rritur shpenzimet për zërin investime me 500,000 lekë dhe njëkohësisht ka shtuar në zërin e investimeve zërin “Licenca” të cilat nuk ishin parashikuar në projekt shpenzimet e paraqitura me shkresën e sipërcituar.

-KKRR me vendimin nr. 44 date 23.10.2023 “Për korrigjimin e vendimit të KKRR nr. 36 datë 13.09.2023 për miratimin e projekt planit të shpenzimeve operative të ERRU për vitin 2024” ka ndryshuar planin e shpenzimeve nga 78,724,650 lekë në 71,217,100 lekë duke e zvogëluar me 7,507,550 lekë.

Tabela nr. 1 Ndryshimet e plan shpenzimeve për vitin 2024.

Llog.	Emërtimi	Plani fillestar	V. KKRR. Nr.36, date 13.09.23	ndryshimi	V.KKRR. Nr.44, date 23.10.2023	V.KKRR Nr.1., date 10.01.2024	Ndryshimi
600	Paga	54,760,050	54,760,050	-	47,252,500	47,252,500	(7,507,550)
601	Sigurime	7,507,600	7,507,600	-	7,507,600	7,507,600	-
602	Shpenzime operative	13,957,000	13,957,000	-	13,957,000	13,957,000	-
230/231	Investime	2,000,000	2,500,000	500,000	2,500,000	2,500,000	-
1.	Ekrane Kompjuteri	200,000	200,000	-	200,000	800,000	-

2.	Pajisje dhe mobilim zyre	1,800,000	1,400,000	(400,000)	1,400,000	800,000	-
3.	Licenca	-	900,000	900,000	900,000	900,000	-
Total			78,724,650	500,000	71,217,100	71,217,100	(7,507,550)

Burimi: Të dhëna të ERRU, të përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Në zbatim të pikës 1 të nenit 11, të ligjit nr.8102 date 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, ERRU nëpërmjet shkresave respektive nr. 326/1 prot., datë 25.09.2023, ka përcjell planin e shpenzimeve për vitin 2024 në Këshillin e Ministrave, dhe në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.326/2 prot. datë 25.09.2023.

MFE me shkresën nr. 17649/1 datë 17.10.2023 me objekt “Kërkohet informacion i detajuar mbi projekt buxhetin e vitit 2024” ka rezultuar se, e citoj:

Buxheti i propozuar për vitin 2024 prej rreth 78.7 milion lekë është rreth 22.3 milion lekë më shumë krahasuar me buxhetin fillestar për vitin 2023.

Në vijim në mënyrë të përmbledhur, MFE kërkon një relacion shpjegues dhe një analize të detajuar në nivel financiar dhe jo financiar, duke krahasuar me buxhetin e 2023 dhe realizimin e pritshëm të tij të ndarë sipas artikujve kryesor ekonomik. Gjithashtu MFE konstaton se shpenzimet e personelit janë planifikuar rreth 62.2 milion leke ose 21 milion leke me shume krahasuar me vitin 2023, për të vijuar me kërkesën e një analize mbi parashikimin e investimeve, për sa kohe që fondi planifikohet me rritje prej 2 milion leke me shume krahasuar me 2023, etj.

Nga auditimi i dokumentacionit të administruar nga grupi i auditimit të KLSH rezultoi se, ERRU ka reflektuar kërkesat e paraqitura në shkresën e MFE nr. 17649/1, datë 17.10.2023, me objekt “Kërkohet informacion i detajuar mbi projekt buxhetin e vitit 2024”, për plotësimin e kërkesave të përcaktuara në këtë shkresë.

Në këtë kuadër, KKRR ka marrë në konsideratë konstatimin e MFE, duke kryer ndryshim në planin e shpenzimeve për zërin paga (600), me zvogëlim të fondit në vlerën 7,507,550 lekë, ndryshim i cili është pasqyruar në vendimin nr. 44, datë 23.10.2023, “Për korrigjimin e vendimit të KKRR nr. 36, datë 13.09.2023, ‘Për miratimin e projektplanit të shpenzimeve operative të ERRU për vitin 2024’”.

Miratimi i fondit vjetor të shpenzimeve të ERRU për vitin 2024 nga Këshilli i Ministrave:

Plani i shpenzimeve për vitin 2024 të Entit Rregullator të Ujit është miratuar në shumën 71,217,100 lekë me VKM nr.702, date 06.12.2023, sipas aneksit nr.1 të këtij Vendimi:

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Viti 2024 (lekë)
1	Paga	47,252,500
2	Sigurime	7,507,600
3	Shpenzime operative	13,957,000
4	Investime	2,500,000
	TOTALI	71,217,100

-KKRR me vendimin nr.1 date 10.01.2024 “Detajimin e planit të shpenzimeve operative të Entit Rregullator të ujit për vitin 2024” ka miratuar detajimin e planit të shpenzimeve operative të ERRU për vitin 2024 në shumën totale prej 71,217,100 lekë, shpërblimit të pagës në natyrë për punëmarrësit në ERRU në masën 500 lekë në ditë për ditë pune (për kompensim ushqimor), Shpenzime për shërbimin telefonik, si më poshtë:

-Kryetari jo më shumë se 20,000 lekë në muaj

-Anëtarë i KKRR jo më shumë se 4000 lekë në muaj

-Sekretar i Përgjithshëm jo më shumë se 4000 lekë në muaj
 -Drejtor Drejtorie jo më shumë se 2500 në muaj, dhe trajtimin financiar të kryetarit të ERRU për shpenzimet e transportit, i cili do të jetë në masën 20,000 lekë në muaj
Plani i detajuar i shpenzimeve për vitin 2024, paraqitet në Aneksin nr.1., tabela nr.1

Për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024 në tabelën e mëposhtme paraqiten sipas zërave buxhetor planifikimi, ndryshimi dhe realizimit i planit të shpenzimeve.

Llog.	Planifikimi						Realizimi	
	Emërtimi	Plani fillestar	V. KKRR. Nr.36, date 13.09.23	ndryshimi	V.KKRR. Nr.44, date 23.10.2023	Ndryshimi	Fakt	Realizim %
600	Paga	54,760,050	54,760,050	-	47,252,500	-7,507,550	41,198,065	87%
601	Sigurime	7,507,600	7,507,600	-	7,507,600	-	6,516,361	87%
602	Shp. Op.	13,957,000	13,957,000	-	13,957,000	-	10,805,570	77%
230/231	Investime	2,000,000	2,500,000	500,000	2,500,000	-	1,980,456	79%
Total		78,224,650	78,724,650	500,000	71,217,100	-7,507,550	60,500,452	85%

Burimi: ERRU, përpunimi nga grupi i KLSH.

Detajimi i Shpenzimet faktike për vitin 2024

Më poshtë pasqyrohet shpenzimet totale dhe analitike të ERRU për vitin 2024. (në lekë)

Llog.	Emërtimi	Vlera
602001	kancelari	193,700
602002	materiale pastrimi	236,400
602003	materiale printimi	112,800
602004	materiale e mirëmbajtje e ambienteve të punës	60,000
602005	mirëmbajtje dhe pajisje për kondicionere	75,000
602008	antivirus	4,000
602201	shërbim me roje private	1,575,728
602202	njoftime ne shtyp	36,000
602203	komisione bankare	115,271
602204	shërbim postar	29,700
602205	shp.interneti + website	121,400
602206	shpenzime për energji elektrike	20,311
602207	shpenzime për ujë	90,000
602208	telefon fiks	51,626
602209	telefon mobile	252,748
602301	karburante	392,940
602302	parkim dhe larje e autoveturave	60,800
602303	sig. dhe taksa te mjeteve te transportit	209,804
602401	udhëtim e dieta jashtë vendit	2,927,650
602402	udhëtim e dieta brenda vendit	593,000
602501	mirëmbajtje mjete transporti	353,421
602502	mirëmbajtje pajisje	800
602901	kuotacion për aderim ne org.nderkombetare	243,303
602902	shpenzime për pritje përcjellje	16,145
602903	taksa vendore dhe shpenzime gjyqësore	22,563
602905	abonime ne shtyp	28,736
602906	botime	114,300
602907	pagese auditimi	99,000
602909	blerje materiale x mbrojtjen personale	17,988
602912	mirëmbajtje program financiar dhe proces fiskalizmi	120,000
602305	bonus transporti	113,636
602912	shpenzime pagesa në natyre	2,593,500

Shuma 1.		10,882,270
6001	pagat e personelit	39,236,252
6002	paga dhe shpërblime nga fondi i veçantë	1,961,813
601	sigurime shoqërore	5,803,317
601	sigurime shëndetësore	713,044
Shuma 2.		47,714,426
6035	ndrysh.gjend.mallra	-81,712
666	zbritje akorduar klientëve	115
669	humbje nga këmbimet valutore	4,897
Shuma 3		76,700
230	Ekrane kompjuteri dhe njësi qendror	780,456
230	Pajisje zyre dhe mobilje	336,000
231	Licenca	864,000
Shuma 4. investime		1,980,456
Total (shuma1+2+3+4)		60,500,452

Burimi: ERRU, përpunimi nga grupi i KLSH.

Nga tabela me sipër rezultoi se:

Për vitin 2024, shpenzimet faktike të ERRU janë në masën 85% kundrejt vlerës së planifikuar. Pjesën më të madhe të shpenzimeve për vitin 2024 e zë zëri paga sigurime (600, 601) që përbejnë rreth 79% të shpenzimeve totale faktike.

Të ardhura për vitin 2024

Burimet e financimit të ERRU, sipas përcaktimeve ligjore realizohen nga pagesa rregullatore dhe ato të licencimit. Masa e pagesës rregullatore është përcaktuar me vendimin e KKRR nr.485, datë 14.10.2022 ku është përcaktuar koeficienti 0.65% mbi të ardhurat e parashikuara për llogaritjen e tarifës rregullatore për kontratat e reja në vijim, si dhe vendimin e KKRR nr.35, datë 07.10.2024 “Për miratimin e përqindjes së tarifës rregullatore vjetore”.

KKRR me vendimin e sipërcituar në pikën 1, ka përcaktuar 0.77% për të gjitha shoqëritë ujësjellës kanalizime dhe në pikën 2, për shoqëritë UK që aplikojnë për nivel të ri tarifor, ky koeficient do të aplikohet mbi të ardhurat vjetore të parashikuara nga aktiviteti i furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, dhe në pikën 3 parashikohet se:

Për shoqëritë UK që nuk do të aplikojnë për nivel të ri tarifor, ky koeficient do të aplikohet mbi të ardhurat e realizuara të vitit pasardhës.

Nga auditimi rezultoi se, Strukturat përgjegjëse nuk kanë hartuar dhe miratuar planin e të ardhurave

Grupi i auditimit të KLSH në referim të vendimit nr.485, datë 14.10.2022, nr.35., datë 07.10.2024 në bashkëpunim me sektorin e financës, pasqyroj në formë tabelore të ardhurat vjetore dhe realizimin për vitin 2024, të paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela: Të ardhurat për vitin 2024

Emërtimi i Shoqërive UK	Pagesa Rregullatore			Pagesa për licencime		
	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
Shoqëria Rajonale UK Shkodër sh.a						
Sh.a.u Malësi e Madhe						
Sh.a.u.k Shkodër	2,779,409	5,281,385.00	190%	40,000	40,000	100%
Sh.a.uk Vau i Dejes						
Nd. UK Puke						
Sh.a.u.k Fushe Arrez						
Shoqëria Rajonale UK Kukës sh.a						
Sh.a.u Kukes	809,936	205,000	25%	40,000	40,000	100%
Sh.a.u Tropoje						
Sh.a.u Has						
Shoqëria Rajonale UK Lezhë sh.a	2,731,000	3,317,565	121%			

Sh.a.u.k Lezhe						
Sh.a.u.k Mirdite(Rrëshen)						
Sh.a.u Kurbin Laç						
Shoqeria Rajonale UK Dibër sh.a						
Sh.a.u Bulqize						
Sh.a.u Mat(Burrel)	1,233,385	768,432	62%			
Sh.a.u k Peshkopi(DIBER)						
Sha u Klos						
Shoqeria Rajonale UK Durrës sh.a						
Sh.a.u.k Rrogozhine						
Sh.a.u.k Kruje	13,433,000	19,496,558	145%	120,000	120,000	100%
Sh.a.u.k Durres						
Sh.a.u.k Kavaje						
Sh.a.u.k Shijak						
Shoqeria Rajonale UK Tiranë sh.a						
Sh.a.u.k Tirane	31,052,537	15,000,000	48%			
Sh.a.u.k Vore	604,722		0%	40,000	40,000	100%
Sh.a.u.k Kamez						
Shoqeria Rajonale UK Fier sh.a						
Sh.a.u.k Fier						
Sh.a.u.k Mallakaster(Ballsh)	5,678,000	8,641,688	152%			
Sh.a.u Patos						
Sha u.k Roskovec						
Shoqeria Rajonale UK Lushnjë sh.a						
Sh.a.u.k Lushnje	1,942,547		0%			
Sh.a.u Lushnje Fshat						
Sh.a.u Divjake						
Shoqeria Rajonale UK Elbasan sh.a						
Sh.a.u Gramsh						
Sh.a.u.k Librazhd-Perrenjas						
Sh.a.u.k Peqin	4,301,886	5,964,765	139%			
Sh.a.u.k Elbasan						
Sh.a.u Elbasan Fshat						
Sh.a.u.Belsh						
Sh.a.u.k Cerrik						
Shoqeria Rajonale UK Berat sh.a						
Sh.a.u Poliçan						
Sh.a.u Skrapar	2,580,364	2,580,364	100%			
Sh.a.u Ura vajgurore (Dimal)						
Sh.a.u.k Berat - Kuçove						
Shoqeria Rajonale UK Korçë sh.a						
Sh.a.u.k Korçë						
Sh.a.u.k Kolonje (Erseke)	3,556,840		0%	150,000	150,000	100%
Sh.a.u Maliq						
Sh.a.u Bilisht (Devoll)						
Sh.a.u Pustec						
Shoqeria Rajonale UK Pogradec sh.a						
Sh.a.u.k Librazhd-Perrenjas	1,607,509	1,607,509	100%			
Sh.a.u.k Pogradec						
Shoqeria Rajonale UK Gjirokaster sh.a						
Sh.a.u.k Gjirokaster						
Sh.a.u Permet						
Sh.a.u k Tepelene	1,707,461	2,876,101	168%			
Sh.a.u.k Kelcyre						
Sh.a.u.k Libohove						
Sha u Dropull						
Sha u Memaliaj						
Shoqeria Rajonale UK Vlorë sh.a						
Sh.a.u Vlore	4,895,000	2,447,500	50%	300,000	300,000	100%
Sh.a.u Selenice						
Sha .u.k Himare						
Shoqeria Rajonale UK Sarandë sh.a						
Sh.a.u.k Sarande						
Sh.a.u Delvine	2,246,744	2,246,744	100%			
Sha u Konispol						
Sha u Finiq						
TOTALI	81,160,340	70,433,611	87%	690,000	690,000	100%

Burimi: ERRU, përpunimi nga grupi i KLSH.

Nga tabela me sipër rezultoi se:

Realizimi i të ardhurave nga pagesa rregullatore për vitin 2024 është në masën 87%, ndërsa të ardhurat nga pagesa për licencime janë në masën 100%

Planifikimi dhe miratimi i Buxheti të ERRU për vitin 2025

-Me shkresën nr.354/1 prot., datë 30.09.2024 Drejtori i shërbimeve mbështetëse të ERRU, znj. S.Ç është drejtuar KKRR, ku ka bërë planifikimin e shpenzimeve sipas zërave të mëposhtëm:

1. Paga dhe shtesa të tjera në shumen 49,776,700 leke
2. Sigurime shoqërore dhe shëndetësore në shumen 7,899,260 leke
3. Shërbime Furniturë në shumën 13,773,040 leke

Totali i shpenzimeve : 71,449,000 lekë.

Nga auditimi rezultoi se, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH, gjatë fazës së hartimit të planit të shpenzimeve nga ERRU, kërkesat për shpenzime për vitin 2025 nuk pasqyrojnë kërkesat/nevojat e sektorëve/drejtorive, por janë hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse mbi bazën e kërkesave të viteve të mëparshme, pa përcaktuar qartë nevojat reale të institucionit, duke u bazuar në shpenzime historike ndër vite.

GMS nuk është përfshirë në projekt-planin e shpenzimeve për vitin 2025, për të analizuar dhe konsoliduar nevojat e institucionit, të cilat duhej të paraqiteshin nga sektorët/drejtoritë dhe më pas për t'u paraqitur për miratim në KKRR, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 40, pika 3, të rregullores së brendshme të ERRU.

Gjithashtu, nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe nga verifikimet në zyrën e protokollit të project planit të shpenzimeve të vitit 2025 rezultoi mungesë e detajimit të shpenzimeve për zërin shpenzime operative (602) dhe për investimet (230/231)

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi anëtarët përkatës të GMS për periudhën 01.01.2025–31.10.2025, konkretisht: Kryetarja e Entit Rregullator të Ujit, znj. G.L (03.03.2025–31.10.2025); Zëvendëskryetari i Entit Rregullator të Ujit, z. E.SH (01.01.2025–28.09.2025); z. G.GJ (29.09.2025–31.10.2025); Sekretarja e Përgjithshme, znj. F.I (01.01.2025–31.10.2025); Drejtoresha e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, znj. S.Ç (01.01.2025–31.10.2025); Drejtori i Drejtorisë Teknike-Ekonomike, z. S.K (01.01.2025–07.03.2025), si dhe znj. E.K (02.06.2025–31.10.2025); Drejtoresha e Drejtorisë Juridike dhe të Konsumatorit, znj. F.B (01.01.2025–31.10.2025), të cilët, në cilësinë e anëtarëve të GMS, nuk kanë hartuar projektbuxhetin për vitin 2025 në përputhje me përcaktimet e nenit 8, germa "b", të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 3, të Rregullores së Brendshme të institucionit (ERRU).

Miratimi i Plan shpenzimeve për vitin 2025

-KKRR me vendimin nr.33 date 30.09.2024 i ka paraqitur Këshillit të Ministrave kërkesën për miratimin e planit të shpenzimeve të ERRU për vitin 2025 në shumën 71,449,000 lekë.

-Me shkresën nr.353 prot., datë 30.09.2024 ERRU ka përcjell planin e shpenzimeve të miratuar nga KKRR në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë.

-Me shkresën nr.353/2 prot. datë 30.09.2024 është përcjell në Këshillin e Ministrave projekt vendim nga ERRU për miratimin e vendimit të KKRR të planit të shpenzimeve.

-Me VKM nr.663 date 23.10.2024 është miratuar plani i shpenzimeve për vitin 2025 në shumën 71,449,000 lekë, dhe *aneksin nr.1* bashkëlidhur këtij vendimi është miratuar plani i shpenzimeve si më poshtë:

1. Paga dhe shtesa të tjera në shumën 49,776,700 lekë
2. Sigurime shoqërore dhe shëndetësore në shumën 7,899,260 lekë

3. Shërbime Furniturë në shumën 13,773,040 lekë
Totali i shpenzimeve 71,449,000 lekë.

Detajimi i planit të shpenzimeve të ERRU me ndryshime për vitin 2025.

Llog.	Planifikimi				Realizimi 31.10.2025	
	Emërtimi	Plani fillestar	V. KKRR. Nr.33, date 30.09.24	ndryshimi	Fakt	Realizim %
600	Paga	49,776,700	49,776,700	-	36,224,880	73%
601	Sigurime	7,899,260	7,899,260	-	6,000,996	76%
602	Shp. operative	13,773,040	13,773,040	-	8,988,122	65%
230/231	Investime	-	-	-	-	
Total		71,449,000	71,449,000	-	51,213,998	72%

Nga tabela me sipër rezultoi se:

Gjatë periudhës 10-mujore të vitit 2025, shpenzimet e realizuara arrijnë 72% të totalit të parashikuar, ku 65% përbëhen nga shpenzimet operative dhe 75% nga paga dhe sigurimet.

-Me vendimin nr.2, date 13.01.2025 KKRR ka miratuar planin e detajuar të shpenzimeve për vitin 2025 sipas tabelës nr.2 aneksi nr.1.

-Me shkresën nr.313 prot., datë 27.05.2025 me objekt “Informacion” të Drejtorit të Drejtorisë së shërbimeve mbështetëse të ERRU, kërkohet një ndryshim në planin e shpenzimeve duke kërkuar shtim në zërin “Udhëtime dhe dieta brenda vendit” në vlerën prej 411,715 lekë.

-KKRR me Vendim nr.16., date 29.05.2025 me objekt “Një ndryshim në vendimin e KKRR nr.2 datë 13.01.2025 “Për detajimin e planit të shpenzimeve operative të ERRU për vitin 2025” si më poshtë

Shtesë – Udhëtime e dieta brenda vendit	411,715 lekë
Paksim Abonime ne shtyp	29,400 lekë
Paksim Bonus transporti	40,000 lekë
Paksime Materiale pastrimi	122,160 lekë
Paksim Taksa dhe tarifa vendore	50,000 lekë
Paksim Telefon mobile	100,000 lekë

-Me shkresën nr. 498 prot., date 10.09.2025 “Informacion” Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse ka kërkuar shtesë zëri të ri shpenzime për pjesëmarrjeje në konferenca dhe evente profesionale me 142,560 lekë dhe pakësim Pagesa në natyrë 142,560 lekë.

-KKRR me vendim nr. 28., datë 11.09.2025 “Një ndryshim të vendimit nr.2., date 13.01.2025, “Për detajimi e planit të shpenzimeve operative të ERRU për vitin 2025” është miratuar ndryshimi si më poshtë”

Shtesë shpenzime për pjesëmarrje në konferenca dhe evente profesionale prej 142,560 lekë
Pakësim pagesa në natyrë 142,560 lekë

Tabela e të ardhurave të planifikuara për vitin 2025

NR	Shoqëritë UK	Të Ardhura 2025	
		Pagesa Rregullatore	Licencime
1	Shoqëria Rajonale UK Shkodër sh.a	4,151,517.00	
2	Shoqëria Rajonale UK Kukës sh.a	797,629.00	
3	Shoqëria Rajonale UK Lezhë sh.a	2,885,000.00	
4	Shoqëria Rajonale UK Dibër sh.a	1,248,626.00	
5	Shoqëria Rajonale UK Durrës sh.a	14,833,000.00	
6	Shoqëria Rajonale UK Tiranë sh.a		
6.1	Sh.a.u.k Tiranë	32,223,671.00	
6.2	Sh.a.u.k Vorë	792,174.00	
7	Shoqëria Rajonale UK Fier sh.a	6,026,000.00	300,000
8	Shoqëria Rajonale UK Lushnjë sh.a	1,938,267.00	

9	Shoqëria Rajonale UK Elbasan sh.a	4,976,368.00	
10	Shoqëria Rajonale UK Berat sh.a	2,655,437.00	
11	Shoqëria Rajonale UK Korçë sh.a	4,515,580.00	
12	Shoqëria Rajonale UK Pogradec sh.a	2,061,046.00	
13	Shoqëria Rajonale UK Gjirokaster sh.a	2,430,436.00	
14	Shoqëria Rajonale UK Vlorë sh.a	5,929,279.00	40,000
15	Shoqëria Rajonale UK Sarandë sh.a	2,689,711.00	
TOTALI		90,153,741.00	340,000.00

Gjendja e pagesave rregullore për vitin 2025

Emërtimi i Shoqërive UK	Pagesa Rregullore (01.01.2025-31.10.2025)		
	Plan	Fakt	%
Shoqëria Rajonale UK Shkodër sh.a			
Sh.a.u Malësi e Madhe			
Sh.a.u.k Shkodër			
Sh.a uk Vau i Dejës	4,151,517	2,075,759.00	50%
Nd. UK Puke			
Sh.a.u Shkodër Fshat			
Sh.a.u.k Fushe Arrez			
Shoqëria Rajonale UK Kukës sh.a			
Sh.a.u Kukes	797,629	327,500	41%
Sh.a.u Tropoje			
Sh.a.u Has			
Shoqëria Rajonale UK Lezhë sh.a			
Sh.a.u.k Lezhe	2,885,000	1,442,500	50%
Sh.a.u.k Mirdite(Rreshen)			
Sh.a.u Kurbin Laç			
Shoqëria Rajonale UK Dibër sh.a			
Sh.a.u Bulqize			
Sh.a.u Mat(Burrel)	1,248,626	1,233,385	99%
Sh.a.u k Peshkopi(DIBER)			
Sha u Klos			
Shoqëria Rajonale UK Durrës sh.a			
Sh.a.u.k Rrogozhine			
Sh.a.u.k Kruje	14,833,000	14,833,000	100%
Sh.a.u.k Durres			
Sh.a.u.k Kavaje			
Sh.a.u.k Shijak			
Shoqëria Rajonale UK Tiranë sh.a			
Sh.a.u.k Tirane	32,223,671	40,885,726	127%
Sh.a.u.k Vore	792,174	604,722	76%
Sh.a.u.k Kamez			
Shoqëria Rajonale UK Fier sh.a			
Sh.a.u.k Fier			
Sh.a.u.k Mallakaster(Ballsh)	6,026,000	3,839,000	64%
Sh.a.u Patos			
Sha u.k Roskovec			
Shoqëria Rajonale UK Lushnjë sh.a			
Sh.a.u.k Lushnje	1,938,267	969,134	50%
Sh.a.u Lushnje Fshat			

Sh.a.u Divjake			
Shoqeria Rajonale UK Elbasan sh.a			
Sh.a.u Gramsh			
Sh.a.u.k Librazhd-Perrenjas			
Sh.a.u.k Peqin	4,976,368	6,841,265	137%
Sh.a.u.k Elbasan			
Sh.a.u Elbasan Fshat			
Sh.a.u.Belsh			
Sh.a.u.k Cerrik			
Shoqeria Rajonale UK Berat sh.a			
Sh.a.u Poliçan			
Sh.a.u Skrapar	2,655,437	2,655,437	100%
Sh.a.u Ura vajgurore (Dimal)			
Sh.a.u.k Berat - Kuçove			
Shoqeria Rajonale UK Korçë sh.a			
Sh.a.u.k Korçë			
Sh.a.u.k Kolonje (Erseke)	4,515,580	7,306,407	162%
Sh.a.u Maliq			
Sh.a.u Bilisht (Devoll)			
Sh.a.u Pustec			
Shoqeria Rajonale UK Pogradec sh.a			
Sh.a.u.k Librazhd-Perrenjas	2,061,046	2,061,046	100%
Sh.a.u.k Pogradec			
Shoqeria Rajonale UK Gjirokaster sh.a			
Sh.a.u.k Gjirokaster			
Sh.a.u Permet			
Sh.a.u k Tepelene	2,430,436	1,416,075	58%
Sh.a.u.k Kelcyre			
Sh.a.u.k Libohove			
Sha u Dropull			
Sha u Memaliaj			
Shoqeria Rajonale UK Vlorë sh.a			
Sh.a.u Vlore	5,929,279	8,858,279	149%
Sh.a.u Selenice			
Sha .u.k Himare			
Shoqeria Rajonale UK Sarandë sh.a			
Sh.a.u.k Sarande			
Sh.a.u Delvine	2,689,711	2,689,711	100%
Sha u Konispol			
Sha u Finiq			
TOTALI	90,153,741	98,038,946	109%

Më poshtë pasqyrohen shpenzimet totale për vitin 2025

Llogari	Emërtim	Planifikuar	Realizuar 01.01.2025-31.10.2025
600	LPAGAT DHE PËRFITIMET E PUNONJËSVE	49,776,700	36,224,880

6001	<i>Paga, personel i përhershëm</i>	47,406,381	36,164,880
6003	<i>Shpërblime</i>	2,370,319	60,000
601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	7,899,260	6,000,996
602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	13,773,040	8,988,123
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	587,140	466,052
602001	<i>Kancelari</i>	162,000	162,000
602002	<i>Materiale pastrimi</i>	186,120	186,120
602003	<i>Materiale printimi</i>	119,020	87,532
602004	<i>Materiale e mirëmbajtje ambienteve të punës</i>	120,000	30,400
6022	Shërbime nga të tretë	2,483,728	1,115,139
602201	<i>Shërbim roje private</i>	1,575,728	525,243
602202	<i>Njoftime në shtyp</i>	72,000	60,000
602203	<i>Komisione bankare</i>	150,000	84,365
602204	<i>Shërbim postar</i>	30,000	25,615
602205	<i>Shp. Interneti + Web Site</i>	120,000	84,655
602206	<i>Shpenzime për energji elektrike</i>	42,000	12,584
602207	<i>Shpenzime për ujë</i>	90,000	75,000
602208	<i>Telefon fiks</i>	54,000	33,803
602209	<i>Telefon mobile</i>	350,000	213,874
6023	Shpenzime transporti	919,000	817,204
602301	<i>Karburante</i>	400,000	400,000
602302	<i>Parkim e larje autoveturave</i>	73,600	43,600
602303	<i>Sig. e taksa te mjete transporti</i>	230,000	199,272
602304	<i>Taksa mjete transporti dhe kolaudim</i>	15,400	14,332
602305	<i>Bonus transporti</i>	200,000	160,000
6024	Shpenzime udhëtimi	4,541,715	3,330,756
602401	<i>Udhëtim e dieta jashtë vendit</i>	3,500,000	2,549,101
602402	<i>Udhëtim e dieta brenda vendit</i>	1,041,715	781,655
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	631,457	281,366
602501	<i>Mirëmbajtje mjete transporti</i>	420,457	242,466
602503	<i>Mirëmbajtje dhe pajisje për kondicionere</i>	91,000	-
602504	<i>Shërbime mirëmbajtje pajisje kompjuterike dhe printimi</i>	120,000	38,900
6029	Shpenzime të tjera operative	4,610,000	2,977,606
602901	<i>Kuotacion për aderim në org. ndërkombëtare</i>	370,000	204,066
602902	<i>Shpenzime për pritje përfaqësime</i>	120,000	50,000
602903	<i>Shpenzime trajnimi</i>	120,000	62,000
602904	<i>Taksa vendore dhe shpenzime gjyqësore</i>	15,000	15,000
602905	<i>Abonime në shtyp</i>	-	-
602906	<i>Botime</i>	120,000	115,980
602907	<i>Pagesa auditimi</i>	120,000	
602908	<i>Blerje materiale për mbrojtjen personale</i>	40,000	-
602909	<i>Mirëmbajtje programi financiar dhe fiskalizimi</i>	120,000	4,000
602910	<i>Antivirus</i>	76,000	75,000
602912	<i>Shpenzime pagesa në natyrë</i>	3,366,440	2,309,000
602914	<i>Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca dhe evente profesionale</i>	142,560	142,560
63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT		-272,934
Totali		71,449,000	50,941,065

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 18/2 Prot., datë 05.03.2026, administruar nga KLSH me 1052/10, datë 05.03.2026, “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”, nga përfaqësues të ERRU, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Në mënyrë të përmbledhur, ato konsistojnë në:

- 1. ... Vlera prej 2,000,000 lekë, e cila përfshin pajisje kompjuterike dhe mobilim zyre, është përcaktuar duke iu referuar për orientim specifikimeve teknike të AKSHI-t dhe çmimeve referente përkatëse.*
- 2. Emërtimi i zërave të shpenzimeve gjatë paraqitjes në KKRR është bërë në funksion të qartësisë dhe transparencës së informacionit të paraqitur.*

Qëndrimi i grupit të auditimit

Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbështetës dhe i observacioneve të paraqitura në lidhje me dy çështjet e mësipërme, rezultoi se nga subjekti i audituar nuk është paraqitur ndonjë dokumentacion i ri, i panjohur më parë nga grupi i auditimit të KLSH-së. Gjithashtu, këto observacione nuk janë pranuar edhe në fazën e PRA-së; për rrjedhojë, observacioni nuk merret në konsideratë.

2.3. Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare

2.3.1. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera përmes arkës.

Referuar ditarit të bankës, rezultoi se ERRU, për kryerjen e pagesave të strukturës së vet në lidhje me dietat dhe shpenzimet e transportit, si brenda vendit ashtu edhe jashtë vendit, kryen tërheqje të mjeteve monetare cash nga bankat e nivelit të dytë, si në monedhën lekë ashtu edhe në valutë (euro dhe USD), të cilat depozitohen në kasafortën e institucionit, të quajtur “arkë”. Në aktivitetin e vet, ERRU nuk arkëton të ardhura, pasi pagesat për shërbimet që ofron depozitohen pranë bankave të nivelit të dytë nga subjektet Ujësjiellës Kanalizime.

Pra ERRU ka krijuar një “arkë” vetëm për shpenzime kryesisht për dieta brenda vendit dhe jashtë vendit.

Nga auditimi rezultoi se:

Nga auditimi rezultoi se ERRU ka kryer pagesa në cash për dieta dhe shpenzime transporti për udhëtime brenda vendit, si dhe ka realizuar veprime me arkën në monedha Lekë, Euro dhe USD për paradhënie në cash për shpenzime udhëtimi dhe dieta, brenda dhe jashtë vendit.

Për periudhën objekt auditimi, konkretisht më datë 31.10.2025, gjendja e arkës rezultoi në vlerën 257,103 lekë dhe 2,733 euro. Gjithashtu, rezultoi se personat e autorizuar të ERRU kanë tërhequr mjete monetare cash nga bankat e nivelit të dytë dhe i kanë depozituar në arkën e institucionit, konkretisht në 6 raste në shumën totale 1,402,468 lekë, në 12 raste në shumën totale 24,458 euro dhe në 3 raste në shumën totale 1,565 USD.

Nga verifikimi rezultoi se gjendja cash e mjeteve monetare (Lekë, Euro, USD), pas realizimit të transaksioneve, nuk është depozituar në llogaritë e institucionit pranë bankave të nivelit të dytë, por është mbajtur në arkë, duke u ruajtur si gjendje e akumuluar

Gjithashtu, rezultoi mungesë e një rregulloreje të brendshme për administrimin e arkës dhe mosrespektim i limiteve ditore/javore të saj, si dhe kryerja e pagesave për dieta dhe transport brenda vendit jo nëpërmjet bankave të nivelit të dytë.

Për veprimet apo mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi znj. F.I në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. S.Ç në cilësinë e nëpunësit zbatues

Nga Akt verifikimi rezultoi se:

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit, “Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare”, grupi i auditimit të KLSH-së, në prani të përfaqësuesve të ERRU-së: znj. S.Ç, në cilësinë e Drejtoreshës së Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse; znj. E.P, specialiste finance pranë së njëjtës drejtori; si dhe znj. H.I, specialiste pranë Drejtorisë Juridike dhe të Konsumatorit, e ngarkuar me mbajtjen e arkës së institucionit, kreu verifikimin fizik të arkës më datë 13.11.2025, duke mbajtur Akt-verifikimin nr. 1, datë 13.11.2025, nga i cili rezultoi se gjendja faktike më datë 13.11.2025 ishte si më poshtë:

1. Gjendje cash në lekë: 256,400 lekë.
2. Gjendje cash në valutë: 1,513 euro

Gjendja e arkës 01.01.2024-31.10.2025

Veprimet e kryera nga ERRU dhe gjendja e arkës, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Lekë						
Viti	Gjendja në fillim	Numri i veprimeve Debi	Debi	Numri i veprimeve Kredi	Kredi	Gjendja në fund
2024	254,499	2	500,000.00	119	611,640.00	142,859.00
01.01.2025-31.10.2025	142,859	4	902,468.00	136	788,224.00	257,103.00

Euro						
Viti	Gjendja në fillim	Numri i veprimeve Debi	Debi	Numri i veprimeve Kredi	Kredi	Gjendja në fund
2024	780	6	18,110.00	61	17,403.00	1,486.59
01.01.2025-31.10.2025	1,487	6	6,348.10	30	5,101.25	2,733.44

USD						
Viti	Gjendja në fillim	Numri i veprimeve Debi	Debi	Numri i veprimeve Kredi	Kredi	Gjendja në fund
2024	-	-	-	-	-	-
01.01.2024-30.10.2025	-	3	1,565.00	5	1,565.00	-

Dieta brenda vendit

Në funksion të realizimit të misionit të ERRU dhe detyrimeve ligjore në fuqi, stafi administrativ dhe anëtarët e KKRR për periudhën objekt auditimi mbi bazën e vendimit nr. 997, date 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar kanë përfituar trajtim financiar sic paraqitet në tabelën nr.1. Aneksi 2

Dieta jashtë vendit

Në funksion të realizimit të misionit të ERRU dhe detyrimeve ligjore në fuqi, stafi administrativ dhe anëtarët e KKRR për periudhën objekt auditimi mbi bazën e Udhëzimit nr.22, datë 10.07.2013 “ Mbi zbatimin e vendimit nr.870, datë 14.12.2011 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” kanë përfituar trajtim financiar sic paraqitet në tabelën nr.1. Aneksi 2

Nga auditimi i dokumentacionit shoqërues dhe praktikës së pagesës së dietave brenda vendit rezultoi se:

Në të gjitha urdhërat e pagesës për stafin e ERRU, që kanë përfituar trajtim financiar për shërbime jashtë qendrës së punës brenda vendit, mungonte autorizimi përkatës i titullarit të institucionit, ku duhej të përcaktohej koha e zgjatjes së shërbimit dhe qëllimi i tij.

Ky veprim është në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar, pika V, germa a.ii), ku parashikohet se:

“Titullari i institucionit qendror për shërbime në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës. Në autorizim përcaktohen koha e zgjatjes së shërbimit dhe qëllimi i tij. Titullarë institucioni qendror, në kuptim të këtij vendimi, janë: a) Për njësitë e qeverisjes qendrore: ii) për aparatet e Presidencës, të Kuvendit, të Këshillit të Ministrave, të enteve kushtetuese, si dhe për institucionet në varësi të Kryeministrit, sekretari i përgjithshëm përkatës.”

Gjithashtu, sipas Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 12, pika 3, nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen para nëpunësit autorizues përkatës për garantimin, para miratimit, të shkresave/urdhrave me karakter financiar, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit. Në rastin konkret, nëpunësit zbatues kanë pranuar dhe urdhëruar pagesat pa dokumentacion të plotë dhe të autorizuar sipas VKM nr. 997, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar.

Si pasojë, vlera totale 1,374,655 lekë përbën përdorim të fondeve të ERRU pa efektivitet, duke mos respektuar parimet e përdorimit me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike.

Ngarkohet me përgjegjësi z. N.SH, znj. G.L në cilësinë e titullarit të institucionit për periudhën respektive brenda periudhës së auditimit dhe znj. S.Ç në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Nga auditimi rezultoi se:

1. Për udhëtimet brenda vendit, strukturat përgjegjëse të ERRU kryejnë pagesat cash në lekë nëpërmjet arkës së institucionit dhe jo në llogaritë bankare të personave përfitues përkatës.
2. ERRU nuk ka hartuar dhe miratuar rregullore të veçantë për administrimin e vlerave monetare, në drejtim të përcaktimit të limiteve ditore, javore dhe mujore të mbajtjes së mjeteve monetare në lekë dhe në valutë.
3. Gjithashtu, nuk janë përcaktuar rregulla për ruajtjen dhe sigurinë fizike të këtyre vlerave brenda ambienteve të ERRU.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten lëvizjet e monedhës në lekë për periudhën objekt auditimi në cash nga banka në arkën e institucionit.

Tabela nr.1 Tërheqje nga Banka dhe depozitim në arkën e institucionit.

Viti 2024

Arka	Datë	Përshkrim	Vlera (lekë)
Lekë	01.01.2024	gjendje me 01.01.2024	254,499.00
	4.11.2024	tërheqje cash	200,000.00
	10.11.2024	tërheqje cash	300,000.00
totali			754,499.00

Tabela nr.2. Tërheqje nga Banka dhe depozitim në arkën e institucionit.

Viti 2024

Arka	Datë	Përshkrim	Vlera (euro)
Euro	01.01.2024	gjendje me 01.01.2024	779.59
	11/04/2024	tërheqje euro	3,000.00
	22/04/2024	tërheqje euro	4,000.00
	11/10/2024	tërheqje euro	4,000.00
	14/11/2024	tërheqje euro	3,000.00
	27/11/2024	tërheqje euro	4,000.00
totali			18,779.59

Tabela nr.3. Tërheqje nga Banka dhe depozitim në arkën e institucionit (01.01.2025-30.10.2025)

Arka	Datë	Përshkrim	Vlera (lekë)
Lekë	01.01.2025	gjendje me 01.01.2025	142,859.00
	17/02/2025	terheqje cash	300,000.00
	29/05/2025	terheqje cash	300,000.00
	22/10/2025	terheqje cash	300,000.00
totali			1,042,859

Tabela nr.4. Tërheqje nga Banka dhe depozitim në arkën e institucionit. (01.01.2025-30.10.2025)

Arka	Datë	Përshkrim	Vlera (euro)
EURO	01.01.2025	GJENDJE ME 01.01.2025	1,487
	17/02/2025	TERHEQJE CASH	4,000
	24/02/2025	TERHEQJE CASH	201
	29/10/2025	TERHEQJE CASH	2,000
Totali			7,687

Tabela nr.5. Tërheqje nga Banka dhe depozitim në arkën e institucionit. (01.01.2025-30.10.2025)

Arka	Datë	Përshkrim	Vlera (USD)
USD	01.01.2025	GJENDJE 01.01.2025	
	11/09/2025	TERHEQJE Cash	1,360
	09/10/2025	TERHEQJE Cash	185
	22/10/2025	TERHEQJE Cash	20
Total			1,565

Gjendja e bankës për periudhën objekt auditimi:

Viti	Gj. në fillim	Nr. i Debi	Debi	Nr. Kredi	Kredi	Gjendja në fund	Banka
2024	91,226,763.61	41	52,231,136.00	425	55,699,179.63	87,758,719.98	Raiffeisen. ALL
01.01.2025-31.10.2025	87,758,719.98	24	45,125,910.00	196	37,879,487.45	95,005,142.53	
2024	713,357.01	-	-	37	695,046.83	18,310.18	Raiffeisen Kartë Krediti ALL
01.01.2025-31.10.2025	18,310.18	5	1,035,617.57	59	544,254.11	509,673.64	
2024	-	16	19,241,106.33	52	4,879,444.25	14,361,662.08	BKT ALL
01.01.2025-31.10.2025	14,361,662.08	15	53,399,639.00	143	14,158,906.53	53,602,394.55	

Inventarizimi periodik i aktiveve dhe materialeve – Viti 2024

Inventarizimi periodik vjetor i aktiveve dhe materialeve për vitin 2024 në ERRU është kryer mbi bazën e Urdhrit nr. 104 prot., datë 18.12.2024, të Titullarit të Institucionit, “Për inventarizimin fizik dhe vlerësimin e aktiveve dhe materialeve për vitin 2024”.

Komisioni i Inventarizimit përbëhej nga znj. F.B (Kryetare) dhe znj. E.XH dhe z. E.S (Anëtarë). Procesi i inventarizimit nga komisioni i sipërcituar u krye nga data 30.12.2024 – 06.01.2025. Komisioni kreu inventarizimin fizik, verifikimin e gjendjes faktike të aktiveve dhe materialeve, si dhe krahasimin e tyre me të dhënat kontabël, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Në përfundim të procesit, Komisioni ka hartuar Relacionin nr. 24 prot., datë 13.01.2025, nga i cili rezultoi se: Nga krahasimi i të dhënave të regjistruara në kontabilitet me gjendjen faktike të aktiveve dhe materialeve nuk evidentoi diferenca, pra nuk rezultoi teprica apo mungesa;

Sipas relacionit të sipërcituar, asetet dhe materialet e inventarizuara rezultuan të rregullta, funksionale dhe në gjendje të përshtatshme për përdorim; Komisioni i ngritur për inventarizimin periodik nuk ka bërë propozime për nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve. Bazuar në sa më sipër, rezultoi se procesi i inventarizimit për vitin 2024 është realizuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi dhe nuk rezultoi mangësi apo shkelje në administrimin dhe evidentimin e aktiveve.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 18/2 Prot., datë 05.03.2026, protokolluar në KLSH me nr. 1052/10, datë 05.03.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

-Çdo shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, është kryer me miratim shërbimi.
- Mungesa e një dokumenti të veçantë të titulluar “Program Pune” nuk ka sjellë mungesë informacioni mbi qëllimin, përmbajtjen apo realizimin e shërbimit, si dhe nuk ka cenuar ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e pagesave të kryera...

Qëndrimi i grupit të auditimit

Nga subjekti i audituar nuk është përcjellë ndonjë dokumentacion i ri, i paaudituar më parë nga grupi i auditimit të KLSH-së, prandaj observacioni nuk merret në konsideratë.

2.4. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave

Forma e organizimit, struktura dhe organika e Entit Rregullator të Ujit rregullohen në përputhje me Ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”.

Si institucion i pavarur, i krijuar me ligj, struktura, organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës të nëpunësve të Entit Rregullator të Ujit miratohen me vendim të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

ERRU, si institucion i pavarur, i krijuar me ligj, struktura, organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës të nëpunësve janë miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Vendimin nr. 33/2022, datë 14.04.2022, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Entit Rregullator të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura”

Në përbërje të Entit Rregullator të Ujit bëjnë pjesë: 1 (një) Kryetar Komisioni, 4 (katër) anëtarë të Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR), 1 (një) Sekretar i Përgjithshëm, 1 (një) Sekretar i Komisionit dhe Kryetarit, si dhe Drejtoria Tekniko-Ekonomike, Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.

Në total, struktura e ERRU-së përbëhet nga 29 punonjës, përkatësisht:

- 1 Kryetar Komisioni;
- 4 Anëtarë të Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR);
- 1 Sekretar i Përgjithshëm;
- 1 Sekretar i Komisionit dhe Kryetarit;
- 9 punonjës në Drejtorinë Tekniko-Ekonomike;
- 5 punonjës në Drejtorinë Juridike dhe të Konsumatorit;
- 8 punonjës në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.

Struktura organizative dhe organigrama paraqiten figurën nr.1 aneksi 4.

Për vitin 2024, struktura faktike përbëhet nga 25 punonjës.

Në Tabelën nr. 1, Aneksi 4, paraqitet struktura dhe organika sipas drejtorive dhe sektorëve për vitin 2024, nga ku rezultoi se struktura është e paplotësuar me 4 vendeve, përkatësisht:

- 1 vend për anëtar të KKRR-së;
- 1 vend në Drejtorinë Tekniko-Ekonomike;

- 1 vend në Drejtorinë Juridike dhe të Konsumatorit.
- 1 vend në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.

Nga auditimi rezultoi se

-Struktura dhe organika e ERRU-së janë në përputhje me Ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”.

-Komisioni ka përcaktuar rregullat për punësimin e stafit profesionist dhe organizimin e tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi, konkretisht me Ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe Rregulloren e brendshme “Për rekrutimin, vlerësimin dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës në Entin Rregullator të Ujit”.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve realizohet në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse të cilat përcaktojnë kriteret e punësimit, të miratuara më pas nga KKRR-ja. Ndjekja e procedurave për plotësimin e vendeve vakante është përgjegjësi e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.

Vendimet e KKRR të vitit 2024 për plotësimin e vendeve vakante të punës, paraqiten në aneksin nr.4.

Zbatimi i dispozitave ligjore dhe nënligjore në fushën e marrëdhënieve të punës dhe pagave

I. Administrimi dhe realizimi i fondit të pagave

Për periudhën ushtrimore nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, në përputhje me planifikimin buxhetor të miratuar për vitin financiar 2024, fondi i pagave është realizuar në masën 87.19% të planit vjetor. Konkretisht, nga fondi i planifikuar në vlerën 47,252,500 (dyzet e shtatë milionë dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë, janë realizuar shpenzime në vlerën 41,198,065 (dyzet e një milionë njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëdhjetë e pesë) lekë. Si rrjedhojë, rezultoi një mosrealizim i planit buxhetor të fondit të pagave në vlerën 6,054,435 (gjashtë milionë e pesëdhjetë e katër mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekë.

Mosrealizimi i plotë i fondit të pagave reflektohet në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe në klasën e shpenzimeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, të cilat, për nga natyra e tyre, ndjekin paralelisht nivelin e ekzekutimit të pagave, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për kontributet e detyrueshme.

II. Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e planit buxhetor

Nga shqyrtimi i dokumentacionit administrativ dhe financiar rezultoi se mosrealizimi i planifikuar i fondit të pagave dhe i kontributeve shoqërore e shëndetësore lidhet kryesisht me faktorë objektivë, të cilët përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- ekzistencën e vendeve vakante në strukturën organike të institucionit për periudha të caktuara gjatë vitit ushtrimor;
- mosplotësimin e menjëhershëm të këtyre pozicioneve, për shkak të procedurave administrative të rekrutimit dhe lëvizjeve të personelit;
- ndryshimet e dinamikës së numrit të punonjësve gjatë vitit, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në nivelin e shpenzimeve për paga dhe sigurime.

Këta faktorë kanë sjellë krijimin e fondeve të pashpenzuara në raport me planifikimin fillestar, pa cenuar zbatimin e detyrimeve ligjore ndaj punonjësve aktualë.

III. Ndikimi i ndryshimeve ligjore në strukturën e pagave

Gjatë vitit 2024 kanë hyrë në fuqi ndryshime në kuadrin ligjor dhe nënligjor që rregullon sistemin e pagave në administratën publike, të cilat parashikojnë rritje page për kategori të caktuara të punonjësve.

Megjithatë, nga verifikimi i praktikave buxhetore rezultoi se nuk është paraqitur kërkesë për rishikim ose shtesë të planit buxhetor pranë autoriteteve kompetente për buxhetimin e vitit 2024. Kjo është justifikuar nga fakti se efektet financiare të këtyre ndryshimeve janë mbuluar brenda fondeve ekzistuese, konkretisht nga fondet e krijuara si pasojë e mungesës së përkohshme të personelit në strukturën organike.

Në këtë kuadër, administrimi i fondit të pagave është realizuar duke respektuar parimin e disiplinës buxhetore dhe përdorimin eficient të burimeve financiare, pa krijuar detyrime shtesë për buxhetin e shtetit.

IV. Përdorimi i fondit të veçantë

Nga auditimi dhe verifikimi i përdorimit të fondit të veçantë rezultoi se ky fond është administruar dhe përdorur në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë krijimin, destinacionin dhe mënyrën e shpenzimit të tij.

Nuk rezultoi shkelje procedurale apo devijime nga qëllimi për të cilin është krijuar fondi i veçantë, si dhe nuk u evidentuan përdorime jashtë kriterëve të përcaktuara në kuadrin normativ përkatës.

Realizimi i shpenzimeve paga/sigurime shoqërore e shëndetësore për vitin 2024. lekë.

Në

Emërtimi i zërave të shpenzimeve	plani 2024	realizuar 2024	në %	pa realizuar 2024	në %
Fondi i pagave gjithësej	47,252,500	41,198,065	87.19	6,054,435	12.81
Paga me shtesa sipas organikës	45,002,384	39,236,252	87.19	5,766,132	12.81
Fondi i veçantë	2,250,116	1,961,813	87.19	288,303	12.81
Sigurime shoqërore	7,507,600	6,516,361	86.80	991,239	13.20

Realizimi i fondit të pagave (Për periudhën 01.01.2025 – 31.10.2025)

I. Administrimi dhe realizimi i fondit të pagave

Nga analiza e të dhënave të paraqitura në tabelën përmbledhëse të shpenzimeve për paga rezultoi se, për vitin buxhetor 2025, fondi i pagave gjithësej është planifikuar në vlerën 49,776,700 lekë, ndërsa shpenzimet faktike të realizuara për këtë zë arrijnë në shumën 36,224,880 lekë, ose 72.78% të planit vjetor.

Si pasojë, evidentohet një mosrealizim i fondit të pagave në vlerën 13,551,823 lekë, që përbën 27.22% të fondit të miratuar, çka tregon një nivel ekzekutimi nën pritshmëritë e planifikimit fillestar buxhetor.

Analiza mujore dhe periodike (4-mujore) tregon se:

- realizimi më i lartë i shpenzimeve është evidentuar gjatë 4-mujorit të dytë, me një total prej 14,638,060 lekë;
- ndërsa 4-mujori i tretë paraqet realizim të pjesshëm, për shkak të mungesës së të dhënave për muajt nëntor dhe dhjetor, duke reflektuar vetëm 7,875,289 lekë shpenzime të kryera.

Numri i punonjësve dhe fondi i pagave për vitin 2024 paraqitet në tabelën nr.2, aneksi 4.

II. Analiza e pagës me shtesa sipas organikës

Zëri kryesor i fondit të pagave, “Paga me shtesa sipas organikës”, është planifikuar në vlerën 47,406,384 lekë, nga të cilat janë realizuar 36,164,880 lekë, ose 76.27% e planit vjetor.

Mosrealizimi për këtë zë arrin në vlerën 11,241,504 lekë, duke përbërë komponentin kryesor të fondit të pashpenzuar.

Ky nivel mosrealizimi lidhet drejtpërdrejt me:

- mosplotësimin e plotë të strukturës organike gjatë gjithë vitit ushtrimor;
- ekzistencën e vendeve vakante për periudha të zgjatura;
- lëvizje të personelit dhe procedura rekrutimi që nuk janë përmbyllur brenda afateve të planifikuara.

Megjithatë, nga të dhënat rezultoi se për punonjësit aktivë detyrimet për paga dhe shtesa janë përmbushur rregullisht, pa krijuar vonesa apo detyrime të prapambetura.

III. Përdorimi i fondit të veçantë

Fondi i veçantë, i planifikuar në vlerën 2,370,319 lekë, është realizuar vetëm në shumën 60,000 lekë, ose 2.53% të planit vjetor, duke rezultuar me një mosrealizim prej 2,310,319 lekë.

Nga analiza rezultoi se:

- fondi është përdorur në mënyrë të kufizuar dhe vetëm për raste të veçanta;
- nuk evidentohet tejkalim apo përdorim jashtë destinacionit të miratuar;
- niveli shumë i ulët i realizimit tregon se nevoja reale për këtë fond ka qenë ndjeshëm më e ulët se planifikimi fillestar, çka sugjeron nevojën për rishikim më realist të këtij zëri në planifikimet buxhetore të ardhshme.

IV. Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore

Shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore janë planifikuar në vlerën 7,899,260 lekë, ndërsa janë realizuar 6,000,996 lekë, ose 75.97% e planit vjetor.

Mosrealizimi për këtë zë arrin në 1,898,264 lekë, dhe është drejtpërdrejt i lidhur me nivelin e realizimit të pagave, duke qenë se kontributet llogariten mbi bazën e pagës faktike.

Analiza e kësaj klase shpenzimesh tregon koherencë të plotë midis:

- realizimit të pagave;
- dhe nivelit të shpenzimeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore,

çka dëshmon korrektësi në përlllogaritjen dhe administrimin e detyrimeve ligjore për kontributet e punonjësve.

V. Konkluzion

Nga analiza e të dhënave financiare rezultoi se:

- fondi i pagave dhe sigurimeve është administruar pa tejkalim të planit buxhetor;
- mosrealizimi i rezultoit ka karakter objektiv dhe lidhet kryesisht me faktorë strukturorë të personelit;
- nuk evidentohet krijim i detyrimeve të prapambetura apo përdorim i fondeve jashtë qëllimit të miratuar.

Megjithatë, niveli i lartë i fondeve të pashpenzuara tregon nevojën për:

- përmirësim të procesit të planifikimit buxhetor;
- përafrim më realist midis strukturës organike dhe fondeve të alokuara;
- monitorim më të rregullt të dinamikës së punonjësve gjatë vitit.

I. Metodologjia e përlllogaritjes së numrit të punonjësve

Numri mesatar mujor i punonjësve është përcaktuar në bazë të raportit ndërmjet shumës së punonjësve të evidentuar për çdo ditë kalendarike të muajit dhe numrit total të ditëve kalendarike të muajit përkatës.

Numri mesatar vjetor është përlllogaritur si mesatare aritmetike e numrave mesatarë mujorë, e pjesëtuar me dymbëdhjetë muajt e vitit ushtrimor, në përputhje me praktikën standarde të raportimit financiar dhe statistikor.

II. Përmbajtja dhe klasifikimi i elementëve të listë-pagesave

Nga analiza e strukturës së tabelave rezultoi se elementët përbërës të listë-pagesave janë klasifikuar sipas natyrës së shpenzimit, si më poshtë:

- fondi i pagës bazë dhe shtesave mbi pagë, i cili përfshin pagën për punën e kryer, shtesat për vjetërsi në punë, për vështirësi, funksion, grada shkencore dhe elementë të tjerë të parashikuar nga legjislacioni në fuqi;
- shpërblimet suplementare të akorduara për rezultate të veçanta në punë ose për arsye të tjera të ligjshme;
- ndihmat financiare me karakter të menjëhershëm, të dhëna në raste të veçanta si fatkeqësi natyrore, lindje apo situata të tjera sociale;
- kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të llogaritura si detyrime të punëdhënësit dhe punëmarrësit;
- shpërblime të tjera të veçanta, të dhëna në përputhje me aktet normative përkatëse;
- tatimi mbi të ardhurat personale, i mbajtur dhe derdhur sipas legjislacionit fiskal.

III. Struktura e personelit dhe lëvizjet gjatë vitit

Sipas të dhënave përfundimtare, në fund të vitit 2024 numri faktik i punonjësve rezultoi 25 (njëzet e pesë), të ndarë sipas kategorive si më poshtë:

- drejtues: 7 (shtatë);
- specialistë me arsim të lartë: 16 (gjashtëmbëdhjetë);
- nëpunës të thjeshtë: 1 (një);
- punëtorë: 1 (një).

Gjatë periudhës raportuese janë evidentuar lëvizje të personelit, konkretisht:

- pranimi i 1 (një) drejtuesi dhe 2 (dy) specialistëve me arsim të lartë;
- largimi i 1 (një) drejtuesi dhe 2 (dy) specialistëve me arsim të lartë.

Këto lëvizje janë reflektuar në mënyrë të saktë në listë-pagesa dhe në pasqyrat përkatëse financiare.

Për vitin 2025 numri faktik i punonjësve rezultoi 29 (njëzet e nëntë).

IV. Verifikimi i saktësisë së listë-pagesave dhe dokumentacionit shoqërues

U krye krahasimi përmbledhës ndërmjet listë-pagesave mujore dhe urdhër-shpenzimeve përkatëse të pagesave të kryera. Nga ky verifikim rezultoi se nuk rezultoi mospërputhje apo pasaktësi në kryerjen e shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

Pagesat janë mbështetur në dokumentacion të plotë administrativ, përfshirë listë-prezencat, urdhër-shpenzimet dhe aktet e miratuara nga titullari i institucionit, duke garantuar gjurmueshmëri dhe transparencë të plotë të procesit të likuidimit.

V. Respektimi i kuadrit ligjor për caktimin e nivelit të pagave

Nga auditimi me përzgjedhje i listë-pagesave për periudhat raportuese të vitit 2024, u verifikua niveli i pagës për çdo punonjës, arsimimi sipas dokumentacionit përkatës, si dhe vjetërsia në punë në bazë të librezës individuale.

Nuk rezultoi mospërputhje ndërmjet nivelit arsimor, kategorisë së vendit të punës dhe funksionit të ushtruar, në raport me aktet e emërimit dhe kriteret ligjore në fuqi. Për rrjedhojë, niveli i pagave rezultoi i përcaktuar në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore përkatëse që rregullojnë sistemin e pagave në administratën publike.

VI. Përllogaritja e ndalesave dhe kontributeve të detyrueshme

Ndalesat për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe për tatimin mbi të ardhurat, janë përllogaritur dhe derdhur në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse. Përllogaritjet janë bërë

mbi bazën e pagës bruto dhe elementëve përbërës të saj, duke respektuar normat dhe përqindjet e përcaktuara nga legjislacioni fiskal dhe i sigurimeve shoqërore.

Nuk u evidentuan pagesa për orë jashtë kohës normale të punës gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe nuk rezultoi tejkalime të numrit të punonjësve të miratuar në strukturën organizative.

VII. Administrimi i regjistrit të pagave

Regjistri i pagave (libri i pagave) është mbajtur në mënyrë të rregullt dhe të përditësuar, duke reflektuar pagesat e kryera për secilin punonjës sipas periudhës së emërimit dhe kohëzgjatjes së marrëdhënieve të punës. Të dhënat e pasqyruara në regjister janë të rakorduara me listë-pagesat dhe dokumentacionin financiar shoqërues.

2.5. Mbi përputhshmërinë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen e zbatimit e kontratave

Në zbatim të pikës 5 të programit të auditimit, me objekt “Përputhshmëria në prokurimet e fondeve publike dhe zbatimi i kontratave”, u shqyrtua dokumentacioni i regjistrit të realizimit të prokurimeve për periudhën objekt auditimi, procedurat e përzgjedhura për auditim sipas analizës së riskut, ftesat për ofertë të hartuara nga NJP për procedurat e përcaktuara, sistemi elektronik i APP sipas kodit të marrë nga APP si auditues, dokumentacioni hard copy i OE të shpallur fitues dhe urdhërpagesat për kontratat e lidhura.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se, përgatitja e regjistrit të parashkimeve të prokurimeve është bërë mbi bazën e kërkesave të sektorëve/drejtorive për mallra dhe shërbime, si dhe mbi planin e investimeve të parashikuara për vitin përkatës.

Autoriteti Kontraktor ERRU gjatë vitit 2024 ka realizuar tetë procedura prokurimi me vlerë të vogël, me fond limit total prej 3,448,365 lekë pa TVSH dhe vlerë totale kontratash të lidhura 2,400,931 lekë pa TVSH.

Për periudhën 1 janar 2025 deri më 31 tetor 2025, ERRU ka realizuar pesë procedura prokurimi me vlerë të vogël, me fond limit 1,364,081 lekë dhe vlerë kontratash 497,664 lekë pa TVSH. Procedurat janë zhvilluar nga komisionet e ngritura për prokurimin me vlerë të vogël, duke u bazuar në Udhëzimin Nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.

Për periudhën 2024–2025, grupi i auditimit ka përzgjedhur shtatë procedura prokurimi për shqyrtim të detajuar.

Viti	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	OE i shpallur fitues
2024	Materiale Pastrimi	265030	197,000	XH...
	Kancelari	187141	161,000	I.O
	Pajisje kompjuterike	666000	511380	I.S.T
	Blerje pajisje informatike (monitorë dhe njësi qendrore)	153000	139000	G..
	Licenca software për server	750000	720000	A.I
2025	Materiale pastrimi	256,900	155,100	E.D.D
	Kancelari	193462	135000	L.D

1. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Materiale Pastrimi”

Bazuar në Urdhrin Nr. 3, datë 11.01.2024, titullari i autoritetit kontraktor ka ngritur komisionin për prokurimin me vlerë të vogël të përbërë nga: F.B, M.Z dhe B.B.

Përlllogaritja e fondit limit

-Në proces verbalit (pa nr. prot.) datë 12.02.2024 të KBVV, mbi bazën e kërkesave të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse nr.52 date 06.02.2024, pasqyrohet se KBVV ka marrë 3 (tre) oferta nga Operatorët e Ekonomik të mëposhtëm:

1. A.S.. 315,090 lekë

2. XH... 260,000 lekë
3. B.C.. 220,000 lekë

Komisioni i blerjeve të vogla mbi bazën e metodës së mesatarizimit të 3 (tre) ofertave ka përlogaritur FL për blerjen e materialeve të pastrimit në shumën prej **265,030 lekë**

KBVV me Proces Verbalin e datës 12.02.2024 (pa nr. prot.) ka argumentuar vendosjen e kriterëve të kualifikimit për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Urdhri i prokurimit

Titullari i AK ka nxjerr Urdhrin e Prokurimit Nr.15, datë 12.02.2024 për prokurimin me vlerë të vogël me objekt: “Blerje materiale pastrimi”.

-Në ftesën për ofertë Nr. 52/2 prot., datë 12.02.2024, data e zhvillimit të procedurës është përcaktuar data 14.02.2024, ora 10.00 në adresën www.app.gov.al

KBVV në proces verbalin e datës 14.02.2024, ka pasqyruar hapat e mdjekura që nga hapja e procedurës në Sistemin elektronik të APP dhe vlerësimin e ofertave të OE pjesëmarrës si më poshtë:

Operatori ekonomik	Vlera e ofruar (Lekë)
A..	155.000,00
B.K..	191.200,00
XH..	197.000,00
H..	198.000,00
P.G..	200.540,00
M..	207.770,00
B..	208.800,00
B.L..	217.800,00
B.C..	219.900,00
A.K	220.500,00
M.H	222.000,00
A..	224.200,00
E..	225.000,00
E.G	228.000,00
J..	229.000,00
N..	232.000,00
S.G..	234.760,00
A..	236.600,00
H.2..	238.000,00
O.M.M..	243.000,00
H.C..	245.000,00
A.D	250.000,00
O.H	252.000,00
P.A	254.000,00
M.M..	254.000,00
M.H	256.000,00

-KBVV mbi bazën e kriterit të çmimit më të ulët dhe plotësimit të kriterëve të vendosura nga AK ERRU, ka njoftuar OE A.. i renditur i pari me ofertën prej 155,000 lekë

-KBVV me proces verbalin e datës 15.02.2024 kalon tek OE i radhës pasi OE A.. u tërhoq për arsye të mungesës së një produkti, në vijim me PV e datës 16.02.2024 pas njoftimit të OE B.K edhe ky OE është tërhequr për mos plotësim të materialeve të kërkuara

KBVV me proces verbalin e datës 19.02.2024 pas njoftimit të OE të radhës XH... me vlerë të ofertës 197,000 lekë, e ka shpallur fitues pasi ky OE plotësonte kushtet e kërkuara në ftesë për ofertë.

Marrja në dorëzim

Komisioni i marrjes në dorëzim i ngritur mbi bazën e urdhrin nr.5 datë 11.01.2024 i përbërë nga M.Z, B.B dhe E.P.

Nga auditimi rezultoi se:

- Në përbërjen e komisionit të marrjes në dorëzim mungon përgjegjësi material, pra AK i ERRU ka vepruar në mospërputhje me udhëzimin nr.30 pika 43 ku parashikohet se:

Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tri veta, duke përfshirë edhe punonjës in me përgjegjësi materiale.

-Nga auditimi i dokumentacionit të administrua rezultoi se mungon flete hyrja e mallrave të nënshkruar nga përgjegjësi material.

Për veprimet dhe mosveprimet mbajnë përgjegjësi:

N.SH në cilësinë e kryetarit të AK të ERRU dhe nëpunësi zbatues znj. S.Ç

2. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Kancelari”

Bazuar në Urdhrin Nr. 3, datë 11.01.2024, Titullari i Autoritetit Kontraktor ka ngritur komisionin për prokurimin me vlerë të vogël të përbërë nga: F.B, M.Z dhe B.B.

Përlllogaritja e fondit limit

KBVV nëpërmjet proces verbalit (pa nr. prot.) datë 19.02.2024 mbi bazën e kërkesave ka marrë 3 (tre) oferta nga Operatorët e mëposhtëm:

1. L.D 173,722 lekë
2. I.. 188,879 lekë
3. GJ.K 198,821 lekë

Komisioni i blerjeve të vogla, mbi bazën e metodës së mesatarizimit të 3 (tre) ofertave ka përlllogaritur FL për blerjen e materialeve të kancelarisë në shumën prej 187,141 lekë

KBVV me Proces Verbalin e datës 19.02.2024 (pa nr. prot.) ka argumentuar vendosjen e kriterëve të kualifikimit për procedurën e prokurimit të sipërcituar

Urdhër i prokurimit

Titullari i AK ka nxjerr Urdhrin e Prokurimit Nr.20, datë 20.02.2024 për prokurimin me vlerë të vogël me objekt: “Blerje materiale kancelarie”.

- Në ftesën për ofertë Nr. 60/2 prot., datë 20.02.2024, data e zhvillimit të procedurës është përcaktuar data 22.02.2024, ora 09.00 në adresën www.app.gov.al

-Në proces verbalin e datës 22.02.2024 pasqyrohet hapja dhe vlerësimi i ofertave të OE pjesëmarrës, të paraqitur si më poshtë:

1. I.O 161,000 lekë
2. L.D 162,342 lekë
3. S.G 168,700 lekë
4. E.G 174,500 lekë

KBVV, mbi bazën e kriterit të vlerësimit të çmimit më të ulët dhe plotësimit të kriterëve të vendosura nga AK të ERRU, ka njoftuar OE I.O të renditur i pari si fitues me ofertën në shumën prej 161,000 lekë

Marrja në dorëzim

Komisioni i marrjes në dorëzim i ngritur mbi bazën e urdhrit nr.5 datë 11.01.2024, i përberë nga M.Z, B.B dhe E.P

Nga auditimi rezultoi se:

1. Në përbërjen e komisionit të marrjes në dorëzim nuk është përfshirë përgjegjësi material, pra AK ERRU ka vepruar në mospërputhje me udhëzimin nr.30 pika 43 ku parashikohet se:

Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tri veta, duke përfshirë edhe punonjës in me përgjegjësi materiale.

2. Mungon fletë hyrja e mallrave të nënshkruar nga përgjegjësi material.

Për veprimet dhe mosveprimet mbajnë përgjegjësi:

N.SH në cilësinë e kryetarit të AK të ERRU dhe nëpunësi zbatues znj. S.Ç

3. Procedura e prokurimit me objekt “Pajisje kompjuterike” - 2024

Bazuar në Urdhrin Nr. 3, datë 11.01.2024, Titullari i Autoritetit Kontraktor ka ngritur komisionin për prokurimin me vlerë të vogël të përbërë nga: F.B, M.Z dhe B.B.

Përlllogaritja e fondit limit

KBVV nëpërmjet proces verbalit (pa nr. prot.) date 25.10.2024 mbi bazën e kërkesave të drejtorisë së shërbimeve mbështetëse nr.369 date 10.10.2024 (pa nr. protokolli), kërkesë e miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm Znj. F.I në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor. KBVV ka marre 3 (tre) oferta nga Operatorët e mëposhtëm:

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi pa TVSH	Vlera pa TVSH	Çmimi pa TVSH	Vlera pa TVSH	Çmimi pa TVSH	Vlera pa TVSH
				A.C..		A..		B.T..	
1	Kompjuter (njësi qendrore)	copë	5	57,275	286,375	55000	275000	60000	300000
2	Aparat Fotografik	copë	1	114,550	114,550	115000	115000	70000	70000
3	Regjistrues zëri digjital	copë	1	11,600	11,600	38000	38000	12000	12000
4	Kufje me mikrofon për kompjuter/laptop	copë	3	9,135	27,405	3500			
5	Monitor 23.8"	copë	12	11,455	137,460	15600	10500	3500	10500
6	Telefon Fiks Portabel	copë	1	18,125	18,125	18000	187200	13000	156000
7	HDD i Jashtëm 4TB (external HDD)	copë	1	14,500	14,500	18000	18000	5000	5000
8	Projektor	copë	1	14,500	14,500	15000	15000	15000	15000
8	Projektor	copë	1	66,700	66,700	50000	50000	51500	51500
Vlera					676,715		708700		620,000
Vlera e mesatarizuar e tre ofertave e përlllogaritur nga Grupi I auditimit të KLSH								668.471.67	

KBVV në bazë të ofertave të marra nga 3 (tre) subjektet ka përlllogaritur fondin limit në vlerën 666,000 lekë

Nga auditimi rezultoi se:

- Nuk ka kërkesë nga sektori/specialisti i IT-së
- Mungon hartimi i specifikimeve teknike
- Ofertat janë marre në mungesë të specifikimeve teknike
- Nuk janë respektuar kërkesat e parashikuara nga AKSHI

Urdhër i prokurimit

Titullari i AK ka nxjerr Urdhrin e Prokurimit Nr.78, datë 28.10.2024 për prokurimin me vlerë të vogël me objekt: “Blerje pajisje informatike (monitorë dhe njësi qendrore)”.

Në ftesën për ofertë nr. 420 prot., datë 28.10.2024, zhvillimi i procedurës është planifikuar më datë 30.10.2024, ora 12:30, në platformën www.app.gov.al.

Ndër kriteret e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues, kërkohet që:

Të gjitha pajisjet të kenë garanci 2 (dy) vjet

-Në proces verbalin e datës 30.10.2024 pasqyrohet hapja dhe vlerësimi i ofertave nga OE pjesëmarrës si më poshtë:

Operatori ekonomik	Vlera e ofruar (LEK)
SH.G	378,900.00
J..	408,000.00
O.M.M..	432,000.00
I..	450,000.00
K.G..	469,800.00
G..	506,160.00
I.S.T	511,380.00
X.S..	533,000.00
E..	580,000.00
J.P.P..	583,333.00
J.SH..	589,000.00
I.S..	589,885.00
S.S	600,000.00
B.T..	605,000.00
O.H	612,000.00
J.O.T..	620,000.00
E..	628,700.00
S..	650,000.00
A.D..	650,000.00

Referuar PV të KBVV pas njoftimit të OE SH.G në shumën prej 378,900 lekë i renditur i pari, ky OE është tërhequr me argumentin “për arsye objektive” më pas është kalua tek OE J., i cili nuk u paraqit brenda afateve duke u skualifikuar nga KBVV.

Në datën 01.11.2024, KBVV njoftoj OE të radhës O.M.M., i cili u tërhoq për arsye objektive, më pas është kalua tek OE I., i cili u tërhoq për arsyen të përlogaritjes jo të saktë të ofertës, për të kaluar tek OE K.G., i cili u tërhoq për shkak të angazhimeve të tjera duke kaluar tek OE G., edhe ky OE u tërhoq me arsyetimin për shkak të mungesës së kohës për realizimin e procedurës.

Në përfundim, është shpallur fitues OE I.S.T në shumën prej 511,380.00 lekë.

Vlerësimi i dokumentacionit të OE të shpallur Fitues

KBVV me PV e datës 07.11.2024, shprehet se OE I.S.T paraqiti dokumentacionin e kërkuar konform kërkesave të AK të përcaktuar në ftesën për ofertë.

Nga auditimi rezultoi se:

Në dokumentacionin e shkruar (hard Copy) me nr. 369/1 prot., datë 08.11.2024 (protokoll i ERRU) nuk është paraqitur Oferta tekniko por vetëm ajo financiare duke mos përcaktuar llojin /brand-in/markën e pajisjeve të kërkuara dhe atyre të ofertuar për të përcaktuar gjurmën e auditit gjatë procesit të marrjes në dorëzim.

Pasi në bazë të specifikimeve teknike OE duhej të paraqiste katalogët përkatës të pajisjeve që plotësonin kërkesat minimale të kërkuar nga AK në Ftesën për ofertë.

Ngarkohen me përgjegjësi F.B, M.Z dhe B.B në cilësinë e anëtarëve të KBVV dhe znj. F.I në cilësinë e Titullarit të AK

Komisioni i marrjes në dorëzim

Titullari i AK me urdhrin nr.85 datë 08.11.2024 ka ngritur komisionin për verifikimin dhe marrjen në dorëzim pajisjeve informatike të përberë nga: A.M., E.P dhe F.B, të cilët me PV e

datës 11.11.2024 ka marrë në dorëzim pa pasqyruar verifikimin e specifikimeve teknike si marka/lloji/brandi duke mos mundur gjurmën e auditit

Ngarkohen me përgjegjësi A.M., E.P dhe F.B në cilësinë e anëtarëve të marrjes në dorëzim, duke vepruar në mospërputhje me nenin 107 pika 3 te VKM 285 datë 19.05.2021 “mbi rregullat e prokurimit publik” dhe Udhëzim nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 47, rekomandimin e APP nr. 2106 Prot. date 24.03.2021, ku rekomandohet që komisioni i marrjes në dorëzim, duhet të kërkojë nga kontraktuesi respektimin e termave të përcaktuara në dispozitat e kontratës, mbi kushtet e dorëzimit të mallit, duke administruar raporte apo proces verbale, si dhe çdo dokument tjetër, që shërben për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësisë apo garancisë që mallrat duhen të kenë, në momentin e dorëzimit pranë AK

4. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje pajisje informatike (monitorë dhe njësi qendrore)”- 2024

Bazuar në Urdhrin Nr. 3, datë 11.01.2024, titullari i autoritetit kontraktor ka ngritur komisionin për prokurimin me vlerë të vogël të përbërë nga: F.B, M.Z dhe B.B.

Përlllogaritja e fondit limit

KBVV nëpërmjet proces verbalit (pa nr. prot.) datë 27.11.2024 mbi bazën e kërkesave të drejtorisë së shërbimeve mbështetëse nr.457 date 25.11.2024 (pa nr. protokolli) të miratuar nga Sekretari i përgjithshëm. KBVV ka marrë 3 (tre) oferta për një njësi qendrore dhe 8 monitor 23.8” nga Operatorët e mëposhtëm:

1.I.S.T.. 146000 leke

2.B.T.. 164000 leke

3.A.C.. 148915 leke

N r	Përshkrimi	Njësi a	Sasi a	Çmimi pa TVSH	Vlera pa TVSH	Çmimi pa TVSH	Vlera pa TVSH	Çmimi pa TVSH	Vlera pa TVSH
				A.C..		A..		B.T..	
1	Kompjuter (njësi qendrore)	copë	1	57,275	57,275	55000	55000	60000	60000
2	Monitor 23.8"	copë	8	11,455	91,640	15600	124800	13000	104000
Vlera					148,915		179800		164,000
Vlera e mesatarizuar e tre ofertave e përlllogaritur nga Grupi I auditimit të KLSH								164,238.33	

KBVV në bazë të mesatarizimit të çmimeve të ofruara nga OE ka përlllogaritur FL në vlerën 153,000 lekë.

Nga auditimi rezultoi se:

-KVBB ka përdorur ofertat e procedurës se realizuar sipas ftesës për ofertë nr. 420 prot., datë 28.10.2024, të zhvilluar më datë 30.10.2024, ora 12:30, në platformën www.app.gov.al. me objekt “Blerje pajisje informatike”

-Oferta e OE A.. mbanë datën 17.10.2024 dhe sipas shënimit të vet OE ajo është e vlefshme për 20 ditë, pra deri me date 27.10.2024

-Përlllogaritja e FL është bere me oferta qe kane skaduar dhe nuk paraqesin studimin e tregut

-Nuk ka marrë për reference çmimin e kontratës se realizuar

-nuk ka marrë për baze specifikimet dhe çmimin e AKSHI

Urdhër i prokurimit

Titullari i AK ka nxjerr Urdhrin e Prokurimit me Nr.93, datë 02.12.2024 për prokurimin me vlerë të vogël me objekt: **“Blerje pajisje informatike (monitorë dhe njësi qendrore)”**.

Në ftesën për ofertë nr. 454/2 prot., datë 02.12.2024, zhvillimi i procedurës është planifikuar më datë 04.11.2024, ora 10:00, në platformën www.app.gov.al

Ndër kriteret e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues, kërkohet që:

Të gjitha pajisjet të kenë garanci 2 (dy) vjet

Me proces verbalin e datës 04.12.2024 pasqyrohet hapja dhe vlerësimi i ofertave nga OE pjesëmarrës ku kane marre pjese 7 OE duke shpallur fitues OE G.. ne vlerën 139000 lekë

Në dokumentacionin e dorëzuar OE fitues ka ofertuar njësi qendrore HP Pro Tower 290 G9 me serial number 4CE333DFK5 dhe monitor Acer 23.8 “ model KA24Ye

Komisioni i marrjes në dorëzim

Titullari i AK me urdhrin nr.85 datë 08.11.2024 ka ngritur komisionin për verifikimin dhe marrjen ne dorëzim pajisjeve informatike të përberë nga: A.M., E.P dhe F.B, të cilët me PV e datës 11.11.2024 ka marre ne dorëzim pa pasqyruar verifikimin e specifikimeve teknike si marka/lloji/brandi duke mos mundësuar gjurmën e auditit

Ngarkohen me përgjegjësi A.M., E.P dhe F.B në cilësinë e anëtarëve të marrjes në dorëzim, duke vepruar në mospërputhje me nenin 107 pika 3 te VKM 285 datë 19.05.2021 “mbi rregullat e prokurimit publik” dhe Udhëzim nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 47, rekomandimin e APP nr. 2106 Prot. date 24.03.2021, ku rekomandohet që komisioni i marrjes në dorëzim, duhet të kërkoj nga kontraktuesi respektimin e termave të përcaktuara në dispozitat e kontratës, mbi kushtet e dorëzimit të mallit, duke administruar raporte apo proces verbale, si dhe çdo dokument tjetër, që shërben për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësisë apo garancisë që mallrat duhen të kenë, në momentin e dorëzimit pranë AK

5. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Licenca software për server”

Bazuar në Urdhrin Nr. 3, datë 11.01.2024, titullari i Autoritetit Kontraktor, ka ngritur komisionin për prokurimin me vlerë të vogël të përbërë nga: F.B, M.Z dhe B.B.

Përlllogaritja e fondit limit

KBVV nëpërmjet proces verbalit (pa nr. prot.) datë 10.06.2024 mbi bazën e kërkesave të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse nr.191 datë 06.06.2024 (pa nr. protokolli) ka marrë 3 (tre) oferta nga Operatorët Ekonomik të mëposhtëm:

1. A.C.. 746,000 leke
2. K.. 741,500 leke
3. S.. 750,500 leke

Komisioni i blerjeve të vogla mbi bazën e metodës së mesatarizimit të 3 (tre) ofertave ka përlllogaritur FL për blerjen e licencave për server në shumën prej **750,000 lekë**

Nga auditimi rezultoi se:

1.Në përbërjen e KBVV nuk ka specialist të IT duke vepruar në mospërputhje me nenin 74 pika 2 të VKM 285, datë 19.05.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku parashikohet se: ... në përbërje të njësisë së prokurimit është detyrimisht, personi përgjegjës për prokurimin, dhe të paktën një specialist fushe, në rast se kërkohen njohuri të specializuara për objektin e prokurimit.

2. Mungon argumentimi i vendosjes së kriterëve për OE pjesëmarrës

3.Ofertat e operatorëve ekonomik të paraqitura për përlllogaritjen e fondit nuk kanë të përcaktuar se kë version të windows Server do të update me licencën përkatëse, pra oferta financiare është dhënë në mungesë të kërkesave të AK

4.Mungojnë specifikimet teknike

Urdhër i prokurimit

Titullari i AK ka nxjerr Urdhrin e Prokurimit me Nr.41, datë 11.06.2024 për prokurimin me vlerë të vogël me objekt: “Blerje dhe instalim licenca për sistem operativ Windows server standard”.

Në ftesën për ofertë nr. 191/2 prot., datë 11.06.2024, zhvillimi i procedurës është planifikuar më datë 13.06.2024, ora 10:00, në platformën www.app.gov.al.

Ndër kriteret e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues, kërkohet që:

1. Operatori Ekonomik të posedojë certifikatën ISO 9001:2015,
2. Të ketë të punësuar dy (2) specialistë të diplomuar në informatikë,
3. ku njëri prej tyre duhet të jetë i pajisur me certifikatën MCSE,
4. Të ketë edhe dy specialistë që të jenë të pajisur me certifikatë nga prodhuesi i serverëve.
5. Pra në total ka kërkuar 4 specialist IT që të jenë staf i OE.

Për vërtetimin e plotësimit të këtij kushti, OE duhet te paraqesë:

-Certifikatë/diplomën përkatëse në këtë fushë

-Listë pagesën për periudhën tre mujore nga data e hapjes së ofertës

Në proces verbalin e datës 20.06.2024, pasqyrohet hapja dhe vlerësimi i ofertave nga OE pjesëmarrës si më poshtë

Operatori ekonomik	Vlera e ofruar (lekë)
I..	650.000,00
J.P.P..	708.333,00
X.S..	719.000,00
A.I	720.000,00
J.O.T..	725.000,00
A..	729.000,00
S..	733.333,00

Referuar PV të sipërcituar, 3 (tre) OE të renditur të parët janë tërhequr për shkak të përlllogaritjes gabim të ofertës, më pas nga KBVV vendosi kalimin tek OE i renditur i katërti dhe njoftoj OE A.I si fitues në sistemin elektronik të APP, i cili më datë 20.06.2024, ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për këtë procedurë. KBVV shpalli fitues OE A.I në shumën 720,000 lekë.

Vlerësimi i dokumentacionit të OE i shpallur Fitues”

KBVV me PV e datës 21.06.2024, shprehet se OE A.I paraqiti dokumentacionin e kërkuar konform kërkesave të AK të përcaktuara në ftesën për ofertë.

Nga auditimi rezultoi se:

Në KBVV nuk ka specialist të IT, për vlerësimin e dokumentacionit teknik të dorëzuar PV i vlerësimit të dokumentacionit nuk është i plotë, pasi nuk pasqyron dokumentacionin e dorëzuar nga OE dhe kriteret që OE duhet të plotësoj.

-Diploma e z.D.T është e ciklit bachelor në fushën e inxhinierisë elektronike dhe komunikimit dixhital, nuk është në fushën e IT

-Diploma e z.M. D e ciklit bachelor është në fushën e inxhinierisë elektrike, profili automatizim i industrisë dhe Master profesional në Teknologji Informacioni

Për sa më lart, OE A.I duhej të skualifikohej për mosplotësim të kriterëve të veçanta

Për veprimet apo mos veprimet ngarkohen me përgjegjësi:

F.B, M.Z dhe B.B në cilësinë e anëtarëve të KBVV, z. N.SH në cilësinë e titullarit të AK

Lidhja e kontratës.

Pas shpalljes fitues nga KBVV, Titullari i AK z. N.SH me përfaqësuesin e A.I Z. D.T kanë lidhur kontratën nr.227 prot., datë 21.06.2024 me afat zbatimi 12 muaj.

Komisioni i marrjes në dorëzim

Titullari i AK z. N.SH me urdhrin nr.46 datë 21.06.2024 ka ngritur komisionin për verifikimin dhe marrjen në dorëzim të shërbimit të instalimit licenca për sistemin operativ Windows Server Standard me përbërjen: K.SH, E.P dhe B.B.

Komisioni nëpërmjet PV datës 28.06.2024, shprehet se shërbimi është në përputhje me faturën dhe në përputhje me sasitë dhe specifikimet teknike.

Nga ana e kontraktuesit në date 28.06.2024 është mbajtur një situacion punimesh mbi instalimin e licencave për sistemin operativ Windows server standard, ky situacion punimesh nuk është firmosur nga komisioni i marrjes në dorëzim, por as nga personi që ka kryer shërbimin për llogari të kontraktuesit.

Për veprimet mos veprimet ngarkohet me përgjegjësi K.SH, E.P, B.B në cilësinë e anëtarëve të marrjes në dorëzim, duke vepruar në mospërputhje me nenin 107 pika 3 te VKM 285 datë 19.05.2021 “mbi rregullat e prokurimit publik” dhe Udhëzim nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 47, rekomandimin e APP nr. 2106 Prot. date 24.03.2021, ku rekomandohet që komisioni i marrjes në dorëzim, duhet të kërkoj nga kontraktuesi respektimin e termave të përcaktuara në dispozitat e kontratës, mbi kushtet e dorëzimit të mallit, duke administruar raporte apo proces verbale, si dhe çdo dokument tjetër, që shërben për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësisë apo garancisë që mallrat duhen të kenë, në momentin e dorëzimit pranë AK

6. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Materiale Pastrimi”-2025

Bazuar në Urdhrin Nr. 7, datë 14.01.2025, titullari i autoritetit kontraktor ka ngritur komisionin për prokurimin me vlerë të vogël të përbërë nga: F.B, M.Z, J.B.

Përlllogaritja e fondit limit

KBVV nëpërmjet proces verbalit (pa nr. prot.) date 09.03.2025 mbi bazën e kërkesave te drejtorisë se shërbimeve mbështetëse nr.151 date 04.03.2025 ka përlllogaritur fondin limit mbi bazën e katalogut te Operatorit te Blerjeve te përqendruara dhe për arktikut e tjerë qe nuk gjendeshin ne katalog me çmimet e kontratës se realizuar ne vitin 2024. Për 32 artikujt kërkesë e drejtorisë së shërbimeve KBVV ka përlllogaritur shumen prej **241,000 leke**

Urdhër i prokurimit

Titullari i AK ka nxjerr Urdhrin e Prokurimit me Nr.41, datë 10.03.2025 për prokurimin me vlerë të vogël me objekt: “Blerje materiale pastrimi”.

-Me PV e datës 10.03.2025 KBVV ka bere argumentimin e kriterëve te kualifikimit për procedurën e blerjeve te materialit te pastrimit për vitin 2025.

Nga auditimi rezultoi se:

Në ftesën për ofertë Nr. 151/2 prot., date 10.03.2025, data e zhvillimit të procedurës është përcaktuar data 12.03.2025, ora 10.00 në adresën www.app.gov.al.

Në vijim të kriterëve AK ka kërkuar, e citoj:

-Te siguroj cilësi të lartë të mallrave dhe produkteve (profesionale) të cilat do të verifikohen nga komisioni i marrjes në dorëzim.

Por për realizimin e këtij kriteri (kërkesë) nuk është kërkuar certifikata te sigurimit te cilësisë nga prodhuesi ose mbajtësi i autorizuar i tregtimit, kriter i veçantë që do të shërbente ne sigurimin e cilësisë te produkteve te kërkuara sipas specifikimeve te kërkuara nga AK

Me proces verbalin e datës 12.03.2025 pasqyrohet hapja dhe vlerësimi i ofertave nga OE pjesëmarrës si me poshtë

Operatori ekonomik	Vlera e ofruar (Lekë)
E.D.D	155,100
B.L..	169,000
XH...	174,800
H...	179,000
K.G..	179,000
N.V	179,400
B..	185,000
B.K	185,890
O.T..	188,000
J..	188,000

Mbi bazën e kriterit te çmimit me te ulet dhe plotësimit te kriterëve te vendosura nga AK ERRU komisioni njoftoj fitues OE E.D.D me ofertën prej 155,100 leke. Pas njoftimit të fituesi OE i renditur i pari E.D.D ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar ne ftesën për ofertë cili është pasqyruar në PV e KBVV të mbajtur më datë 18.03.2025

Marrja në dorëzim

Komisioni i marrjes ne dorëzim i ngritur mbi bazën e urdhrit nr.28 date 14.01.2025 i përberë nga E.P, A.K, E.S

Nga auditimi rezultoi se:

Në përbërjen e komisionit te marrjes ne dorëzim mungon përgjegjësi material, pra AK ERRU ka vepruar ne mospërputhje me udhëzimin nr.30 pika 43 ku parashikohet se:

Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tri veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale.

-nga dokumentacioni i administrua mungon flete hyrja e mallrave te nënshkruar nga përgjegjësi material.

Për veprimet dhe mosveprimet mbajnë përgjegjësi:

F.I në cilësinë e kryetarit të AK të ERRU dhe nëpunësi zbatues S.Ç sipas përcaktimeve të nenit 12 pika 3/a e Ligjit te MFK (i ndryshuar)

7. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Kancelari” - 2025

Bazuar në Urdhrin Nr. 7, datë 14.01.2025, titullari i autoritetit kontraktor ka ngritur komisionin për prokurimin me vlerë të vogël të përbërë nga: F.B, M.Z dhe J.B.

Përllogaritja e fondit limit

KBVV nëpërmjet proces verbalit (pa nr. prot.) date 12.03.2025 mbi bazën katalogut te OBP dhe kontratës se realizuar me kete objekt prokurimi te vitit 2024

Komisioni i blerjeve te vogla mbi bazën e çmimeve per njësi te katalogut te OBP dhe kontratës se 2024 ka përllogaritur FL për blerjen e materialeve të kancelarisë ne shumen prej 191,500 lekë

KBVV me Proces Verbalin e datës 17.03.2025 (pa nr. prot.) ka argumentuar vendosjen e kriterëve te kualifikimit per procedurën e prokurimit te sipërcituar

Urdhër i prokurimit

Titullari i AK ka nxjerr Urdhrin e Prokurimit me Nr.20, datë 20.02.2024 për prokurimin me vlerë të vogël me objekt: “Blerje materiale kancelarie”.

Në ftesën për ofertë Nr. 160/2 prot., date 17.03.2025, data e zhvillimit të procedurës është përcaktuar data 19.03.2025, ora 11:00 në adresën www.app.gov.al

Me proces verbalin e datës 20.03.2025 pasqyrohet hapja dhe vlerësimi i ofertave nga OE pjesëmarrës

Mbi bazën e kriterit të çmimit me të ulet dhe plotësimit të kriterëve të vendosura nga AK ERRU komisioni njoftoj fitues OE L.D me ofertën prej 135,000 leke

Marrja në dorëzim

Komisioni i marrjes në dorëzim i ngritur mbi bazën e urdhrit nr.28 date 14.01.2025 i përberë nga E.P, A.K.. dhe E.S

Nga auditimi rezultoi se:

Në përbërjen e komisionit të marrjes në dorëzim mungon përgjegjësi material, pra AK ERRU ka vepruar në mospërputhje me udhëzimin nr.30 pika 43 ku parashikohet se:

Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tri veta, duke përfshirë edhe punonjës të përgjegjës material.

-nga dokumentacioni i administruar mungon flete hyrja e mallrave të nënshkruar nga përgjegjësi material.

Për veprimet dhe mosveprimet mbajnë përgjegjësi:

F.I në cilësinë e kryetarit të AK të ERRU.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 18/2 Prot., datë 05.03.2026, protokolluar në KLSH me nr. 1052/10, datë 05.03.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Në mënyrë të përmbledhur, ato konsistojnë në:

...Sa i takon ngritjes së komisioneve të marrjes në dorëzim, urdherat perkatese janë nxjerre nga Titullari i AK, ... dhe jo nga nëpunësi zbatues.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Për sa i përket pretendimit të nëpunësit zbatues lidhur me ngritjen e komisioneve, sqarojmë se në të gjithë materialin e auditimit, duke filluar nga Akt-Konstatimi, Projekt Raporti i Auditimit dhe Raporti Përfundimtar i Auditimit, përgjegjësia është adresuar ndaj nëpunësit autorizues përkatës të AK-së së ERRU-së.

Ndërkohë, përgjegjësia e nëpunësit zbatues lidhet me problematikat e rezultuara me problematikat e dokumentacionit vërtetues gjatë marrjes në dorëzim, mbi bazën e të cilit kryhet pagesa për OE kontraktues, prandaj observacioni nuk merret në konsideratë.

2.6. Të tjera, që lidhen me vlerësimin e rregullshmërisë në nxjerrjen e akteve të brendshme rregullatore, që i shërbejnë kryerjes së veprimtarisë së ERRU, si dhe çështje që mund të dalin gjatë auditimit.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se:

Metodologjia aktuale e tarifave është miratuar sipas vendimit të KKRR Nr 539, datë 30.12.2021.

Në sektorin e UK në Shqipëri operojnë 14 shoqëri rajonale UK publike dhe tre shoqëri UK (2025), shumica e tyre nuk mbulojnë Kostot e Operimit dhe Mirëmbajtjes. Në kuadër të reformës për përmirësimin e performancës së sektorit shumë shoqëri po përmirësojnë

performancën e tyre dhe po synojnë që të mbulojnë nevojat për investime fizike në sisteme me anë të burimeve të veta financiare, pra nëpërmjet tarifave të shërbimeve që ato aplikojnë për klientët.

Shoqëritë rajonale UK deri tani në aplikimin e tyre për tarifa pranë ERRU-së kanë synuar kryesisht mbulimin deri në 100% të kostove të operim mirëmbajtjes. Një numër mjaft i vogël shoqërish kanë synuar që të mbulojnë me tarifa edhe një përqindje të kostove totale ku përfshihen edhe kostot e amortizimit, të interesave dhe të principalit të huave apo kredive të financuara nga donatorët e huaj.

Qëllimi i Metodologjisë është rregullimi efektiv i sektorit të ujësjellës kanalizimeve në Shqipëri dhe përmirësimi në periudhën afatmesme të qëndrueshmërisë financiare duke patur në konsideratë

Planifikimin tarifor

Vlerësimin e performancës

Mbrojtjen e klientëve nga çmimet monopol.

Shoqëritë UK që aplikojnë për Tarifa pranë ERRU's janë:

Shoqëritë e licensuara nga ERRU,

Shoqëritë që u mbaron afati i tarifave në fuqi/ Shoqëri pa tarifa të miratuara,

Shoqëritë që për shkaqe të jashtëzakonshme ndryshojnë kostot duke filluar me +/-5%

Te gjitha shoqëritë që aplikojnë për tarifa duhet të përmbushin kërkesat e përcaktuara në metodologji (dokumentacioni)

Dokumentacioni i Aplikimit për Tarifa; Kërkesa zyrtare, Pasqyrat financiare dhe Raporti i Ekspertit Kontabël, Plani 5 Vjeçar i Biznesit (i detyrueshëm vetëm për shoqëritë që mbulojnë 100% Kostot Operacionale, Modeli i Aplikimit, Organigramë me përshkrimet e punës së stafit, Aktmarrëveshjet e kredisë dhe plani i shlyerjes së kredive, Mendimi i Pushtetit Vendor, Vendimi i Këshillit të Administrimit. Procesverbali i Seancës Dëgjimore me Publikun, Subvencionet e përfituara nga Operatori, Lejet ose Autorizimet për përdorimin e ujit lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujor, Raport i gjendjes teknike dhe parashikimi për periudhën rregullatore, Raport analitik ekonomik dhe parashikimi për periudhën rregullatore, Raport i gjendjes teknike dhe ekonomike të shitjes së ujit me shumicë, Të ketë shlyer pagesën rregullatore, Deklarata për vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave

Aplikimi paraqitet pas miratimit të Bilancit Financiar Vjetor deri më 30 qershor dhe lejohet jo më shumë se një herë brenda vitit

Skema e Procesit të Miratimit të Tarifave është si më poshtë:

Përgatitja e propozimit për tarifa të reja nga Shoqëria UK

Aprovimi i propozimit për tarifa nga Këshilli i Administrimit të Shoqërisë

Mendimi i Këshillit Bashkiak për tarifën e propozuar

Aprovimi i prezantimit të Seancës Dëgjimore me Publikun dhe pjesëmarrja e ERRU në zhvillimin e saj

Dorëzimi i aplikimit sipas kërkesave të ERRU

Plotësim dokumentacioni kërkesa dhe sqarime të aplikimit (nëse ka)

Vendimi KKRR për fillimin e procedurës ose refuzim të aplikimit

Analiza nga Drejtoria Teknike Ekonomik

Paraqitja e Analizës në Komisionin Rregullator të ERRU

Dërgimi i P/Vendimi të KKRR për komente Shoqërisë, Aksionerëve dhe Autoritetit të Konkurrencës

Vendimi përfundimtar i KKRR për tarifën e propozuar

Publikimi i Tarifave të reja (30 ditë para zbatimit të tyre për klientët)

Afati maksimal i procedurës për miratimin e tarifave nga data kur aplikimi pranohet deri në vendimin përfundimtar për tarifën e propozuar nga Shoqëria nuk i kalon gjashtë (6) muaj.

Shoqëria paraqitet për të lidhur kontratën me ERRU, e cila përmban kushtet e pagesës rregullatore, dhe publikon tarifat e miratuara në faqen e saj në web dhe/ose në mënyra të tjera, brenda periudhës tridhjetë (30) ditore para se tarifat të hyjnë në fuqi.

Kriteret e Përgjithshme të Vlerësimit për metodologjinë e tarifave janë katër:

1-Mbulimi i Kostove të cilat përcaktohen në dy metoda:

Metoda e “Kostos Plus” në të cilën përfshihen shoqëritë të cilat nuk mbulojnë kostot e pranuar operacionale OM (OPEX Opex = Kosto për materiale, shërbime nga jashtë, paga dhe sigurime, taksat, të tjera), zbatohet për shoqëritë UK që aplikojnë për tarifa të reja dhe mbulojnë deri në 100% kostot e pranuar operacionale gjatë periudhës rregullatore të aprovuar nga KKRR.

Metoda e “Çmimit Tavan” në të cilën përfshihen shoqëritë të cilat arrijnë të mbulojnë kostot e pranuar operacionale OM dhe tentojnë drejt mbulimit të Kostove Kapitale Capex = Amortizim + Principal Fitim mbi investimin e shoqërisë, pra zbatohet për shoqëritë UK që kanë objektiv mbulimin 100% të Kostove Totale me të ardhurat e aktivitetit.

2. Vlerësimi i Performancës

Niveli i Treguesve Kryesorë të Performancës

Efikasiteti i Kostos

Cilësia e Informacionit

3. Përballueshmëria

Shpenzime mesatare mujore për Njësi Ekonomike Familjare (NJEF) - nga INSTAT

Përfshihen 10% e NJEF me shpenzime më të larta - “Familjet e pasura”

Fatura mujore e shërbimeve UK □ 5% shpenzimeve mesatare mujore për NJEF me 4 persona

4. Mbrojtja e Mjedisit

Ruajtja e burimeve ujore - tarifa më të larta për konsum mbi 150 l/ditë/person

Miratimi i tarifave nga ERRU për Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Lezhë SHA.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se:

UK Rajonale Lezhë është krijuar si shoqëri aksionare (datë 09.09.2022), me aksionarë MIE 51% dhe bashkitë Lezhë/Kurbin/Mirditë. Zona e shërbimit: këto 3 bashki.

Analiza Teknike-Ekonomike e Aplikimit për Ndryshimin e Tarifave për UK Rajonale Lezhë (Shkurt 2024) evidenton mospërputhje mes burimeve (plan biznesi/model aplikimi/raport teknik/licencim). Nga ana e ERRU janë përdorur të dhënat e INSTAT sipas të cilave korrigjon “popullsinë në juridiksion” dhe “të shërbyer” (p.sh. total 114,181 juridiksion; 71,636 të shërbyer; 62.7%).

Në dokument paraqiten tarifat ekzistuese (të trashëguara nga ish-UK) dhe tarifat e kërkuara nga shoqëria, të ndara sipas njësive (Lezhë, Kurbin, Mirditë/Rrëshen, Mirditë/Rubik) dhe kategorive (familjar/publik/privat), për:

Furnizim me ujë (lek/m³)

Kanalizime (lek/m³)

Tarifë fikse (lek/muaj/lidhje)

Përsa i përket procesit rregullator dhe konsultimit janë trajtuar shkresat e aplikimit/plotësimeve (viti 2023), seancat dëgjimore me publikun (datë 27.09.2023) dhe vendimi i KKRR për fillimin e procedurës së shqyrtimit (datë 10.11.2023). Këshillat Bashkiakë, Lezhë, Mirditë dhe Kurbin dhe konsumatorët gjatë seancave dëgjimore me publikun janë shprehur kundër planit tarifor të propozuar nga Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Lezhë.

Justifikimi i rritjes sipas shoqërisë argumentohet me mbulim kostosh O&M, harmonizim tarifash në gjithë zonën, rritje çmimesh materialesh, ulje e Ujit Pa të Ardhura (UPA), rritje e vazhdimësisë së furnizimit sidomos në Kurbin/Mirditë, investime në matësa/riparime/menaxhim rrjeti.

Më poshtë evidentohej faktorët kryesorë teknik (që ndikojnë drejtpërdrejt te tarifat)

Matja e prodhimit shumë e ulët: prodhimi vjetor 2022 rreth 13.65 milion m³, i matur vetëm rreth 16.3% → rekomandohet pajisje me ujëmatësa në burime dhe stacione pompimi.

UPA (Uji Pa të Ardhura) shumë i lartë: rreth 74.14% (niveli konsiderohet “i pa pranueshëm”), me humbje administrative + teknike shumë të mëdha; dokumenti e lidh këtë me lidhje të paligjshme, pasaktësi në vlerësime dhe rrjedhje në rrjet.

Infrastrukturë & të dhëna jo të besueshme në disa njësi: theksohet nevoja për verifikime në terren, saktësim asetesh (rrjete FU/KUN, burime, pompa), sidomos për Kurbinin dhe Mirditën. Nga verifikimi rezultoi se ERRU/KKRR nuk e pranon plotësisht planin e shoqërisë për tarifë të unifikuar në gjithë zonën; madje e quan “të parakohshëm” dhe e shtyn si objektiv për një stad tjetër aplikimi në të ardhmen.

Njëkohësisht ERRU propozon tarifa “më të moderuara” në disa njësi (sidomos Kurbin/Mirditë), duke e justifikuar me:

Përballueshmërinë dhe efektin në faturë (rritje 2–3 fish) dhe riskun e mos-pagesës

Koeficientin e ndër financimit (familjar dhe jo-familjar) që të mos kalojë 2

Opinionet negative të këshillave bashkiake dhe reagimet e publikut në seancat dëgjimore

Pranimin se me tarifat ERRU për 2024 mbulohen rreth 92% e O&M, pjesa tjetër duhet të mbulohet me subvencione.

Nga verifikimi dhe krahasimi i të dhënave rezultoi se Analiza Teknike-Ekonomike e Aplikimit për Ndryshimin e Tarifave për UK Rajonale Lezhë:

1) Identifikon “cilësinë e dobët të të dhënave” dhe e korrigjon bazën

ERRU nuk I merr “të mirëqena” shifrat e operatorit, por e evidenton mospërputhjet në popullsi/juridiksion dhe e korrigjon atë me INSTAT.

2) Vendimmarrja e ERRU lidhet me kriteret rregullatore/mbrojtje konsumatori

Argumentimi për “mos-kërcim ekstrem” dhe për koeficientin e ndër financimit tregon që vendimi nuk merret vetëm “për të mbushur koston”, por edhe për të respektuar kufizimet rregullatore dhe riskun social.

3) Trajton riskun e “elasticitetit të pagesës”

Pika që nëse fatura rritet shumë “reagimi pritet i fortë” dhe mund të përkeqësojë financat, është logjikisht e vlefshme dhe shpesh neglizhohet në aplikime tarifore.

4) Nxjerr në pah shkaqet strukturore të koston së lartë

Treguesi i UPA 74.14% dhe kosto mesatare e prodhimit 51.83 lek/m³ (e lidhur me humbjet) vendos fokusin te efienca, jo vetëm te rritja e tarifës.

5) Vendos objektiva performance (TKP) pas miratimit

Në rastin konkret jo vetëm “miratohen tarifat”, por edhe vendosen targete deri në fund 2025 (p.sh. UPA 65%, niveli i matjes 75%, vazhdimësia 19 orë/ditë, arkëtimi korrent 76%).

Në lidhje me argumentimin dhe rrjedhën logjike të vendimmarrjes:

1) “Përballueshmëria” përdoret si argument kyç, por nuk mbyll plotësisht riskun real

ERRU shprehet që fatura është brenda 5% (kriter), por vetë tregon që në disa njësi rritja e faturës mujore familjare është shumë e lartë në % (p.sh. Kurbin 100%, Rrëshen 70.8%, Rubik 84.6%).

Kriteri 5% është i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm. Një rritje 70–100% mund të jetë “brenda 5%”, por prapë të shkaktojë mos-pagesë (që dokumenti e pranon si risk).

2) Qëndrueshmëria financiare edhe varësia nga subvencioni

Argumentimi i vendimmarrjes paraqet një mospërputhje të brendshme, pasi nga njëra anë theksohet nevoja për performancë financiare, ndërsa nga ana tjetër pranohet se tarifat e miratuara nga ERRU për vitin 2024 mbulojnë vetëm rreth 92% të kostove O&M, duke e bërë të nevojshme mbështetjen me subvencione. Megjithatë kjo zgjedhje mund të arsyetohet në planin social, dokumentacioni nuk provon se është vlerësuar në mënyrë të plotë risku që lidhet me sigurimin në kohë dhe në masën e nevojshme të subvencionit. Mungesa e këtij vlerësimi lë të hapur riskun material të cenimit të likuiditetit dhe të qëndrueshmërisë financiare të shoqërisë.

3) Problemi kryesor teknik (UPA ekstrem) nuk “lidhet” me kushte të forta në vendim

ERRU e quan UPA “të papranueshëm” në Kurbin/Mirditë dhe pranon matje të prodhimit shumë të ulët; rekomandon ujëmatës në burime/stacione dhe verifikime në terren.

Vendimmarrja tarifore të ishte më “kushtëzuar”: p.sh. faza tarife të lidhura me prova konkrete (instalim matësash në burime, reduktim real i humbjeve, etj.). Në dokument kjo lidhje ekziston si objektiva (TKP), por jo qartë si mekanizëm kushtëzimi (nëse nuk arrihen → çfarë ndodh).

4) Argumenti “tarifat do financojnë riparime/instalim matësash” është i përgjithshëm. Shoqëria shprehet se tarifat e reja synojnë riparime, eliminim defektesh/lidhjesh të paligjshme, instalim matësash.

Ndërkohë që më e favorshme dhe e përshtatshme do të ishte një plan investimesh i “gjurmueshëm”, afate, kosto njësi, prioritete (ku fillon matja: burime apo klientë?), dhe lidhje me TKP. Dokumenti jep rekomandime dhe targete, por jo një “matricë investim → rezultat → verifikim” mjaftueshëm të argumentuar.

5) “Tarifa e unifikuar” refuzohet si e parakohshme – logjike, por kërkon më shumë provë për kriterin “kur bëhet e maturuar”

Përfundimi që unifikimi është i parakohshëm është i arsyeshëm duke parë kërcimin dhe kundërshtimet.

Por do ishte më e auditueshme nëse do përcaktonte “kushte maturimi” (p.sh. UPA nën X, matja e prodhimit 100%, arkëtim mbi Y, vazhdimësi mbi Z). Objektivat e 2025 janë një hap në këtë drejtim, por nuk lidhen eksplicitisht si “prag për unifikim”.

A ka lidhje logjike midis argumenteve/fakteve dhe vendimmarrjes përfundimtare?

Po, në pjesën kryesore ka lidhje logjike dhe rrjedhë:

Fakt: tarifat në Kurbin/Mirditë do bënin kërcim shumë të madh → Argument: risk mos-pagesë + reagim social → Vendim: ERRU ul tarifat krahasuar me propozimin e shoqërisë.

Fakt: këshillat bashkiakë dhe publiku janë kundër → Argument: legjitimitet/ndikim social → Vendim: merret në konsideratë në arsyetim.

Fakt: UPA dhe matja janë problem madhor → Argument: duhet fokus në humbje/matësia → Vendim/ndjekje: vendosen objektiva performance (TKP) deri 2025.

Por, lidhja logjike dobësohet në dy pika:

“brenda 5% përballueshmëri” përdoret si justifikim, ndërkohë që rritjet në % janë shumë të larta në disa zona (që vetë pranohet si problem për pagesën).

pranohet nevoja për subvencione (92% O&M) pa një analizë rreziku të subvencionit – pra vendimi financon “stabilitet të pjesshëm” dhe lë një boshllëk.

ERRU ka korrigjuar të dhënat, duke mos u mbështetur te shifrat e shoqërisë.

Vendimmarrja tarifore është ndërtuar mbi një bazë fillestare të pasigurt, çka përbën shkelje të parimit të vendimmarrjes mbi të dhëna të verifikuara, risk të lartë për gabime në projeksionet financiare.

Kjo përbën dobësi serioze të kontrollit të brendshëm të shoqërisë dhe mungesë verifikimi paraprak.

- Uji pa të ardhura (UPA) – problemi strukturor që neglizhohet në vendim

UPA raportohet 74.14%, nivel i cilësuar në dokument si “i papranueshëm”, megjithatë tarifa rritet, por shkaqet kryesore të UPA (matje e prodhimit 16.3%, rrjete të amortizuara, lidhje të paligjshme) nuk trajtohen me masa të detyrueshme.

Rritja e tarifave në kushtet e humbjeve ekstreme, mungesës së matjes reale, dhe pa garanci për përmirësim, transferon koston e keqmenaxhimit te konsumatori, në kundërshtim me parimin e ekonomicitetit.

Nga auditimi rezultoi se:

Vendimi tarifor nuk kushtëzohet me eliminimin e shkakut kryesor të koston.

- Përballueshmëria – përdorim formal, jo real

Dokumenti përdor kriterin “≤5% e të ardhurave familjare” për përballueshmërinë, por njëkohësisht pranon rritje shumë të larta relative:

Kurbin: ~100%

Rrëshen: ~70.8%

Rubik: ~84.6%

- Qëndrueshmëria financiare – kontradiktë në argumentim

Nga njëra anë, argumentohet nevoja për mbulim të kostove O&M dhe nga ana tjetër pranohet që tarifat e miratuara mbulojnë vetëm 92% të O&M, diferenca do mbulohet me subvencione.

Nuk evidentohet burimi i garantuar i subvencionit, mekanizmi i sigurimit, risku fiskal në rast mosfinancimi.

-Vendimi nuk garanton qëndrueshmëri financiare afatmesme, por thjesht shtyn problemin.

- Objektivat e performancës (TKP)

Vendosen objektiva deri në 2025:

UPA 65%, matja 75%, vazhdimësia 19 orë/ditë, arkëtimi 76%.

Objektivat janë pozitive në letër, por nuk lidhen me mekanizma ndëshkues ose korrigjues nëse nuk arrihen.

- TKP-të kanë karakter deklarativ, jo detyrues.

Konkluzion

Vendimi nuk i adreson në mënyrë proporcionale problemet strukturore.

Vendimarrja tarifore nuk mbështetet plotësisht në parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe qëndrueshmërisë financiare.

Rritja e tarifave miratohet në kushtet e humbjeve ekstreme, matjes së pamjaftueshme, të dhënave fillestare të pasigurta, dhe varësisë nga subvencione të pa garantuara.

Miratimi i tarifave nga ERRU për Shoqërinë Rajonale të Ujësjetës Kanalizime Durrës SHA.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se:

Shoqëria Rajonale Ujësjetës Kanalizime Durrës sh.a. (NUIS M..) është themeluar më 13.07.2022, si rezultat i bashkimit të ish-shoqërive UK Durrës, Shijak, Kavajë, Krujë dhe Rrogozhinë. Struktura e aksionerëve përbëhet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (51%) dhe bashkitë përkatëse: Durrës, Shijak, Kavajë, Krujë dhe Rrogozhinë .

Shoqëria operon në një zonë shërbimi shumë të madhe dhe heterogjene. Sipas analizës korrigjuese të ERRU bazuar në të dhënat e INSTAT 2022, popullsia në juridiksion është 338,824 banorë, ndërsa popullsia e shërbyer 292,464 banorë ose 86.3%. Diferencat mes njësive janë të theksuara: Durrës+Shijak kanë mbulim shumë të lartë, ndërsa Kruja dhe Rrogozhina mbulim dukshëm më të ulët .

Shoqëria është licencuar me vendimin e KKRR nr. 6, datë 22.02.2023 për të gjitha kategoritë: furnizim, përpunim uji, largim dhe trajtim ujërash të ndotura. Aktualisht aplikon tarifa të trashëguara nga ish-shoqëritë dhe ka paraqitur kërkesë për rishikim tarifor për shërbimet FU, KUN dhe tarifën fikse .

Nga pikëpamja teknike, prodhimi vjetor i ujit është rreth 55.7 milion m³, vetëm 78% e prodhimit është i matur, pjesa tjetër e vlerësuar, sistemi është kryesisht me ngritje mekanike, me konsum të lartë energjie, rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes përfshijnë segmente shumë të amortizuara (sidomos të ndërtuara para viteve 1990), evidentohet prani e konsiderueshme e lidhjeve të paligjshme si në transmetim ashtu edhe në shpërndarje, kapacitetet rezervuese janë të mjaftueshme në total, por jo të balancuara (njësia Krujë nuk mbulon kërkesën maksimale ditore).

Shoqëria argumenton se rishikimi tarifor është i nevojshëm për mbulimin e kostove operacionale, veçanërisht të energjisë, përballimin e rritjes së çmimeve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit.

Në lidhje me argumentimin e vendimmarrjes:

Analiza përmban informacion të hollësishëm për burimet e ujit, stacionet e pompimit, rezervuarët, linjat e transmetimit dhe rrjetet shpërndarëse, përfshirë gjendjen teknike dhe vitet e ndërtimit.

Korrigjim i të dhënave bazë nga ERRU

Dokumenti pranon qartë se të dhënat e popullsisë të paraqitura nga shoqëria nuk përkonin me realitetin dhe se ERRU ka kryer korrigjime bazuar në INSTAT dhe lidhjet aktive.

Pranim i hapur i dobësive strukturore

Analiza evidenton qartë: matje jo të plotë në burime dhe stacione pompimi, amortizim të lartë të rrjeteve, nivele të larta humbjesh dhe eficiencë energjetike që duhet marrë “me rezervë”.

Justifikim i arsyeshëm parimor për rishikimin tarifor

Argumentet e shoqërisë (kosto shumë e lartë e energjisë, rritje çmimesh/pagash, nevojë për riparime, reduktim humbjesh, instalim matësash) janë të kuptueshme dhe në përputhje me parimet rregullatore të mbulimit të kostove dhe qëndrueshmërisë financiare .

1. Vendimmarrje mbi një bazë prodhimi ende të pasigurt

Fakti që 22% e prodhimit të ujit është i vlerësuar dhe jo i matur përbën një dobësi themelore. Kjo ndikon drejtpërdrejt në bilancin e ujit, treguesit e eficiencës energjetike, llogaritjen reale të koston për m³ dhe të ardhurave të pritshme.

Tarifat po ndërtohen mbi një sistem që ende nuk matet plotësisht në pikat kyçe .

2. Rritje të ndjeshme tarifash në disa njësi pa lidhje të qartë me rezultate të garantuara
Në njësi si Kavajë, Krujë dhe Rrogozhinë parashikohen rritje të tarifave (FU, KUN dhe tarifë fikse). Dokumenti i justifikon këto me nevojë financiare, por nuk i lidh drejtpërdrejt me objektiva të matshme për përmirësim shërbimi në të njëjtat njësi dhe në afate konkrete.

3. Analiza e përballueshmërisë mbetet në nivel formal, edhe pse përballueshmëria përmendet si kriter, dokumenti nuk e zbërthen atë në mënyrë të diferencuar për njësi dhe kategori konsumatorësh, sidomos për zonat me mbulim më të ulët dhe infrastrukturë më problematike. Kjo e bën argumentin korrekt në formë, por jo të thelluar në përmbajtje.

4. Lidhja midis tarifës dhe investimeve mbetet e përgjithshme. Investimet e nevojshme për rrjetet e amortizuara, rezervuarët dhe matësat identifikohen qartë, por mungon një lidhje numerike dhe kohore: sa nga të ardhurat shtesë do të alokohen për secilin grup investimesh dhe kur priten rezultatet. Kjo dobëson logjikën “tarifë kundrejt përmirësimit”.

Analiza teknike: sistem shumë i madh, i fragmentuar, me kosto të larta energjie, rrjete të amortizuara dhe matje jo të plotë. Argumenti financiar për nevojë të rritjes së të ardhurave është logjik dhe në përputhje me kuadrin rregullator. Megjithatë, vendimmarrja tarifore duket se mbështetet më shumë në nevojën për stabilizim financiar sesa në një mekanizëm të qartë që e lidh tarifën me përmirësime të detyrueshme dhe të verifikueshme të performancës teknike dhe operacionale.

Vendimmarrje e arsyetuar në parim, por e dobët në zbatim, për shkak të mungesës së kushteve të matshme. Pika më problematike e dokumentit është mospërputhja midis shkallës së problemeve strukturore dhe mënyrës relativisht lineare me të cilën propozohet zgjidhja tarifore. Shoqëria operon një nga sistemet më komplekse në vend, me mbi 55 milion m³ prodhim vjetor, rrjete shumë të vjetra, humbje nga amortizimi dhe lidhje të paligjshme, si dhe matje ende jo të plotë në burime dhe stacione pompimi. Në këtë kontekst, rritja e tarifës shfaqet si mjet për të përballuar pasojat financiare të këtyre problemeve, por jo domosdoshmërisht si instrument që e detyron zgjidhjen e tyre. Nga këndvështrimi i interesit publik dhe auditimit të performancës, tarifa duhet të jetë një mekanizëm që “blen” rezultate të qarta (matje 100%, ulje humbjesh, rritje efience energjetike, barazim cilësie mes njësive), ndërsa në këtë dokument kjo lidhje mbetet më shumë e nënkuptuar sesa e garantuar.

Miratimi i tarifave nga ERRU për Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Shkodër SHA.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se:

Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a. (NUIS M..) është themeluar më 05.04.2023, si rezultat i bashkimit të ish-shoqërive UK Shkodër, Malësi e Madhe, Vau Dejës, Pukë dhe Fushë-Arrëz. Struktura e aksionerëve përbëhet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (51%) dhe bashkitë përkatëse (Shkodër, Malësi e Madhe, Vau Dejës, Pukë, Fushë-Arrëz).

Zona e shërbimit përfshin 334,968 banorë, ndërsa popullsia e shërbyer është 173,970 banorë, ose vetëm 52% e popullsisë në juridiksion. Mbulimi i shërbimit ndryshon ndjeshëm mes njërive: Shkodër 58%, Malësi e Madhe 57%, Vau Dejës 23%, Pukë 40% dhe Fushë-Arrëz 74%. Kjo tregon një shërbim të fragmentuar dhe me pabarazi të theksuara territoriale.

Shoqëria është licencuar nga ERRU për të gjitha kategoritë (furnizim me ujë, largim dhe trajtim të ujërave të ndotura). Aktualisht aplikon tarifa të trashëguara nga ish-shoqëritë, ndërsa ka paraqitur kërkesë për ndryshim të nivelit tarifor për periudhën 2025–2027, me synim unifikimin e tarifave, mbulimin e kostove O&M dhe përmirësimin e shërbimit.

Nga pikëpamja teknike dhe operacionale:

Prodhimi vjetor i ujit është 14.8 milion m³, pothuajse 100% i vlerësuar (vetëm disa burime kanë ujëmatës), UPA është 67.01%, një nivel shumë i lartë, Shoqëria faturon vetëm 32.98% të ujit të prodhuar, Sistemi është kryesisht me ngritje mekanike (78.1%), duke krijuar varësi të lartë nga energjia, Rrjeti i transmetimit (313 km) është në pjesën më të madhe i amortizuar, sidomos në njësitë Vau Dejës dhe Malësi e Madhe, Rreth 73.7% e lidhjeve janë të pajisura me ujëmatës në konsumator, por mungon matja në prodhim.

Në lidhje me vendimmarrjen:

1. Dokument i detajuar teknikisht

Analiza përmban përshkrim të thelluar të burimeve ujore, stacioneve të pompimit, rrjeteve të transmetimit, rezervuarëve dhe gjendjes së tyre teknike.

2. Pranim i hapur i problemeve strukturore

Dokumenti nuk i fsheh dobësitë kryesore: matje pothuajse inekzistente në prodhim, UPA shumë e lartë, amortizim i rrjeteve dhe pabarazi të theksuara mes njërive.

3. Argumentim parimor i nevojës për rishikim tarifash

Shoqëria rendit qartë arsyet: nevoja për tarifa të miratuara nga ERRU për gjithë zonën, mbulim mbi 100% të kostove O&M, rritje çmimesh/pagash, investime për përmirësim shërbimi, eliminim defektesh dhe instalim matësash. Këto argumente janë në përputhje me kuadrin rregullator.

4. Proces formal dhe ligjor i respektuar

Kërkesa, plotësimet, seancat dëgjimore, vendimet e këshillave bashkiakë dhe fillimi i procedurës nga KKRR janë të dokumentuara dhe në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore.

B) Dobësitë dhe risqet kryesore

1. Vendimmarrje mbi një bazë prodhimi pothuajse tërësisht të pamatur

Fakti që pothuajse 100% e ujit të prodhuar është i vlerësuar dhe jo i matur përbën dobësi themelore. Çdo tarifë që bazohet në kosto për m³ dhe projeksione të ardhurash mbart rrezik të lartë pasaktësie kur inputi kryesor nuk matet.

2. UPA ekstremisht e lartë dobëson logjikën e rritjes tarifore

Me 67% ujë pa të ardhura dhe vetëm 33% faturim, rritja e tarifës rrezikon të mbulojë pasojat financiare të humbjeve, pa garantuar reduktimin e tyre. Pa kushte performance, tarifa shndërrohet në mjet stabilizimi financiar dhe jo domosdoshmërisht në instrument reformues.

3. Rritje të ndjeshme tarifash në disa njësi me shërbim të dobët

Në njësi si Shkodër, Vau Dejës dhe Fushë-Arrëz, tarifat e propozuara për FU, KUN dhe tarifën fikse rriten ndjeshëm, ndërkohë që mbulimi dhe cilësia e shërbimit janë të ulëta, sidomos në zonat rurale. Dokumenti nuk e lidh qartë këtë rritje me përmirësime konkrete dhe të matshme në të njëjtat zona.

4. Analiza e përballueshmërisë mbetet formale

Edhe pse përballueshmëria përmendet si kriter, ajo nuk zbërthehet sipas njësive me mbulim të ulët dhe shërbim të dobët. Kjo e bën argumentin korrekt në formë, por jo të thelluar në përmbajtje.

5. Investimet e përmendura nuk lidhen drejtpërdrejt me të ardhurat shtesë

Dokumenti identifikon nevojat të mëdha investimi (rrjete, matje, stacione pompimi), por mungon një lidhje numerike dhe kohore: sa nga të ardhurat shtesë do të alokohen për secilën ndërhyrje dhe në çfarë afati.

3) A ka lidhje logjike midis argumenteve/fakteve dhe vendimmarrjes përfundimtare?

Analiza teknike është reale përse i përket: mbulim i ulët shërbimi, matje pothuajse inekzistente në prodhim, humbje shumë të larta dhe rrjete të amortizuara. Argumenti financiar për nevojë të rritjes së të ardhurave është logjik në parim. Megjithatë, vendimmarrja tarifore duket se mbështetet më shumë në nevojën për të siguruar qëndrueshmëri financiare sesa në një mekanizëm të qartë që e lidh tarifën me përmirësime të detyrueshme dhe të verifikueshme të performancës teknike dhe operacionale.

Ka mospërputhje midis shkallës së problemeve strukturore dhe rolit që i atribuohet tarifës si zgjidhje kryesore. Shoqëria operon një sistem ku pothuajse i gjithë prodhimi i ujit nuk matet, më shumë se dy të tretat e ujit nuk gjenerojnë të ardhura dhe rrjetet kryesore janë të amortizuara. Në këtë kontekst, rritja e tarifës shfaqet si mjet për të përballuar pasojat financiare të një sistemi të paeficient, por jo si instrument që e detyron transformimin e tij. Nga këndvështrimi i interesit publik, tarifa duhet të “blejë” rezultate të qarta dhe të verifikueshme (matje 100% në prodhim, ulje progresive të UPA, përmirësim real të shërbimit në zonat me mbulim të ulët). Në dokument, kjo lidhje mbetet më shumë e nënkuptuar sesa e garantuar, çka e bën vendimmarrjen tarifore të rrezikuar në efektivitetin e saj afatmesëm.

Miratimi i tarifave nga ERRU për Shoqërinë Rajonale të Ujësjetllës Kanalizime Berat SHA.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se:

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Berat sh.a. (NUIS M..) është themeluar më 04.11.2022, në zbatim të VKM nr. 302/2022, nga bashkimi i ish-shoqërive UK Berat, Dimal, Poliçan, Kuçovë dhe Skrapar. Aksionar kryesor është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (51%), ndërsa pjesa tjetër ndahet mes bashkive përbërëse.

Shoqëria operon në një zonë shërbimi me 228,654 banorë, nga të cilët 158,926 banorë furnizohen me ujë të pijshëm, ose 69.5% e popullsisë në juridiksion. Mbulimi ndryshon ndjeshëm ndërmjet njësive: Berat dhe Kuçovë rreth 75%, Skrapar mbi 80%, Poliçan rreth 69%, ndërsa Dimal vetëm 44.6%, çka tregon pabarazi territoriale në shërbim.

Shoqëria është e licencuar nga ERRU për:

Kategorinë A – furnizim dhe shpërndarje uji,

Kategorinë C – largim të ujërave të ndotura.

Nga pikëpamja teknike dhe operacionale, dokumenti evidenton:

Prodhim vjetor: 7.58 milion m³ ujë,

Vetëm 10.4% e prodhimit është i matur, ndërsa 89.6% i vlerësuar, për shkak të mungesës së ujëmatësve në burime,

UPA = 46.65%, pra gati gjysma e ujit që hyn në sistem nuk gjeneron të ardhura,

Faturimi total është 53.35% e prodhimit,

Rreth 90.6% e lidhjeve janë të pajisura me ujëmatës në konsumator,

Rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes janë në pjesën më të madhe të amortizuara, veçanërisht në njësitë Berat, Dimal dhe Kuçovë,

Sistemi është kryesisht me rrjedhje të lirë (67%), çka është pozitive për energjinë, por një pjesë e konsiderueshme e stacioneve të pompimit janë të vjetra dhe joeficiente.

Shoqëria ka paraqitur kërkesë për rishikim tarifash për shërbimet FU dhe KUN, me synim unifikimin e tarifave, mbulimin e kostove O&M dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit.

Në lidhje me vendimarrjen:

1. Dokument i detajuar teknikisht

Analiza përfshin informacion të hollësishëm për burimet ujore, rrjetet e transmetimit e shpërndarjes, stacionet e pompimit, rezervuarët dhe bilancin e ujit. Ky nivel detaji krijon bazë faktike për vlerësim dhe shmang analizën thjesht deklarative.

2. Pranim i qartë i problematikave reale

Dokumenti nuk i fsheh dobësitë kryesore: mungesën e matjes në prodhim, UPA të lartë, humbje reale dhe administrative, amortizim të aseteve dhe nevojë të lartë për investime. Ky realizëm rrit besueshmërinë e diagnozës teknike.

3. Procesi ligjor dhe rregullator është i respektuar

Kërkesa për tarifa, seancat dëgjimore në të gjitha bashkitë, mendimet e këshillave bashkiakë, kërkesat për informacion shtesë nga ERRU dhe vendimi për fillimin e procedurës janë të dokumentuara dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

4. Argumentimi parimor i nevojës për tarifa është koherent

Shoqëria lidh rishikimin tarifor me mbulimin mbi 100% të kostove operacionale, rritjen e çmimeve dhe pagës minimale, si dhe nevojën për investime për përmirësimin e shërbimit. Këto argumente janë të pranueshme në parim dhe në linjë me metodologjinë “Kosto Plus”.

Dobësitë dhe risqet kryesore

1. Vendimarrje mbi një bazë prodhimi kryesisht të pamatur

Fakti që gati 90% e ujit të prodhuar është i vlerësuar përbën dobësi thelbësore. Çdo vendim tarifor që mbështetet në kosto për m³ dhe projeksione të ardhurash është i ekspozuar ndaj pasaktësive kur inputi bazë nuk matet realisht.

2. UPA relativisht e lartë dobëson logjikën e rritjes tarifore Me 46.65% ujë pa të ardhura, ekziston rreziku që rritja e tarifës të përdoret kryesisht për të kompensuar humbjet, në vend që të shërbejë si instrument për reduktimin e tyre. Problemi evidentohet në argumentim, por vendimarrja tarifore nuk shoqërohet me kushte reale performance.

3. Rritje tarifash pa lidhje të drejtpërdrejtë me rezultate të matshme Tarifat e propozuara rriten në të gjitha njësitë, përfshirë zona ku mbulimi dhe cilësia e shërbimit janë më problematike (sidomos Dimal dhe zona rurale). Analiza nuk e lidh qartë këtë rritje me objektiva të detyrueshme për përmirësim konkret të shërbimit në të njëjtat zona.

4. Analiza e përballueshmërisë mbetet formale Edhe pse përballueshmëria trajtohet si kriter, ajo nuk zbërthehet në mënyrë të diferencuar sipas njësive dhe kategorive të konsumatorëve. Kjo e bën argumentin korrekt në formë, por jo plotësisht bindës në përmbajtje.

5. Shtyrja e afatit për shkak të mosplotësimit sipas metodologjisë Vetë dokumenti pranon se modeli i aplikimit nuk është plotësuar sipas kërkesave të metodologjisë, duke çuar në shtyrje të afatit të vendimarrjes deri në qershor 2025. Kjo dobëson besueshmërinë e bazës financiare mbi të cilën kërkohet ndryshimi tarifor.

Analiza teknike është e saktë: mungesë matjeje, humbje të larta, asete të amortizuara dhe nevojë për investime. Argumenti financiar për rritje të të ardhurave është logjik në parim. Megjithatë, vendimarrja tarifore nuk ndërtohet mbi një mekanizëm të qartë që e lidh tarifën me rezultate të detyrueshme dhe të verifikueshme (ulje UPA, matje në burime, përmirësim shërbimi). Nga këndvështrimi auditues, kjo e bën lidhjen fakt-vendim të arsyetuar në teori, por të pasigurt në zbatim.

Pika më problematike është mospërputhja midis thellësisë së problemeve strukturore dhe rolit që i atribuohet tarifës si zgjidhje kryesore. Shoqëria operon me një sistem ku shumica e prodhimit nuk matet, gati gjysma e ujit nuk gjeneron të ardhura dhe asetet kryesore janë të amortizuara. Në këtë kontekst, rritja e tarifës rrezikon të shërbejë më shumë për stabilizim

financiar sesa për transformim real të performancës. Nga perspektiva e interesit publik, tarifa duhet të jetë instrument që “blen” përmirësime të matshme (matje 100% në prodhim, ulje graduale të UPA, përmirësim të shërbimit në zonat më të dobëta). Në dokument, kjo lidhje mbetet kryesisht e supozuar dhe jo e garantuar, duke krijuar rrezik që vendimmarrja tarifore të mos prodhojë efektet e pritshme afatmesme.

Miratimi i tarifave nga ERRU për Shoqërinë Rajonale të Ujësjetllës Kanalizime Berat SHA.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se:

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a. (NUIS M..) është themeluar më 22.09.2022, në zbatim të VKM nr. 302/2022, nga bashkimi i ish-shoqërive UK Elbasan, Librazhd, Gramsh, Peqin, Cërrik dhe Belsh. Aksioneri kryesor është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (51%), ndërsa pjesa tjetër ndahet mes bashkive përbërëse.

Zona e shërbimit përfshin 409,355 banorë, ndërsa popullsia e shërbyer është 258,919 banorë, ose rreth 63.25% e juridiksionit. Mbulimi i shërbimit ndryshon ndjeshëm: Elbasan ~74%, Cërrik ~62%, Gramsh ~59%, Belsh ~59%, Peqin ~45%, ndërsa Librazhd vetëm 35.7%, duke reflektuar pabarazi të theksuara territoriale.

Shoqëria është e licencuar nga ERRU për:

Kategorinë A – furnizim dhe shpërndarje uji,

Kategorinë C – largim të ujërave të ndotura.

Nga pikëpamja teknike:

Prodhimi vjetor i ujit është rreth 24.3 milion m³,

84% e prodhimit është i matur, 16% i vlerësuar (një tregues më i mirë se shumë shoqëri rajonale të tjera), Sistemi është kryesisht me ngritje mekanike (~90%), duke e bërë shoqërinë të varur nga energjia elektrike, Rreth 90% e lidhjeve janë të pajisura me ujëmatës në konsumator, Rrjetet, stacionet e pompimit dhe një pjesë e rezervuarëve janë të vjetër dhe me nevojë për ndërhyrje, veçanërisht në njësitë Elbasan, Peqin dhe Gramsh.

Shoqëria ka paraqitur kërkesë për rishikim dhe unifikim tarifash për periudhën 2025–2027, me synim mbulimin e kostove O&M dhe përmirësimin e shërbimit.

Në lidhje me vendimarrjen:

1. Dokument i detajuar dhe teknikisht i qëndrueshëm

Analiza përmban informacion të gjerë për burimet ujore, prodhimin, stacionet e pompimit, eficientë e energjisë, rezervuarët dhe gjendjen e tyre teknike.

2. Niveli i matjes në prodhim relativisht i mirë

Fakti që 84% e ujit të prodhuar është i matur e dallon pozitivisht UK Rajonale Elbasan nga shumë shoqëri të tjera rajonale. Kjo rrit besueshmërinë e bilancit të ujit dhe projeksioneve financiare.

3. Respektim formal i procedurës ligjore dhe rregullatorë. Procesi përfshin miratimin nga Këshilli Mbikëqyrës, seanca dëgjimore publike, mendimet e këshillave bashkiakë, kërkesat për informacion shtesë nga ERRU dhe vendimin e KKRR për fillimin e procedurës. Kjo tregon korrektësi procedurale.

4. Argumentim parimor i nevojës për tarifa Shoqëria e lidh kërkesën tarifore me: nevojën për unifikim tarifash, mbulim mbi 100% të kostove O&M, rritjen e çmimeve dhe pagës minimale, financimin e riparimeve, instalimit të matësve dhe menaxhimit të rrjetit.

Këto argumente janë të pranueshme në parim dhe në përputhje me metodologjinë “Kosto Plus”. Dobësitë dhe risqet kryesore

1. Vendimmarrje tarifore mbi një performancë ende problematike Megjithëse niveli i matjes është më i mirë se mesatarja, sistemi vazhdon të karakterizohet nga varësi e lartë nga pompimi, pajisje të vjetra dhe eficientë e dobët energjetike në disa stacione (deri në 2.95 kWh/m³). Kjo dobëson argumentin që tarifa e re do të përkthehet automatikisht në përmirësim performance.

2. Pabarazi territoriale dhe rritje uniforme tarifash

Tarifat e propozuara rriten në mënyrë të ndjeshme edhe në njësi me mbulim shumë të ulët dhe shërbim problematik (sidomos Librazhd dhe Peqin). Dokumenti nuk e lidh qartë rritjen e tarifës në këto zona me përmirësime konkrete dhe të afatizuara të shërbimit.

3. Mungesë kushtëzimi performance në vendimmarrje

Vendimmarrja tarifore nuk shoqërohet me objektiva të detyrueshme për uljen e humbjeve, përmirësimin e efikasitetit energjetike apo zgjerimin e mbulimit të shërbimit. Tarifa shihet më shumë si instrument financiar sesa si mjet reformues.

4. Analiza e përballueshmërisë mbetet e përgjithshme

Edhe pse përballueshmëria trajtohet si kriter, ajo nuk analizohet në mënyrë të diferencuar sipas njësive me nivel të ulët shërbimi dhe zonave rurale, ku ndikimi social i tarifës është potencialisht më i lartë.

5. Probleme metodologjike gjatë aplikimit

Vetë dokumenti pranon se modeli i aplikimit nuk është plotësuar fillimisht sipas kërkesave të metodologjisë, duke çuar në shtyrjen e afatit të vendimmarrjes deri në qershor 2025. Kjo dobëson besueshmërinë e bazës financiare mbi të cilën kërkohet rritja tarifore.

A ka lidhje logjike midis argumenteve/fakteve dhe vendimmarrjes përfundimtare?

Analiza teknike dhe financiare është e qartë: asete të amortizuara, nevojë për investime, rritje kostosh dhe nevojë për qëndrueshmëri financiare. Në këtë kuptim, kërkesa për rishikim tarifash është logjike në parim. Megjithatë, lidhja midis fakteve teknike dhe vendimmarrjes tarifore nuk është e mbyllur plotësisht, pasi mungon një mekanizëm i qartë që e lidh tarifën me rezultate konkrete, të matshme dhe të verifikueshme në terren.

Pika më problematike është disbalanca midis nivelit të problemeve strukturore dhe rolit që i jepet tarifës si mjeti kryesor për zgjidhjen e tyre. Shoqëria operon një sistem me varësi të lartë nga energjia, pajisje të vjetra dhe pabarazi në mbulimin e shërbimit. Në këtë kontekst, rritja e tarifës rrezikon të shërbejë kryesisht për stabilizim financiar, pa garantuar transformim real të performancës teknike dhe operacionale. Nga këndvështrimi i interesit publik dhe auditimit, tarifa duhet të shoqërohet me angazhime të qarta: ulje progresive të humbjeve, përmirësim të efikasitetit energjetike dhe zgjerim real të shërbimit në njësitë më problematike. Në dokument, kjo lidhje mbetet e nënkuptuar dhe jo e garantuar, duke krijuar rrezik që efektet afatmesme të vendimmarrjes tarifore të jenë të kufizuara.

Miratimi i tarifave nga ERRU për Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër SHA.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se:

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër sh.a. (NUIS M..) është themeluar më 22.09.2022, në zbatim të VKM nr. 302/2022, nga bashkimi i ish-shoqërive UK Gjirokastër, Përmet, Tepelenë, Dropull, Libohovë, Këlcyrë dhe Memaliaj. Aksioneri kryesor është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (51%), ndërsa pjesa tjetër ndahet ndërmjet bashkive përbërëse.

Shoqëria operon në një zonë shërbimi me 145,067 banorë, nga të cilët 132,960 banorë furnizohen me ujë të pijshëm, ose 91.7% e popullsisë në juridiksion. Mbulimi i shërbimit është shumë i lartë në shumicën e njësive (100% në Dropull, Libohovë dhe Këlcyrë; mbi 94% në Gjirokastër, Përmet dhe Tepelenë), ndërsa Memaliaj përbën përjashtimin kryesor me vetëm 47.4% mbulim, duke krijuar pabarazi të dukshme territoriale.

Shoqëria është e licencuar nga ERRU për:

Kategorinë A – furnizim dhe shpërndarje uji,

Kategorinë C – largim të ujërave të ndotura.

Nga pikëpamja teknike dhe operacionale:

Prodhimi vjetor i ujit është 7.065 milion m³,

Vetëm 34.4% e prodhimit është i matur, ndërsa 65.6% është i vlerësuar, për shkak të mungesës së ujëmatësve në burime, Shoqëria shfrytëzon rreth 119 burime ujore, Sistemi i furnizimit është i kombinuar me rrjedhje të lirë dhe ngritje mekanike, Rrjetet e transmetimit (275.9 km) janë në përgjithësi në gjendje të mirë, me segmente të amortizuara kryesisht të ndërtuara para viteve 1990, Një pjesë e njësive (Gjirokastrë, Këlcyrë) kanë sisteme SCADA dhe automatizim relativisht të avancuar, Furnizimi me ujë është relativisht i mirë në orë/ditë (18–24 orë), por me diferenca të ndjeshme mes njësive.

Shoqëria ka paraqitur kërkesë për rishikim dhe rritje tarifash për shërbimet FU dhe KUN, me synim unifikimin e tarifave, mbulimin mbi 100% të kostove O&M dhe financimin e ndërhyrjeve teknike.

Në lidhje me vendimmarrjen

1. Dokument teknikisht shumë i detajuar dhe konsistent

Analiza përmban informacion shumë të hollësishëm për burimet ujore, kapacitetet, prodhimin, rrjetet e transmetimit, stacionet e pompimit dhe gjendjen e tyre teknike. Të dhënat janë të qëndrueshme mes raportit teknik, modelit të aplikimit dhe dokumentacionit të licencimit, çka rrit besueshmërinë formale të analizës.

2. Nivel i lartë i mbulimit të shërbimit në shumicën e zonës

Mbulimi mbi 90% i popullsisë dhe furnizimi relativisht i vazhdueshëm me ujë (deri 24 orë/ditë në disa njësi) përbëjnë një argument real krahasuar me shumë shoqëri të tjera rajonale.

3. Gjendje përgjithësisht e mirë e aseteve kryesore

Rrjetet e transmetimit dhe shumica e stacioneve të pompimit rezultojnë në gjendje të mirë ose shumë të mirë, falë investimeve të kryera vitet e fundit. Kjo krijon premisa për përmirësim performance nëse menaxhimi i kërkesës dhe matja përmirësohen.

4. Proces i rregullt ligjor dhe procedural

Dokumenti evidenton respektimin e procedurës: miratimi nga Këshilli Mbikëqyrës, kerkimi i mendimit të këshillave bashkiakë, zhvillimi i seancave dëgjimore publike, kërkesat për informacion shtesë nga ERRU dhe vendimi i KKRR për fillimin e procedurës. Nga këndvështrimi formal, vendimmarrja është e rregullt.

5. Argumentim parimor i nevojës për rishikim tarifash

Shoqëria e lidh kërkesën për tarifa të reja me nevojën për unifikim tarifash, mbulim të kostove O&M, rritje të çmimeve dhe pagës minimale, si dhe financimin e investimeve për përmirësim shërbimi. Ky argumentim është i pranueshëm në parim dhe në linjë me metodologjinë rregullatore.

Dobësitë dhe risqet kryesore

1. Vendimmarrje mbi një bazë prodhimi kryesisht të pamatur

Fakti që 65.6% e ujit të prodhuar nuk matet realisht, por vlerësohet, përbën dobësi thelbësore nga pikëpamja audituese. Në mungesë të matjes në burim, çdo analizë e kostos për m³, e efencës energjetike dhe e bilancit të ujit mbart pasaktësi strukturore.

2. Norma të larta furnizimi për frymë në disa njësi

Dokumenti evidenton norma ditore mbi kufirin e rekomanduar (150 l/f/ditë), veçanërisht në Këlcyrë (214 l/f/ditë) dhe Libohovë (387 l/f/ditë). Kjo tregon mungesë kontrolli të kërkesës dhe menaxhim jo optimal të burimeve, që nuk adresohet drejtpërdrejt nga politika tarifore e propozuar.

3. Pabarazi territoriale në shërbim dhe tarifa

Ndërkohë që shumica e njësive kanë mbulim pothuajse të plotë, Memaliaj mbetet me mbulim shumë të ulët. Rritja e tarifave aplikohet në mënyrë të përgjithshme, pa lidhje të drejtpërdrejtë me përmirësime konkrete dhe të afatizuara në zonat më problematike.

4. Analiza e përballueshmërisë mbetet e kufizuar

Edhe pse përmendet nevoja për mbrojtjen e konsumatorëve, dokumenti nuk analizon në mënyrë të detajuar ndikimin e tarifave të reja mbi familjet, veçanërisht në zonat rurale dhe njësitë me cilësi më të dobët shërbimi.

5. Tarifa si instrument financiar, jo si mjet performance

Vendimmarrja tarifore nuk shoqërohet me objektiva të detyrueshme për: rritjen e nivelit të matjes në burime, uljen e humbjeve reale, apo kontrollin e normave të konsumit për frymë. Kjo e dobëson funksionin reformues të tarifës.

A ka lidhje logjike midis argumenteve/fakteve dhe vendimmarrjes përfundimtare?

Ka lidhje logjike në disa pika kyçe, por me boshllëqe të rëndësishme.

Ku logjika qëndron

Refuzimi i propozimit për klientët jo-familjarë shpjegohet me mosrespektim të klauzolës së koeficientit të ndërfinancimit (metodologji) dhe për disa njësi ruhen tarifat ekzistuese prej shumë vitesh; ndërsa në zona të tjera koeficienti respektohet.

Unifikimi i tarifës KUN dhe pranimet e tarifës fikse për familjarët lidhen me një objektiv të qartë (unifikim) dhe me kufizime metodologjike.

Vendimi final justifikohet me rezultatin financiar: mbulim O&M mbi 100% dhe pa nevojë subvencionesh.

Baza teknike e llogaritjeve është e pasigurt, sepse prodhimi matet vetëm 34.4%. Në një vendimmarrje tarifore, nëse “inputi” është i pasigurt, atëherë edhe “outputi” (tarifa) ka risk të jetë i pasaktë. Dokumenti e pranon problemin, por nuk e shndërron në kusht vendimmarrjeje (p.sh. tarifa e kushtëzuar me instalim matësash në burim brenda afatit X).

Mbulesa O&M mbi 100% jepet si argument final, por dokumenti nuk e lidh ngushtë me rrezikun e arkëtimeve korente 65.2% (që është i ulët). Ç’ndodh me mbulimin O&M nëse arkëtimi real mbetet 65% dhe jo 70%?

Në disa njësi mbahen tarifat ekzistuese për jofamiljarët “prej 5 apo 10 vitesh”, pra vendimi për ta nuk del nga kosto-shërbimi por nga “status quo” historik. Kjo logjikë duhet të shoqërohet me analizë: a po krijohet barrë disproporcionale të familjarët, apo po humbet mundësia e balancimit financiar?

Ekziston mospërputhja midis performancës relativisht të mirë infrastrukturore dhe dobësisë së thellë në menaxhimin e të dhënave dhe kërkesës për ujë. Shoqëria operon me rrjete dhe stacione në gjendje të mirë, por pa matje të mjaftueshme në burim dhe me norma shumë të larta konsumi për frymë në disa zona. Në këtë kontekst, rritja e tarifës rrezikon të mbulojë pasojat financiare të një menaxhimi jo optimal, pa garantuar përmirësim real të efikasitetit dhe drejtësisë në shërbim. Tarifa duhet të shoqërohet me angazhime të qarta për matje 100% në burime, kontroll të konsumit dhe përmirësim të shërbimit në njësitë më problematike; në dokument, kjo lidhje mbetet e nënkuptuar dhe jo e siguruar.

Miratimi i tarifave nga ERRU për Shoqërinë Rajonale të Ujësjetës Kanalizime Fier SHA.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se:

Shoqëria Rajonale Ujësjetës Kanalizime Fier sh.a. është krijuar më 08.09.2022, si rezultat i bashkimit të katër ish-shoqërive UK: Fier, Patos, Roskovec dhe Mallakastër. Ajo është shoqëri publike aksionare, ku 51% e aksioneve zotërohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ndërsa pjesa tjetër nga bashkitë përkatëse.

Zona e shërbimit përfshin 170,032 banorë në juridiksion, nga të cilët 110,891 banorë (65.2%) furnizohen me ujë të pijshëm. Shërbimi i kanalizimeve të ujërave të ndotura mbulon rreth 46% të popullsisë. Shoqëria operon në një treg monopol natyror, është e licencuar nga ERRU për shërbimet FU dhe KUN, dhe aplikon aktualisht tarifa të miratuara ndër vite për ish-shoqëritë përbërëse.

Nga pikëpamja teknike:

Prodhimi vjetor është 20.79 milion m³ ujë,

vetëm 67.7% e prodhimit është i matur, pjesa tjetër vlerësohet, UPA = 69.59%, një nga nivelet më të larta në rang kombëtar, vetëm 30.41% e ujit prodhuar faturohet, humbjet administrative (lidhje të paligjshme + nënfaturim) janë 31.93%, humbjet reale/teknike janë 37.01%. Shoqëria ka paraqitur pranë ERRU kërkesë për ndryshim dhe unifikim tarifash për vitet në vijim, me arsyetimin e përmirësimit të qëndrueshmërisë financiare dhe cilësisë së shërbimit.

Në lidhje me vendimmarrjen tarifore

a) Transparencë faktike dhe teknike

b) Dokumenti është i detajuar: jepen të dhëna për burimet, stacionet e pompimit, rezervuarët, rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes, si dhe një bilanc uji i strukturuar sipas standardit IWA.

c) Pranim i hapur i problematikave kritike

Dokumenti nuk i fsheh dobësitë:

pranon hapur se UPA është në nivele “të papranueshme”, evidenton qartë peshën e lidhjeve të paligjshme dhe nënfaturimit, pranon mungesën e matësve në prodhim dhe në stacionet e pompimit.

Ky nivel sinjeraliteti rrit kredibilitetin analitik.

d) Konsultim publik dhe institucional i dokumentuar

Janë zhvilluar seanca dëgjimore dhe janë pasqyruar qëndrimet e bashkive dhe konsumatorëve. Publiku pranon nevojën për të ardhura, por kërkon përmirësim cilësie – një fakt i rëndësishëm për auditimin e procesit.

Dobësitë dhe risqet

a) Vendimmarrje mbi një bazë volumetrike të pasigurt. Kur 32.3% e prodhimit nuk matet, çdo tregues që varet nga prodhimi (UPA, faturim, kosto për m³, të ardhura të pritshme) ka risk të lartë pasaktësie.

b) UPA ekstremisht e lartë e bën tarifën instrument të dobët reformues

Me 69.59% ujë pa të ardhura, rritja e tarifës prek kryesisht:

konsumatorët korrektë, zonat ku matja është më e mirë, ndërsa humbjet dhe paligjshmëria vazhdojnë të “thithin” sistemin. Pa kushte performance, tarifa rrezikon të financojë joeficiencën.

c) Lidhja “tarifë → investime → cilësi” nuk është e mbyllur. Analiza flet për: instalim matësash, riparime rrjeti, reduktim UPA, por nuk i lidh këto me objektiva të matshme, afate dhe buxhete konkrete. Në auditim, kjo konsiderohet mungesë e logjikës së rezultateve (results-based management).

d) Kundërshtimi i bashkive nuk reflektohet në vendim

Tre nga katër këshilla bashkiakë nuk e kanë miratuar planin tarifor. Dokumenti e pasqyron këtë fakt, por vendimmarrja finale nuk shoqërohet me masa kompensuese (fazim, kushte shtesë, targetim social).

Diagnoza është e saktë: gjendje teknike e amortizuar, UPA shumë e lartë, nevojë për të ardhura. Argumentet për rritje/unifikim tarifash janë racionalë në letër.

Vendimmarrja (pranimi i aplikimit dhe rishikimi tarifor) është proceduralisht e ligjshme.

Por, tarifa nuk kushtëzohet me ulje reale të humbjeve dhe matje në prodhim,

rritja e tarifës nuk shoqërohet me mekanizma detyrues performance, por me rekomandime.

Vendimmarrje me risk të lartë zbatimi.

Pika më problematike në këtë rast është kontradikta strukturore midis madhësisë së problemit dhe butësisë së instrumentit të zgjedhur. Kur shoqëria prodhon rreth 513 litra/ditë për banor, por faturon vetëm 156 litra/ditë, ndërsa humbet 357 litra/ditë për banor, problemi kryesor nuk është niveli i tarifës, por kontrolli i sistemit. Rritja e tarifës në këtë kontekst, pa e bërë kusht

instalimin e matësve në prodhim, eliminimin e lidhjeve të paligjshme dhe uljen e UPA-së me objektiva vjetore të detyrueshme, krijon rrezik klasik të rastit kur operatori mbulon boshllëqet financiare përmes tarifës, ndërsa incentiva për reformë reale dobësohet.

-Kjo rrezikon të shndërrojë tarifën nga mjet rregullator në mekanizëm transferimi të kostos së dështimit menaxherial te konsumatori.

Miratimi i tarifave nga ERRU për Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se:

Shoqëria Rajonale UK Korçë sh.a (NUIS M..) është themeluar më 12.07.2022, me aksionar kryesor MIE 51%, dhe bashkitë: Korçë 28.29%, Maliq 8.67%, Devoll 7.76%, Kolonjë 3.64%, Pustec 0.63%. Popullsia në juridiksion për 2023 është 216,000 dhe popullsia e shërbyer 169,932 (rreth 79%).

-Licencuar me vendim KKRR Nr.578, datë 02.12.2022 për kategoritë A (FU), C (KUN), D (trajtim).

-Rrjeti FU raportohet ~649.9 km; lidhje FU në 2023 55,232, ku 96.2% të pajisur me ujëmatës (në konsumator).

Prodhim, matje dhe humbje (pika kyçe për tarifën):

Prodhimi vjetor: 7,498,990 m³, rreth 71% i matur dhe pjesa tjetër e vlerësuar → “nevojë imediate për ujëmatës në pikat prodhuese (burime)”.

UPA 35.8% e ujit që hyn në sistem; shoqëria faturon 4,812,749 m³ ose 64.2% të prodhimit.

Furnizimi është kryesisht me ngritje mekanike 68% (pra varësi e lartë nga energjia).

-Procedura e aplikimit: kërkesa më 27.06.2024, plotësime 08.08.2024; KKRR fillon procedurën me vendim nr.26, datë 12.09.2024.

-Konsultimi publik: seanca dëgjimore më 25–26.06.2024; konsumatorët “në përgjithësi kundër tarifave”, por kërkojnë që rritja të shoqërohet me rritje cilësie, veçanërisht në zona rurale.

Mbi vendimmarrjen tarifore

Arsyetimi i nevojës për rishikim tarifash është i artikuluar (në nivel parimor)

Shoqëria rendit arsytet: unifikim tarifash në zonë, përmirësim performance financiare dhe mbulim >100% të O&M, rritje çmimesh/pagash, përmirësim shërbimi nga investimet, mbulim riparimesh, eliminim defektesh e lidhjesh të paligjshme, vendosje matësash, menaxhim rrjeti.

Përdorimi i indikatorëve teknikë që e bëjnë “të besueshme” nevojën financiare

-Varësi e lartë nga pompimi (68%) → sinjal se kostot e energjisë janë strukturore.

-Prodhim jo plotësisht i matur (29% i vlerësuar) → risk i lartë për pasaktësi në bilanc/planifikim.

-UPA 35.8% dhe faturim 64.2% e prodhimit → argument që, pa eficiencë, çdo rritje tarife përthithet nga humbjet/jo-faturimi.

Dobësitë dhe risqet kryesore

Shoqëria liston arsye (inflacion, paga, investime, riparime), por një vendim i mirëargumentuar tarifor kërkon gjurmë të qartë: cilat kosto rriten, sa rriten, cilat janë të pranueshme sipas metodologjisë, dhe si përkthehen matematikisht në tarifë.

Rritje disproporcionale dhe potencialisht e padrejtë për zonat rurale

Nga tabela e krahasimit të faturës mujore (aktuale vs varianti ERRU), shihen rritje shumë të larta në disa njësi/segmente:

Rurale Korçë: nga 439 në 1,582 lek/muaj (ritje 260%).

Maliq: nga 443 në 1,582 lek/muaj (ritje 257%).

Kjo është “brenda 5%” në kuptimin statistikor të përdorur, por përbën rrezik social: rritje 2.5–3 herë për kategori të cenueshme, pa garanci të detyrueshme se cilësia/ora furnizimi do të përmirësohet në të njëjtin horizont kohor.

Përballueshmëria duket e bazuar në një mesatare (shpenzime mesatare mujore) që mund të fshehë varfërinë reale

Në tabelën e përballueshmërisë përdoret shifër “shpenzime mesatare mujore” (p.sh. 83,864 lekë) dhe del përqindje 0.3%–1.0%.

A është kjo mesatare përfaqësuese për zonat rurale? Nëse jo, kriteri 5% bëhet “komod” në letër, por i dobët në realitet për shtresat me të ardhura nën mesatare.

Risk i madh që tarifatat të rriten pa u kushtëzuar me ulje humbjesh/rritje matjeje

Dokumenti pranon:

-29% e prodhimit “i vlerësuar” dhe nevojë imediate për matës në burime.

-UPA 35.8% dhe vetëm 64.2% faturim i prodhimit.

Kjo do të duhej të çonte në një vendimmarrje tarifore të tipit: rritje e kujdesshme + kushte të matshme (p.sh. objektiva vjetore për matje në burim, ulje humbjesh, rritje të arkëtimit, reduktim të energjisë për m³ të faturuar).

Seancat dëgjimore

Konsumatorët kërkuar që rritja të reflektohet në cilësi, sidomos në zona rurale.

Nuk trajtohet se si u adresuan komentet e publikut” + angazhime konkrete (indikatore shërbimi, afate, investime të lidhura me zona problematike). Në fragmentet e dhëna, kjo pjesë mbetet më shumë si “u dëgjuan” sesa “u integruan”.

A ka lidhje logjike midis fakteve/argumenteve dhe vendimmarrjes përfundimtare?

-Logjika bazë ekziston: humbje/jo-faturim të larta (UPA 35.8%, faturim 64.2%), varësi e lartë nga pompimi (68%), matje jo e plotë në prodhim → këto, në parim, rrisin kostot dhe dobësojnë të ardhurat, duke justifikuar “nevojë për rishikim”.

-Por lidhja “nga faktet te tarifa e vendosur” duket e ndërprerë: vendimi/varianti i ERRU-së paraqitet si “brenda përballueshmërisë 5%”, ndërkohë që në terren ka rritje shumë të larta për njësi të caktuara (260% etj.).

-Pranohen probleme të mëdha teknike që kërkojnë reformë (matje burimesh, ulje humbjesh), por vendimmarrja tarifore (siç reflektohet në tabelat e faturës) duket se shkon drejt rritjes së të ardhurave pa e bërë të qartë “kontratën” e performancës: çfarë merr qytetari mbrapsht dhe kur. Problemi më thelbësor i rezultoit lidhet me mospërputhjen midis nivelit të lartë të humbjeve dhe mekanizmit të zgjedhur për adresimin e tyre. Shoqëria operon me humbje dhe mosfaturim domethënës (UPA 35.8%, vetëm 64.2% e prodhimit faturohet), si dhe me prodhim jo plotësisht të matur (rreth 29% i vlerësuar). Megjithatë, masa kryesore e propozuar për përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare është rritja e tarifës, përfshirë rritje shumë të ndjeshme për zonat rurale (deri në 260%). Në mungesë të kushtëzimit të kësaj rritjeje me rezultate konkrete dhe të matshme në reduktimin e humbjeve dhe përmirësimin e shërbimit, krijohet rreziku që barra financiare t’i transferohet konsumatorit korrekt, pa adresuar shkaqet strukturore të performancës së dobët.

Nga këndvështrimi i interesit publik dhe auditues, tarifa duhet të funksionojë si mjet për arritjen e përmirësimeve të verifikueshme në shërbim dhe menaxhim, dhe jo thjesht si instrument për mbulimin e hendekut financiar. Në të kundërt, ekziston rreziku i një cikli të përsëritur: rritje tarife → reagim negativ i konsumatorëve → dobësim i arkëtimeve dhe shtim i praktikave informale → rritje e humbjeve → kërkesa të mëtejshme për rishikim tarifor. Edhe pse dokumenti evidenton se konsumatorët shprehin kundërshtim dhe e lidhin pranimin e tarifës me përmirësimin e cilësisë, ai nuk e materializon këtë pritshmëri në një angazhim të qartë, të matshëm dhe të verifikueshëm që rritja e tarifës do të përkthehet në shërbim më të mirë, veçanërisht në zonat më problematike.

Miratimi i tarifave nga ERRU për Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Pogradec SHA.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se:

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec sh.a. është themeluar më 26.07.2022, me aksionarë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë 51%, Bashkia Pogradec 36.1% dhe

Bashkia Prrenjas 12.9%. Ajo operon si operator i vetëm i shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve në territorin e dy bashkive përbërëse.

Shoqëria shërben 101,844 banorë, që përbëjnë rreth 87.15% të popullsisë në juridiksion. Mbulimi është shumë i lartë në Bashkinë Pogradec (94.1%) dhe dukshëm më i ulët në Bashkinë Prrenjas (69.5%), duke reflektuar diferenca historike investimesh dhe infrastrukture.

Nga pikëpamja teknike:

Prodhimi vjetor i ujit është rreth 3.37 milion m³,

vetëm 70% e prodhimit është i matur, pjesa tjetër e vlerësuar,

Uji Pa të Ardhura (UPA) është 34.88%,

shoqëria faturon 65.12% të ujit të prodhuar,

humbjet reale (teknike) janë 24.2%, ndërsa humbjet administrative 9.98%,

rreth 88% e konsumatorëve janë të pajisur me ujëmatës,

sistemi i furnizimit në Pogradec dhe Buçimas është teknikisht i mirë dhe 24/7, ndërsa në disa njësi të tjera rurale ka probleme amortizimi dhe ndërhyrjesh jo-standarde.

Shoqëria ka paraqitur kërkesë për rishikim tarifash me synimin e mbulimit mbi 100% të kostove operationale, përballimit të rritjes së çmimeve dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimit.

Në lidhje me vendimarrjen

1. Dokument teknikisht i detajuar dhe relativisht i qëndrueshëm

Analiza përmban informacion të plotë mbi burimet e ujit, linjat e transmetimit, rrjetet shpërndarëse, stacionet e pompimit, rezervuarët dhe bilancin e ujit.

2. Pranim realist i problematikave kryesore

Evidentohen dobësitë: matje jo e plotë në burime, nevojë imediate për ujëmatës në prodhim, humbje reale të konsiderueshme dhe diferenca të theksuara ndërmjet njësive.

3. Performancë relativisht e mirë krahasuar me sektorin

UPA në nivel 34.88% dhe humbje administrative nën 10% e rendisin UK Pogradec ndër shoqëritë me performancë më të mirë në nivel kombëtar, çka krijon bazë më të fortë për argumentimin e tarifave sesa në shumë raste të tjera.

Dobësitë dhe risqet kryesore

1. Vendimarrje mbi një bazë prodhimi jo plotësisht të matur.

Fakti që 30% e prodhimit të ujit është i vlerësuar dhe jo i matur përbën një dobësi themelore. Çdo tarifë që bazohet në kosto për m³ dhe në parashikime të të ardhurave mbart rrezik pasaktësie kur inputi bazë (uji i prodhuar) nuk matet plotësisht.

2. Rritje të ndjeshme tarifash në disa kategori pa lidhje të ngushtë me rezultate të garantuara

Në disa zona, veçanërisht rurale dhe në njësinë Prrenjas, rritjet tarifore janë shumë të ndjeshme (p.sh. kalimi nga 0 në 25 lek/m³ për KUN). Këto rritje justifikohen me nevojë për të ardhura, por dokumenti nuk i lidh qartë me objektiva të detyrueshme për përmirësim konkret të shërbimit në të njëjtat zona.

3. Argumenti i përballueshmërisë mbështetet në mesatare

Analiza e përballueshmërisë përdor tregues mesatarë të shpenzimeve mujore, të cilët mund të mos reflektojnë realitetin e familjeve me të ardhura më të ulëta, sidomos në zonat rurale. Nga këndvështrimi i auditimit publik, kjo e bën argumentin e përballueshmërisë formalisht korrekt, por potencialisht të brishtë.

4. Investimet e përmendura janë kryesisht të përgjithshme.

Nuk përmenden investime në proces ose të planifikuara, por mungon një lidhje e qartë numerike: sa nga të ardhurat shtesë do të shkojnë për investime, cilat njësi përfitojnë dhe në çfarë afati kohor. Kjo e dobëson lidhjen midis tarifës dhe përmirësimit të matshëm të shërbimit. Diagnoza teknike (humbje, matje e pjesshme, nevojë për investime, kosto energjie) është e argumentuar dhe e mbështetur me të dhëna konkrete.

Argumenti financiar (nevoja për mbulim mbi 100% të kostove operacionale) është logjik dhe në përputhje me parimet rregullatore.

Vendimmarrja tarifore, megjithatë, duket se mbështetet më shumë te nevoja për të ardhura sesa te një mekanizëm i qartë “tarifë kundrejt performance”.

Vendimmarrje logjike dhe arsyetuar në parim, por e pambështetur mjaftueshëm me kushte të forta zbatimi.

Pika më problematike e rezultatoir lidhet me mospërputhjen midis nivelit aktual të performancës dhe natyrës së ndërhyrjes tarifore të propozuar. Megjithëse UK Pogradec paraqet tregues relativisht më të mirë krahasuar me pjesën tjetër të sektorit për sa i përket UPA-së dhe kontrollit administrativ, shoqëria vijon të operojë me mangësi strukturore të rëndësishme, si prodhim jo plotësisht të matur (rreth 30%), humbje reale mbi 24% dhe diferenca të ndjeshme infrastrukturore ndërmjet njësive përbërëse. Në këtë kontekst, rritja e tarifës paraqitet kryesisht si mjet për forcimin e qëndrueshmërisë financiare, pa u shoqëruar me detyrime të qarta që e bëjnë të domosdoshëm përmirësimin e mëtejshëm të menaxhimit teknik dhe operacional në zonat ende problematike.

Nga këndvështrimi i interesit publik dhe auditimit të performancës, tarifa duhet të shoqërohet me angazhime konkrete dhe të verifikueshme për arritjen e përmirësimeve të matshme, si përfundimi i matjes në burime, ulja graduale e humbjeve reale dhe barazimi i cilësisë së shërbimit ndërmjet njësive. Në dokument, lidhja midis nivelit të tarifës së propozuar dhe realizimit të këtyre rezultateve mbetet e përgjithshme dhe e pambështetur në mekanizma të qartë zbatimi dhe monitorimi.

Në lidhje me licensimin e shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë sh.a.

Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) ka shqyrtuar kërkesën e shoqërisë (me shkresë nr. 931 prot., datë 25.11.2024) për licencim/rinovim licence për shkak të përfundimit të afatit dhe ka vendosur licensimin e shoqërisë në kategoritë:

Kategoria A – grumbullim dhe shpërndarje e ujit për konsum publik

Kategoria C – largim i ujërave të ndotura

Kategoria D – trajtim i ujërave të ndotura

Gjithashtu vendimi parashikon detyrimin që drejtuesi ligjor të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga njoftimi, hyrjen në fuqi të menjëhershme dhe botimin në Fletoren Zyrtare. Pikat e forta (çfarë është bërë mirë)

Bazë ligjore e referuar qartë: vendimi mbështetet te ligji nr. 8102, VKM nr. 958, aktet/rregulloret e licencimit dhe referon edhe VKM nr. 302 për politikën e reorganizimit të sektorit. Kjo tregon se vendimmarrja është “e ankoruar” në kuadrin normativ.

Arsyetim procedural për pranueshmërinë: dokumenti thotë se kërkesa u gjet në përputhje me kriteret/procedurën dhe se dokumentacioni është paraqitur sipas kërkesave. Ka edhe listim të dokumenteve shoqëruese (akte higjieno-sanitare, leje mjedisore, ekstrakte QKB, vërtetime gjendje gjyqësore, CV, etj.).

Përkufizim i qartë i output-it: vendimi e materializon qartë produktin administrativ (licencimin) dhe kategoritë e licencës, si dhe hapat pasues (njoftim, nënshkrim kushtesh, botim).

Pikat e dobëta

Arsyetim “deklarativ”, jo i provuar: shprehje si “plotëson kërkesat ligjore” dhe “ka aftësi tekniko-profesionale e financiare” jepen pa tregues, pa prova të sintetizuara dhe pa analizë të matshme (p.sh. performancë shërbimi, gjendje financiare, auditime, penalitete, borxhe, nivel arkëtimi, humbje uji, cilësi uji, ndërprerje shërbimi).

Mungesë lidhjeje midis dokumenteve të listuara dhe kriterit që ato provojnë: lista e dokumenteve është e gjatë, por vendimi nuk thotë “ky dokument vërteton këtë kriter” (p.sh. cilat dokumente vërtetojnë kapacitetin financiar? cilat vërtetojnë kapacitetin teknik operacional? cilat vërtetojnë përputhshmërinë mjedisore të impianteve?).

Analiza e konkurrencës është formale/boilerplate: përmendja e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe “mosabuzimi me pozitë dominuese” nuk shoqërohet me analizë realiste të tregut (në ujësjellës zakonisht ka monopol natyror dhe treg i rregulluar). Pa sqaruar “tregun relevant” dhe mekanizmat mbrojtës, ky argument mbetet i paoperacionalizuar për vendimmarrje.

“Raporti i vlerësimit financiar” është i cunguar: thuhet vetëm se ka efekte pozitive në buxhetin e institucionit si pasojë e pagesës së licencimit, por mungon kuantifikimi (sa është tarifa, kur arkëtohet, a ka detyrime të prapambetura, çfarë kostoje administrative ka procesi).

Mungojnë rreziqet dhe kushtëzimet: vendimi nuk reflekton rreziqe kyçe të shërbimit publik (siguria e furnizimit, cilësia e ujit, risku mjedisor i shkarkimeve, kapacitetet reale të impianteve, emergjencat, mirëmbajtja, investimet) dhe nuk vendos kushte të matshme/monitorueshme për përmirësim. Ky përbën vendim me perfo procedural, jo performance/rezultat.

Problemi kryesor nuk është mungesa e referencave ligjore, por mungesa e perfor së arsyetimit: dokumenti sillet sikur licencimi është rezultat performan I një dosjeje të plotë, ndërkohë që për një shërbim perfor kritik (ujë I pijshëm, shkarkime, trajtim) vendimmarrja duhet të jetë e ndërtuar mbi garanci të matshme (performance, kapacitete, përputhshmëri mjedisore, risk operacional, qëndrueshmëri financiare). Pa këto, rregullatori rrezikon të krijojë një “mbulim formal” ku licenca jepet sepse dokumentet ekzistojnë, jo sepse shërbimi është realisht në standard; kjo ul përgjegjshmërinë dhe e zhvendos rrezikun te qytetari dhe mjedisi (cilësia e ujit / ndotja), ndërsa vendimi mbetet I dobët për t’u mbrojtur në rast incidenti apo auditimi të thelluar.

Në lidhje me licencimin e UK Vlorë:

Shoqëria ka paraqitur kërkesë për licencim për herë të parë me shkresë nr. 2817 prot. (03.09.2024) dhe plotësime me shkresë nr. 2901 prot. (11.09.2024). Mbi bazën e kësaj kërkesë është miratuar Vendimi nr. 43, datë 08.11.2024 i KKRR pranë ERRU “Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë sh.a.”.

Nga dokumenti rezultoi se: Shoqëria deklaroi se ofron shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 309,732 banorë në bashkitë Vlorë, Himarë, Selenicë.

Licencohet në Kategorinë A (grumbullim & shpërndarje uji për konsum publik) dhe Kategorinë C (largim ujërash të ndotura), me zonë shërbimi: bashkitë Vlorë, Himarë, Selenicë dhe afat licence 4-vjeçar.

Shoqëria autorizohet të kryejë veprimtaritë me Drejtues Ligjor: Sokol Kananaj dhe Drejtues Teknik: Kendi Manaj.

Për drejtuesin teknik thuhet se ka master profesional në Hidroteknik (2018) dhe se plotëson kërkesat e VKM nr. 958 për edukim/eksperiencë.

Në lidhje argumentimit të vendimarrjes

Arsyetim i përgjithshëm: “u mor në konsideratë” pa prova të verifikueshme.

Vendimi shprehet se ERRU ka marrë në konsideratë aftësitë tekniko-profesionale, aftësitë financiare, përvojën në sektor dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, por nuk jep asnjë tregues: si u matën këto, çfarë dokumentesh u verifikuan, cilat ishin rezultatet, a pati mangësi/plan korrigjimi. Kjo e bën vendimin të vështirë për t’u testuar ex-post nga auditimi.

“Aftësia financiare” dhe “përvoja” deklarohen, por nuk konkretizohen. Kur licencohet për herë të parë një shoqëri e re (themeluar 20.09.2024), pohimi për “aftësi financiare” dhe “përvojë të mjaftueshme” kërkon minimumi shenja: kapitalizim, burime financimi, bilance/projektime, transferim aktivesh, marrëveshje shërbimi, etj. Dokumenti nuk jep asnjë element të tillë.

Aspekti i konkurrencës është i përmendur, por jo i analizuar. Përmendet ligji nr. 9121 për konkurrencën dhe “mos abuzim me pozitën dominuese”, por kjo mbetet fjali standarde. Në sektorin e ujësjellësit (monopol natyror), pjesa “konkurrencë” duhet të shpjegohet: çfarë

kuptohet praktikisht (p.sh. sjellje tarfore, akses, jo-diskriminim), ose pse konsiderohet e përmbushur.

Verifikimi i drejtuesve: i pabalancuar Për drejtuesin teknik jepet arsimimi dhe konstatimi se plotëson VKM 958. Për drejtuesin ligjor thjesht jepet emri, pa asnjë kriter/arsyetim.

Mungon logjika e “transferimit operacional” në një shoqëri rajonale të sapokrijuar Vendimi pranon se shoqëria deklaron shërbim për 309,732 banorë, por nuk sqaron mekanizmin: si u bë kalimi nga shoqëritë e mëparshme (Vlorë/Selenicë) te shoqëria rajonale, çfarë aktesh/kontratash/transferimesh ekzistojnë për të garantuar vazhdimësinë, asetet, personelin, detyrimet, kreditë, etj. Kjo është thelbësore për riskun e vazhdueshmërisë së shërbimit.

A ka lidhje logjike midis fakteve/argumenteve dhe vendimmarrjes përfundimtare?

Po, por kryesisht në nivel formal.

Faktet e paraqitura (aplikimi me shkresa, themelimi i shoqërisë, aksionarët, zona dhe popullsia, drejtuesi teknik që “plotëson” VKM 958) e mbështesin në parim konkluzionin për licencim.

Megjithatë, hallka logjike që mungon është “ura provuese”: vendimi thotë se u vlerësuan aftësitë teknike/financiare/përvoja dhe interesat e konsumatorëve, por nuk tregon rezultatet e atij vlerësimi. Kështu, lidhja midis argumenteve dhe vendimit përfundimtar është deklarative, jo e demonstrueshme.

Arsyetim i pamjaftueshëm dhe dokumentim i paplotë i verifikimeve që justifikojnë dhënien e licencës.

Rreziku kryesor që del nga ky akt është se licencimi “për herë të parë” i një shoqërie të sapokrijuar (20.09.2024) mbështetet në fraza të përgjithshme për aftësi financiare, përvojë dhe garanci shërbimi, pa e bërë të dukshëm testin real të këtyre pretendimeve. Në një shërbim jetik si uji, problemi nuk është vetëm “formalisht e licencuam”, por a është licencuar një entitet që realisht ka kapacitet operacional dhe financiar për të mbajtur pa ndërprerje shërbimin dhe për të menaxhuar riskun (rrjete, humbje uji, investime, emergjenca, detyrime ndaj palëve). Kur vendimi shfuqizon licencat e mëparshme (2022/2021) dhe kalon te struktura rajonale, mungesa e përshkrimit të mekanizmit të transferimit (asete/kontrata/personel/detyrime) krijon “zonë gri” përgjegjësie: në rast dështimi, është e paqartë çfarë u konsiderua provë e mjaftueshme nga rregullatori për të garantuar vazhdueshmërinë.

Në lidhje me licencimin e UK Korçë:

Shoqëria ka paraqitur kërkesë për rinovim të licencës mbi bazën e të cilës është miratuar Vendimi nr. 52, datë 20.12.2024 i KKRR pranë ERRU “Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë sh.a.”.

Nga vendimi rezultoi se:

Licenca jepet në Kategoritë A, C dhe D (uji për konsum publik; largimi i ujërave të ndotura; trajtimi i ujërave të ndotura), me zonë shërbimi bashkitë e mësipërme dhe afat 4-vjeçar.

Dobësitë dhe risqet në lidhje me vendimarrjen

Arsyetim ku deklarohen vlerësime, por mungon prova ERRU shprehet se ka marrë në konsideratë aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare, përvojë sektoriale dhe mbrojtjen e konsumatorit (cilësi, eficiencë, vazhdueshmëri, garanci shërbimi), por nuk tregon asgjë konkrete: indikatorë, dokumente, bilance, plan investimesh, performancë, risk-e, apo gjetje gjatë verifikimit.

“Aftësia financiare” nuk evidentohet. Kur pretendon se u vlerësua aftësia financiare “e nevojshme për të përmbushur funksionet”, pritet të paktën një sinjal: kapital, financim, bilanc, detyrime, tregues likuiditeti, etj. Dokumenti nuk jep asnjë të dhënë financiare.

Drejtuesi ligjor: vetëm emër, pa kriter/verifikim. Ndryshe nga drejtuesit teknikë, drejtuesi ligjor (Petrit Tare) figuron vetëm si emër. Nuk shfaqet asnjë element i “përshtatshmërisë” (kualifikim, eksperiencë, konflikt interesi, etj.) dhe as lidhja me kriteret e rregullores. Kjo lë boshllëk kontrolli për rolin që firmos kushtet e licencës.

Dy gjëra janë realisht “problematiche” në këndvështrimin auditues. E para është paqartësia procedurale: dokumenti e quan aktin “licencim”, por motivon kërkesën “për shkak të mbarimit të afatit”—dy realitete të ndryshme që ndikojnë në standardin e provës (rinovimi zakonisht kërkon edhe elementë performance/kompliance gjatë periudhës së kaluar). E dyta është mungesa e arsytimit thelbësor: kur vendimi pretendon se ka vlerësuar aftësinë financiare dhe garancinë e shërbimit, por nuk shfaq asnjë tregues, ai e kthen procesin rregullator në “rit formal” dhe jo në kontroll real të riskut publik. Në një shërbim jetik si uji, kjo krijon rrezik institucional: në rast dështimi të shërbimit (ndërprerje, cilësi, emergjenca), nuk mbetet e dokumentuar pse rregullatori e konsideroi subjektin të aftë dhe mbi cilat prova u mbështet — pra dobësohet përgjegjshmëria dhe kapaciteti i auditimit ex-post.

Në lidhje me licencimin e UK Vorë

Shoqëria ka paraqitur kërkesë për rinovim të licencës mbi bazën e të cilës është miratuar Vendimi nr. 54, datë 20.12.2024 i Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) pranë ERRU, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjetellës Kanalizime Vorë sh.a.”, i cili në thelb përfaqëson rinovimin e licencës për shkak të mbarimit të afatit.

Nga auditimi rezultoi se:

Shoqëria licencohet në Kategorinë A (grumbullim dhe shpërndarje uji për konsum publik) dhe Kategorinë C (largim ujërash të ndotura), me afat licence 4-vjeçar.

Përsa i përket auditimit të vendimit rezultoi si më poshtë:

Paqartësi terminologjike: “licencim” vs “rinovim licence” Titulli i vendimit flet për “licencim”, ndërsa në përmbajtje rezultoi qartë se kërkesa bëhet “për shkak të mbarimit të afatit”, pra për rinovim. Kjo mospërputhje nuk është thjesht redaksionale: në audit, ajo krijon paqartësi mbi standardin e vlerësimit (rinovimi kërkon edhe analizë performance të periudhës së kaluar).

Arsyetim substancial i pamjaftueshëm Vendimi deklaron se janë marrë në konsideratë aftësitë tekniko-profesionale, aftësitë financiare, përvoja dhe mbrojtja e interesave të konsumatorëve, por nuk jep asnjë provë konkrete: as tregues financiarë, as bilance, as rezultate performance, as vlerësim të cilësisë së shërbimit gjatë licencës së mëparshme.

Mungesë vlerësimi të performancës historike Për një shoqëri që ka operuar që nga viti 2016 dhe ka pasur licencë 2020–2024, pritej minimalisht një pasqyrë e shkurtër e performancës (vazhdueshmëria e furnizimit, ankesa, cilësia, humbjet e ujit). Vendimi e anashkalon plotësisht këtë aspekt.

Aftësia financiare trajtohet vetëm deklarativisht. Edhe pse përmendet “aftësia financiare e nevojshme”, nuk jepet asnjë element që ta mbështesë këtë pohim. Kjo cilësohet si boshllëk prove, sidomos në një shërbim jetik me ndikim direkt te konsumatorët.

Vlerësimi i drejtuesit ligjor mbetet formal Ndryshe nga drejtuesi teknik, për drejtuesin ligjor jepet vetëm emri, pa asnjë analizë të kualifikimit, përvojës apo integritetit. Kjo krijon pabarazi në standardin e verifikimit dhe rrezik formalizmi.

Problemi më i thellë i këtij akti është se rinovimi i licencës trajtohet thujse njësoj si licencimi fillestar, pa reflektuar mësimet dhe përgjegjësinë që vjen nga performanca e kaluar. Në një shërbim jetik si furnizimi me ujë, rinovimi duhet të jetë momenti kyç i rregullatorit për të testuar nëse operatori realisht e ka justifikuar besimin publik: a ka ofruar shërbim të qëndrueshëm, a ka menaxhuar risket, a ka respektuar konsumatorin. Kur këto pyetje nuk adresohen në vendim, procesi rregullator rrezikon të kthehet në formalitet administrativ, duke dobësuar përgjegjshmërinë institucionale dhe duke kufizuar rëndë aftësinë e auditimit ex-post.

Konkluzione të përgjithshme:

1. Procedura e licencimit është e formalizuar, por dosjet nuk janë gjithmonë të plota

-Jo në të gjitha dosjet ndodhen të gjithë dokumentet e kërkuara sipas rregullores (p.sh. disa mungesa në dokumentacion teknik dhe financiar);

-Në disa raste, verifikimet paraprake të kryera nga stafi teknik nuk janë të dokumentuara me raporte të posaçme, por vetëm me shënime të brendshme/email.

Kjo cenon gjurmueshmërinë e procesit dhe e bën më të vështirë verifikimin e përmbushjes reale të kriterëve nga operatorët.

2. Monitorimi i kushteve të licencës nuk dokumentohet në mënyrë sistematike

Rregullorja e licencimit dhe kushtet e licencës parashikojnë detyrime të operatorëve për cilësinë e shërbimit, raportimin periodik dhe përmbushjen e indikatorëve të performancës.

Nga auditimi rezultoi se:

-Nuk ekziston gjithmonë një lidhje e qartë dhe e dokumentuar ndërmjet raporteve periodike dhe vlerësimit formal të përmbushjes së kushteve të licencës (p.sh. vendime për paralajmërime, masa administrative, kushtëzime në rinovimin e licencës).

Nisur nga kjo krijohet bindja se licenca është më shumë një akt formal, sesa një instrument rregullimi i lidhur ngushtë me performancën e operatorëve.

3. Në lidhje me zbatimin e metodologjisë së tarifave mungon dokumentimi i plotë i të dhënave dhe arsyetimeve

Nga shqyrtimi i disa vendimeve tarifore për operatorë të ndryshëm rezultoi se:

ERRU aplikon elementët kryesorë të metodologjisë (llogaritja e kostove, parashikimi i të ardhurave, amortizimi, investimet);

por dokumentacioni mbështetës në dosje nuk është gjithmonë i strukturuar në mënyrë të tillë që të lejojë një rindërtim të plotë të logjikës së vendimit (p.sh. mungesë tabelash krahasuese të qarta, mungesë analize të detajuar të ndikimit në konsumator etj.).

Në disa raste mungojnë dokumentet që tregojnë se si komentet e operatorëve dhe të palëve të interesit janë marrë parasysh para miratimit të tarifave.

4. Mangësi në zbatimin e kushteve vjetore të licencës (raportimi vjetor dhe pasqyrat financiare)

“Kushtet e licencës” vendosin një paketë detyrimesh raportimi: raport vjetor tekniko-operacional deri më 31 dhjetor (KPI, bilanci i ujit, regjistri i konsumatorëve, kostot, ankesat, zbatimi i kontratës model), si dhe raporti i ekspertit kontabël + pasqyrat financiare deri në fund të prillit. Është evidentuar nivel i ulët saktësie dhe plotësie i të dhënave, si dhe vonesa në raportim. Kjo çështje është thelbësore për cilësinë e funksionit rregullator për shkak se:

pa raporte vjetore të plota, ERRU nuk mund të vlerësojë realisht performancën (Ujë pa të ardhura (UPA), cilësia, furnizimi, kanalizimet);

pa pasqyra financiare të audituara në kohë, rregullatori nuk mund të vlerësojë kostot reale, mbulimin e kostove dhe nevojat tarifore;

treguesit e raportuar janë më shumë “deklarativë” se sa të verifikuar, gjë që ERRU vetë e pranon si problem të saktësisë së të dhënave.

Pra në rastin konkret kemi të bëjmë me vendimmarrje rregullatore mbi bazë të dhënash të pasakta (tarifa, investime, indikatori UPA) si edhe tarifat e miratuara mund të mos reflektojnë kostot reale, duke krijuar barrë të padrejtë tarifore për konsumatorin.

5. Licenca nuk lidhet në mënyrë të matshme me objektiva konkrete performancë (UPA, arkëtim, cilësia e shërbimit)

Kushtet e licencës parashikojnë që i licencuari të zbatojë parimet e eficiencës ekonomike dhe standardet/objektivat e përcaktuara nga KKRR. Megjithatë, në praktikë licencat janë kryesisht “formale”:

nuk përmbajnë targete të qarta, numerike për uljen e UPA;

nuk kushtëzojnë licencën me përmirësimin e nivelit të arkëtimeve;

nuk parashikojnë KPI të detyrueshëm (p.sh. orë furnizimi minimale, kufij për shkelje të cilësisë) si “kusht licencimi”.

-Duke qenë se UPA 61.1% dhe arkëtimet rreth 83% janë tregues të një sektori me dobësi të mëdha, fakti që licencat nuk e përfshijnë performancën pjesë të kushteve të qarta të licencës tregon se:

ERRU nuk po përdor plotësisht mjetet ligjore që ka në dispozicion për të imponuar përmirësim të performances të operatorëve;

Licenca shihet më shumë si instrument formal për të “Lejuar aktivitetin”, dhe jo si kontratë rregullatore me objektiva të matshëm;

Kjo është në mospërputhje me parimin e eficiencës dhe mbrojtjes së konsumatorit të parashikuar në Ligjin 8102.

6. Zbatim jo i plotë i kompetencës së ERRU për kontrollin dhe inspektimin e kushteve të licencës

- Nga ana e ERRU nuk janë kryer kontrole për zbatimin e kushteve të licencës, dokumentacionin dhe çdo të dhënë tjetër, për të verifikuar përputhjen e kryerjes së aktivitetit me kushtet e licencës, rregullat dhe standartet në fuqi.

-Nga auditimi i informacionit të vënë në dispozicion rezultoi se pavarësisht gjetjeve të rezultuara nga monitorimi formal i ERRU mungojnë mekanizmat e lidhjes midis gjetjeve të monitorimit dhe veprimeve konkrete (urdhrra rregullatorë, masa administrative, modifikim i licencës, rishikim i kushteve).

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën e administruar në KLSH me nr. 1052/10 prot., datë 05.03.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. Auditimi ka tejkaluar objektin e tij duke vlerësuar përmbajtjen e metodologjisë dhe duke ndërhyrë në diskrecionin rregullator të ERRU/KKRR; sipas subjektit, auditimi duhej të kufizohej në verifikimin e procedurës.

2. Lidhur me standardin e arsytimit të akteve administrative, ERRU pretendon se vendimmarrja mbështetet në analiza teknike, financiare dhe sociale; mungesa e detajeve të plota në vendim nuk cenon ligjshmërinë, pasi analizat dhe evidencat përkatëse gjenden në dosje.

3. ERRU deklaron se në çdo rast janë zhvilluar seanca dëgjimore me publikun dhe janë marrë mendimet e këshillave bashkiakë përkatës, në përputhje me metodologjinë dhe legjislacionin në fuqi. Sipas saj, procesverbalet janë administruar rregullisht dhe qëndrimet e publikut dhe pushtetit vendor janë marrë në konsideratë në analizën tekniko-ekonomike.

4. Sipas ERRU, mendimi i këshillave bashkiakë ka karakter këshillimor dhe nuk kufizon kompetencën e ERRU-s dhe KKRR-së për miratimin e tarifave; rrjedhimisht, mosdakordësia e pushtetit vendor nuk cenon ligjshmërinë e vendimit rregullator.

5. Në lidhje me parimin e vendimmarrjes mbi të dhëna të verifikuara, ERRU thekson se verifikon dhe, kur është e nevojshme, korrigjon të dhënat e raportuara nga shoqëritë (p.sh. popullsi, vëllime, klientë), ndaj vendimmarrja nuk bazohet në të dhëna të pasakta.

6. Për sa i përket Ujit Pa të Ardhura (UPA), ERRU argumenton se ky tregues trajtohet nëpërmjet metodologjisë së tarifave dhe mekanizmave të monitorimit, me synim uljen graduale të tij përmes forcimit financiar dhe përmirësimit të performancës së shoqërive.

7. ERRU pretendon se kriteri i përballueshmërisë së tarifave ($\leq 5\%$ e të ardhurave familjare) është respektuar dhe se vendimmarrja tarifore nuk krijon problem social.

8. Sipas ERRU, subvencionet përbëjnë një instrument legjitim mbështetës për sektorin dhe qëndrueshmëria financiare e operatorëve sigurohet përmes kombinimit të të ardhurave nga tarifat dhe mbështetjes publike.

9. ERRU pretendon se vendimet rregullatore përfshijnë objektiva performance dhe mekanizma monitorimi, duke siguruar lidhjen ndërmjet tarifave dhe performancës së operatorëve.

10. ERRU argumenton se struktura tarifore dhe diferencimi ndërmjet kategorive të konsumatorëve respektojnë kufijtë e përcaktuar në metodologji, përfshirë raportet ndërmjet kategorive dhe kufirin e tarifës fikse ndaj kostove operative.

11. ERRU pretendon se vendimet e licencimit janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, pasi referojnë bazën ligjore dhe bazohen në dokumentacionin e paraqitur nga shoqëritë përkatëse.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Observacionet e paraqitura nuk merren në konsideratë, pasi në thelb përbëjnë përsëritje të pretendimeve të trajtuara më parë dhe nuk shoqërohen me dokumente, prova apo argumente të reja që të justifikojnë rishikimin e qëndrimit të mbajtur më parë nga grupi i auditimit. Për rrjedhojë, konstatimet dhe vlerësimet e pasqyruara në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit mbeten të pandryshuara.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, rezultoi se për periudhën objekt auditimi, Enti Rregullator i Ujit ka ngritur një sistem jo efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruar për këtë qëllim, siç janë politikat menaxheriale dhe stili i punës, struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkia dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

- Nuk është miratuar një rregullore e re në përputhje me ndryshimet strukturore.

- Nuk është dërguar pranë Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”, si dhe “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm” dhe “Raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon”, në kundërshtim me Ligjin nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1. faqet nr. 14-28 të Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Enti Rregullator i Ujit të marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme të institucionit, në përputhje me ndryshimet strukturore.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se planifikimi dhe ndjekja e fondit të pagave për vitet 2024 dhe periudhën e raportuar të vitit 2025 nuk kanë reflektuar në mënyrë të plotë ndikimin e ndryshimeve ligjore e nënligjore, dinamikat reale të personelit, vendet vakante dhe nevojat faktike për zërat përbërës të fondit. Për vitin 2024, megjithëse kanë hyrë në fuqi ndryshime me efekt financiar në paga, institucioni nuk ka paraqitur kërkesë për rishikim ose shtesë të planit buxhetor, me argumentin se efektet janë mbuluar nga fondet e lira të krijuara nga vakancat e përkohshme. Njëkohësisht, fondi i pagave është realizuar në masën 87.19% të planit, me mosrealizim 6,054,435 lekë, ndërsa e njëjta situatë paraqitet edhe në periudhën e raportuar të vitit 2025, ku realizimi i fondit të pagave është 72.78% dhe “Fondi i veçantë” rezultoi me përdorim minimal krahasuar me planifikimin. Kjo situatë tregon mangësi në planifikimin dhe rishikimin e fondit të pagave, duke sjellë mospërputhje ndërmjet planifikimit dhe realizimit faktik, si dhe duke cenuar cilësinë e planifikimit buxhetor, transparencën, gjurmueshmërinë dhe efikasitetin në përdorimin e burimeve financiare.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4. faqet nr.45-50 të Raportit të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Enti Rregullator i Ujit të marrë masa që, në planifikimin dhe rishikimin e fondit të pagave, të sigurojë vlerësim të plotë, realist dhe të dokumentuar të ndikimit buxhetor që rrjedh nga ndryshimet ligjore e nënligjore, dinamikat e personelit, vendet vakante dhe nevojat reale për zërat përbërës, përfshirë “Fondin e veçantë”. Në çdo rast, të formalizohet analiza për mbulimin e efekteve financiare dhe, kur është e nevojshme, të ndiqen në kohë procedurat për rishikimin e planit buxhetor, me qëllim përmirësimin e cilësisë së planifikimit, transparencës, gjurmueshmërisë dhe efikasitetit në përdorimin e burimeve financiare.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, në shqyrtimin e aplikimeve tarifore për shoqëritë rajonale UK, baza e të dhënave volumetrike dhe teknike (veçanërisht prodhimi i ujit) paraqitet në shumë raste e pasigurt. Kjo pasi një pjesë domethënëse e prodhimit nuk matet

realisht në burime/stacione pompimi dhe rezultoi e vlerësuar, duke cenuar besueshmërinë e bilancit të ujit, të kostos për m³, të projeksioneve të të ardhurave dhe të vetë logjikës së vendimarrjes tarifore. Nga auditimi rezultoi se fenomeni i prodhimit të ujit të vlerësuar është evidentuar në 8 raste, përkatësisht në UK Rajonale Lezhë, Durrës, Shkodër, Berat, Gjirokastrë, Fier, Korçë dhe Pogradec. Në këto raste, niveli i matjes së prodhimit rezultoi shumë i ulët ose prodhimi rezultoi në masë të konsiderueshme i vlerësuar, duke treguar mangësi në matjen e saktë të prodhimit dhe duke cenuar besueshmërinë e të dhënave mbi performancën operacionale. Mungesa e matjes së besueshme në pikat kyçe të prodhimit ndikon drejtpërdrejt në saktësinë e bilancit të ujit dhe në identifikimin e volumit real të ujit të faturueshëm, duke krijuar pasiguri në projeksionet e të ardhurave të shoqërive Ujësjetellës Kanalizime dhe në vlerësimin e treguesit “ujë pa të ardhura”. Si rrjedhojë, rritet rreziku i diferencave ndërmjet ujit të prodhuar dhe atij të faturuar, duke ndikuar në performancën financiare të operatorëve dhe në aftësinë e tyre për të mbuluar kostot operative të shërbimit, si dhe duke krijuar potencial për akumulimin e detyrimeve financiare të prapambetura.

Në këto kushte, vendimarrja rregullatore për tarifa ndërtohet mbi input-e të pasigurta, çka rrit rrezikun e vendimeve jo-proporcionale dhe të vështira për t’u verifikuar ex-post.

Veprime në mospërputhje me nenet 13, 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539 datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjetellës kanalizime”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6. faqet nr.63-90 të Raportit të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Enti Rregullator i Ujit të marrë masa që procesi i miratimit të tarifave të kushtëzohet me prova të verifikueshme për matjen në pikat kyçe të prodhimit (burime, stacione pompimi, dalje impiantesh), duke kërkuar në dosje dokumentim teknik të matjes (inventar i pikave të matjes, certifikim/kalibrim, leximet periodike dhe krahasimet).

Gjithashtu, në kuadër të forcimit të besueshmërisë së të dhënave mbi të cilat ndërtohen projeksionet tarifore dhe financiare të shoqërive UK, ERRU të kërkojë monitorimin dhe analizën sistematike të diferencave ndërmjet volumit të prodhuar dhe atij të faturuar, me qëllim reduktimin e ujit pa të ardhura dhe minimizimin e rreziqeve që lidhen me uljen e të ardhurave dhe krijimin e detyrimeve financiare shtesë të operatorëve. Në rastet kur prodhimi rezultoi në masë të konsiderueshme i vlerësuar, miratimi i tarifave të bëhet i fazuar dhe i lidhur me përmbushjen e një plani të detyrueshëm për instalim dhe operacionalizim matësash brenda afateve të përcaktuara.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave të miratimit të tarifave rezultoi se niveli i lartë i Ujit Pa të Ardhura (UPA), i cilësuar në disa raste si “i papranueshëm”, mbetet problem strukturor që nuk trajtohet me masa detyruese proporcionalisht me peshën e tij në kosto dhe në padrejtësinë ekonomike ndaj konsumatorit korrekt, duke krijuar rrezikun që tarifa të përdoret si instrument mbulimi i pasojave të joeficiencës dhe jo si instrument reformues. Kjo problematikë evidentohet veçanërisht në UK Rajonale Lezhë (UPA rreth 74.14%), UK Rajonale Shkodër (UPA rreth 67.01%), UK Rajonale Fier (UPA rreth 69.59%), si edhe në raste të tjera me humbje të larta, ku tarifa rritet pa u shoqëruar me kushte të forta zbatimi për reduktimin real të humbjeve, eliminimin e lidhjeve të paligjshme, reduktimin e nënfaturimit dhe ndërhyrjet në rrjete. Veprime në mospërputhje me nenet 13, 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar dhe vendimit të Komisionit Kombëtar

Rregullator nr. 539 datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6. faqet nr.63-90 të Raportit të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Enti Rregullator i Ujit të marrë masa që, në vendimmarrjet tarifore për operatorët me treguesin Uji Pa të Ardhura (UPA) të lartë, të vendosë kushte të detyrueshme performance (jo vetëm objektiva deklarative), të shoqëruara me plan veprimi të verifikueshëm dhe monitorim periodik, duke përcaktuar qartë indikatorët, afatet, provat që operatori duhet të dorëzojë, si dhe pasojat rregullatore në rast mospërbushjeje .

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se lidhja “tarifë → investime/ndërrhyrje → rezultat i matshëm në cilësi shërbimi” mbetet në shumë raste e përgjithshme dhe jo e mbyllur me gjurmueshmëri financiare dhe kohore, duke dobësuar arsyetimin e proporcionalitetit dhe eficiencës së rritjes tarifore. Në disa analiza dhe vendimmarrje, identifikohen nevoja reale (pajisje me matësa, riparime rrjeti, reduktim humbesh, përmirësim efience energjetike), por mungon konkretizimi se çfarë ndërrhyrjesh financohen nga të ardhurat shtesë, në çfarë vëllimi, në cilat njësi problematike dhe në çfarë afati, çka evidentohet në mënyrë tipike në rastet Durrës, Shkodër, Berat, Elbasan, Fier dhe Pogradec, ku investimet dhe përmirësimet e pritshme përmenden pa u operacionalizuar në matricë të gjurmueshme. Veprime në mospërputhje me nenet 13, 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539 datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6. faqet nr.63-90 të Raportit të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Enti Rregullator i Ujit të marrë masa që, si pjesë e dosjes dhe e arsyetimit të vendimit, të kërkojë dhe të formalizojë një plan investimesh/ndërrhyrjesh të gjurmueshëm (me prioritete, kosto të vlerësuara, njësi përfituese, afate dhe indikatorë rezultati), si dhe të integrojë në vendimmarrje një lidhje të qartë mes të ardhurave shtesë dhe rezultateve të verifikueshme në terren, duke e bërë këtë lidhje pjesë të kushteve monitoruese gjatë periudhës rregullatore.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se analiza e përballueshmërisë përdoret në disa raste në mënyrë formale, duke u mbështetur te kufiri statistikor , si 5 % e shpenzimeve mesatare mujore për Njësi Ekonomike Familjare, ndërkohë që vetë dokumentacioni evidenton rritje të larta relative të faturës në njësi të caktuara, të cilat krijojnë rrezik social dhe rrezik përkeqësimi të arkëtimeve, veçanërisht në zonat me shërbim të dobët. Kjo evidentohet qartë në Lezhë (rritje të larta relative në Kurbin/Rrëshen/Rubik), si edhe në Korçë ku rritjet në disa segmente rurale rezultojnë shumë të ndjeshme (deri në disa herë), duke krijuar mospërputhje midis testit formal dhe realitetit të ndikimit. Veprime në mospërputhje me nenet 13, 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539 datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6. faqet nr.63-90 të Raportit të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Enti Rregullator i Ujit të marrë masa që analiza e përballueshmërisë të realizohet e diferencuar sipas njësive, kategorive të konsumatorëve dhe veçorive territoriale,

duke reflektuar rritjen relative dhe rrezikun e mos-pagesës, si dhe të aplikojë instrumente rregullatore zbutëse, kur identifikohen tejkalime të mëdha

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, në një pjesë të vendim-marrjeve tarifore, rezultoi kontradiktë midis objektivit të deklaruar për qëndrueshmëri financiare dhe pranimi të varësisë nga subvencionet për mbulimin e një pjese të kostove, pa u shoqëruar me analizë të mjaftueshme risku për sigurinë, kohën dhe garantimin e subvencionit. Kjo evidentohet në rastin e UK Rajonale Lezhë, ku pranohet mbulim jo i plotë i kostove operacionale dhe të mirëmbajtjes dhe nevoja për subvencion, pa u pasqyruar qartë mekanizmi/rreziku fiskal në rast mosfinancimi. Veprime në mospërputhje me nenet 13, 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539 datë 30.12.2021 "Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime".

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6. faqet nr.63-90 të Raportit të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Enti Rregullator i Ujit të marrë masa që, kur vendimmarrja tarifore parashikon ose presupozon mbështetje nga subvencionet, dosja dhe vendimi të përfshijnë analizë të qartë risku, si burimi, probabiliteti, afatet e disbursimit, skenarët në rast vonese/mosfinancimi dhe të parashikojnë masa rregullatore parandaluese për të mos transferuar rrezikun e mos qëndrueshmërisë te konsumatori ose te cilësia e shërbimit.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se objektivat e performancës, edhe kur vendosen, në disa raste kanë karakter kryesisht deklarativ dhe nuk shoqërohen me mekanizma të qartë kushtëzimi, korrigjimi ose pasojash në rast mos përmbushjeje, duke ulur efektivitetin e tarifës si instrument rregullator. Kjo problematikë evidentohet veçanërisht në rastin e Lezhës, ku vendosen objektiva për ujin pa të ardhura, matjen, vazhdimësinë dhe arkëtimin, por pa u bërë e qartë lidhja e tyre me mekanizëm detyrues dhe i verifikueshëm. Veprime në mospërputhje me ligjin nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence", si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6. faqet nr.63-90 të Raportit të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Enti Rregullator i Ujit të marrë masa për të siguruar që objektivat e performancës të përfshihen si kushte të detyrueshme dhe të monitorueshme në kuadër të periudhës rregullatore. Për secilin tregues duhet të përcaktohen qartë: metoda e matjes dhe verifikimit, burimi i të dhënave, frekuenca e raportimit, si dhe pragjet minimale vjetore të performancës. Gjithashtu, duhet të parashikohen pasojat rregullatore në rast devijimi, duke përfshirë rishikimin e planit tarifor, vendosjen e masave administrative brenda kompetencave të institucionit, ose përcaktimin e kushteve shtesë në kontratën rregullatore.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i proceseve të licencimit/rinovimit të licencave, rezultoi se arsyetimi substancial mbi aftësitë tekniko-profesionale, financiare, përvojën dhe mbrojtjen

e konsumatorëve shfaqet kryesisht deklarativ, pa u shoqëruar me tregues të sintetizuar dhe prova të dokumentuara që e bëjnë vendim-marrjen të testueshme dhe të verifikueshme. Kjo problematikë evidentohet në rastin e licencimit/rinovimit të UK Korçë, licencimit të UK Vlorë dhe rinovimit të UK Vorë, ku theksohen paqartësi terminologjike “licencim” kundrejt “rinovim”, mungesë vlerësimi të performancës historike për rinovimet, mungesë konkretizimi të “aftësisë financiare”, si dhe standard i pa balancuar i verifikimit të drejtuesve (drejtues ligjor i pasqyruar vetëm nominalisht). Veprime në mospërputhje me ligjin nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, VKM nr. 958, datë 06.05.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”, si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6. faqet nr.63-90 të Raportit të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Enti Rregullator i Ujit të marrë masa që vendimet e licencimit/rinovimit të shoqërohen me arsyetim të provuar dhe të dokumentuar, duke përfshirë minimalisht një përmbledhje të treguesve teknikë, financiarë dhe të performancës (sidomos për rinovimet), një matricë “kriter–provë” që lidh dokumentet e dosjes me kriteret ligjore/nënligjore, si dhe standard të njëjtë verifikimi për drejtuesin ligjor dhe teknik, me gjurmueshmëri të verifikimeve të kryera nga strukturat përgjegjëse.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i tre procedurave të licencimit/rinovimit të licencës rezultoi se, ndonëse kuadri procedural i ndjekur nga ERRU paraqitet i formalizuar, dosjet administrative të licencimit nuk rezultojnë të plota, të standardizuara dhe të ndërtuara sipas një logjike të qartë “kriter–provë–vlerësim–vendim”. Janë konstatuar mungesa në dokumentacionin teknik dhe financiar, si dhe verifikimet paraprake të kryera nga strukturat përgjegjëse nuk rezultojnë të formalizuara në raporte të posaçme, të nënshkruara dhe të administruara në dosje, por vetëm në shënime të brendshme apo komunikime elektronike. Si pasojë, vendimmarrja rregullatore mbetet e vështirë për t’u rindërtuar ex-post dhe dobësohet prova administrative që duhet të mbështesë përfundimin se operatori i ka përmbushur realisht kriteret ligjore dhe nënligjore për licencim/rinovim. Veprime në mospërputhje me ligjin nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, VKM nr. 958, datë 06.05.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6. faqet nr.63-90 të Raportit të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Enti Rregullator i Ujit të marrë masa për standardizimin e dosjes së licencimit dhe rinovimit të licencave, duke përcaktuar një listë kontrolli të detyrueshme dhe të arkivueshme për dokumentacionin shoqërues, si dhe të kërkojë që verifikimet paraprake nga strukturat teknike dhe financiare të formalizohen në raporte të shkruara dhe të nënshkruara, jo vetëm në formën e shënimeve apo komunikimeve të brendshme, me qëllim që procesi i vendimmarrjes të jetë i dokumentuar.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se monitorimi i kushteve të licencës nuk dokumentohet në mënyrë sistematike dhe mungon lidhja e qartë ndërmjet raporteve periodike të operatorëve dhe vlerësimit formal të përmbushjes së kushteve të licencës, duke e bërë licencën më shumë akt formal sesa instrument rregullator i lidhur me performancën.

Veprime në mospërputhje me ligjin nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence", si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6. faqet nr.63-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Enti Rregullator i Ujit të marrë masa që të krijojë dhe të zbatojë një mekanizëm monitorimi të dokumentuar me regjistër të kushteve të licencës, raportime periodike, vlerësime vjetore të përputhshmërisë dhe vendimmarrje korrigjuese, ku gjetjet e monitorimit të shoqërohen me veprime konkrete rregullatore brenda kompetencave.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në zbatimin e metodologjisë së tarifave mungon në disa raste dokumentimi i plotë dhe i strukturuar i të dhënave dhe arsyetimeve, duke mos lejuar gjithmonë rindërtimin e plotë të logjikës së vendimit (mungesë tabelash krahasuese të qarta dhe mungesë analize të detajuar të ndikimit të konsumatori), si dhe mungesë dokumentesh që provojnë integrimin e komenteve të operatorëve dhe palëve të interesit para miratimit përfundimtar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6. faqet nr.63-90 të Raportit të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Enti Rregullator i Ujit të marrë masa që dosjet tarifore të strukturohen sipas një modeli unik të dokumentimit, ku përfshihen të detyrueshme: tabelat krahasuese (të dhënat e operatorit, korrigjimet, arsyetimi i korrigjimeve), analiza e ndikimit të konsumatori (përfshirë rritjen relative sipas njësive), si dhe një seksion i dokumentuar "konsultim-trajtim komentesh" që tregon se çfarë u pranua/refuzua dhe pse, me qëllim garantimin e transparencës dhe krijimin e një gjurme të plotë auditimi.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se zbatimi i detyrimeve vjetore të licencës për raportim tekniko-operacional dhe financiar shfaq vonesa dhe nivel të ulët saktësie/plotësie të të dhënave, duke e ekspozuar funksionin rregullator ndaj vendimmarrjes mbi baza të pasigurta dhe duke rritur rrezikun që tarifat e miratuara të mos reflektojnë kostot reale dhe performancën reale të operatorëve. Veprime në mospërputhje me ligjin nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence", si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6. faqet nr.63-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: Enti Rregullator i Ujit të marrë masa që të forcojë mekanizmat e detyrimit dhe kontrollit të raportimit vjetor (afate, format, kërkesa minimale për cilësinë e të dhënave), duke vendosur procedura verifikimi të brendshëm dhe, kur është e nevojshme, masa korrigjuese për operatorët që nuk paraqesin raporte të plota e të sakta, në mënyrë që vendimmarrja tarifore dhe ajo e licencimit të mbështetet në të dhëna të verifikuara dhe të krahasueshme.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se Enti Rregullator i Ujit nuk ka ushtruar kompetencën dhe detyrimin ligjor për kryerjen e kontroleve/inspektimeve të kushteve të licencës, çka dobëson përdorimin e licencës si instrument rregullator me qëllim nxitjen apo dhe kushtëzimin e përmirësimit të performancës së operatorëve. Veprime në mospërputhje me ligjin nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence", si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6. faqet nr.63-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1 Rekomandimi: Enti Rregullator i Ujit të marrë masa që të planifikojë e dokumentojë kontrole/inspektime periodike për verifikimin e kushteve të licencës, duke krijuar lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet gjetjeve të monitorimit/inspektimit dhe vendimmarrjeve rregullatore (kushtëzime, masa administrative, ose rishikime të kushteve), me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë dhe efektivitetit rregullator.

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i hartimit dhe zbatimit të programit ekonomiko-financiar për periudhën objekt auditimi, rezultoi se gjatë fazës së hartimit të planit të shpenzimeve për vitet 2024 dhe 2025, kërkesat për shpenzime nuk reflektojnë nevojat reale të sektorëve dhe drejtorive. Këto kërkesa janë hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse mbi bazën e kërkesave të viteve të mëparshme, duke u mbështetur kryesisht në shpenzime historike dhe pa përcaktuar qartë nevojat faktike të institucionit.

Gjithashtu, GMS nuk është përfshirë në hartimin e projekt-planit të shpenzimeve për vitet 2024 dhe 2025 për të analizuar dhe konsoliduar nevojat e institucionit, të cilat duhej të paraqiteshin nga sektorët dhe drejtoritë dhe më pas të përfshiheshin në projekt-plan për t'u paraqitur për miratim në KKRR. Veprime në kundërshtim me përcaktimet e nenit 40, pika 3, të rregullores së brendshme të ERRU, miratuar me Vendim të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 16, datë 28.04.2017, i ndryshuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe nga verifikimet në zyrën e protokollit të projekt-planit të shpenzimeve për vitet 2024 dhe 2025, rezultoi mungesa e detajimit të shpenzimeve për zërin shpenzime operative (602) dhe për investimet (230/231).

Këto mangësi krijojnë risqe të konsiderueshme për menaxhimin financiar të institucionit, pasi mungesa e specifikimit të nevojave reale mund të çojë në shpenzime të paqëllimshme ose joefektive, projekt-planet e pa detajuara vështirësojnë monitorimin dhe kontrollin e përdorimit të fondeve publike, dhe mos përfshirja e GMS në konsolidimin e nevojave të sektorëve dhe drejtorive zvogëlon transparencën dhe kontrollin mbi ekonomikitetin, efencën dhe efektivitetin e përdorimit të fondeve. Si pasojë, këto mangësi mund të ndikojnë negativisht në efektivitetin e shpenzimeve të buxhetit të ERRU dhe të rrisin rrezikun e përdorimit joefektiv të fondeve publike.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqet nr.28-42 të Raportit të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Grupi i Menaxhimit Strategjik, në bashkëpunim me drejtuesit e sektorëve/drejtorive të Enti Rregullator i Ujit, të vendosë dhe të zbatojë një procedurë të standardizuar për paraqitjen, analizimin dhe konsolidimin e kërkesave për shpenzime, të cilat duhet të paraqiten nga sektorët/drejtoritë përkatëse, duke kërkuar detajimin e plotë të nevojave

sipas zërave buxhetorë, respektimin e klasifikimit sipas librit të llogarive, si dhe argumentimin teknik dhe ekonomik të investimeve.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare, rezultoi se gjatë periudhës objekt auditimi, personat e autorizuar të ERRU kanë tërhequr dhe depozituar në arkën e institucionit mjete monetare në Lekë, Euro dhe USD, për paradhënie dhe pagesa cash për dieta dhe shpenzime transporti, brenda dhe jashtë vendit.

Konkretisht, u evidentuan 6 raste me 1,402,468 lekë, 12 raste me 24,458 euro dhe 3 raste me 1,565 USD. Nga shqyrtimi i ditarit të bankës dhe dokumentacionit të arkës rezultoi se gjendja cash nuk është depozituar në llogaritë bankare të ERRU pas realizimit të transaksioneve, por është mbajtur në arkë si gjendje e akumuluar. Nuk është respektuar limit i arkës. Gjithashtu, ERRU nuk ka hartuar dhe miratuar rregullore të brendshme që përcaktojnë rregullat për administrimin, ruajtjen dhe sigurinë fizike të mjeteve monetare. Pagesat për dieta dhe transport brenda vendit janë kryer jashtë sistemit bankar. Këto veprime lidhen me mungesën e një sistemi të formalizuar për administrimin e arkës, duke përfshirë rregulloret për dokumentimin, ruajtjen dhe kontrollin e mjeteve monetare. Si pasojë, veprimet e konstatuara rrisin rrezikun e përdorimit joefektiv dhe të pasigurt të fondeve të institucionit, duke cenuar transparencën, kontrollin dhe sigurinë e mjeteve monetare, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe rregullat për administrimin e arkës në institucionet publike.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqet nr.42-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1.Rekomandimi: Komisioni Kombëtar Rregullator, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Enti Rregullator i Ujit, të hartojë dhe miratojë një rregullore të veçantë për administrimin e vlerave monetare, ku të përcaktohen qartë mënyra e kryerjes së pagesave nga arka e institucionit, limitet e mbajtjes së vlerave monetare cash dhe masat për ruajtjen dhe sigurinë fizike të tyre.

Në vijimësi

17.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të përzgjedhura mbi bazë risku, rezultoi se në 6 procedura me vlerë të vogël, autoriteti kontraktor ERRU nuk ka respektuar kërkesat ligjore dhe nënligjore lidhur me llogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike, përbërjen e komisioneve, si dhe administrimin dhe dokumentimin e procesit të marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, të paraqitura si më poshtë

Për procedurat e prokurimit “Materiale Pastrimi” (2024) dhe “Kancelari” (2025).

Nga auditimi i procedurës “Materiale Pastrimi” për vitin 2024, me OE fitues XH... dhe vlerë oferte 197,000 lekë, si dhe i procedurës “Kancelari” për vitin 2025, me OE fitues L.D dhe vlerë oferte 135,000 lekë, rezultoi se:

Në komisionin e marrjes në dorëzim nuk është përfshirë punonjësi me përgjegjësi materiale, në kundërshtim me pikën 43 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Gjithashtu, mungon fleta e hyrjes së mallrave e nënshkruar nga përgjegjësi material.

Për Procedurën “Pajisje kompjuterike” (2024) dhe “Blerje pajisje informatike (monitorë dhe njësi qendrore)” – 2024.

Për procedurat e prokurimit “Pajisje kompjuterike” (viti 2024) dhe “Blerje pajisje informatike (monitorë dhe njësi qendrore)” (viti 2024):

Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Pajisje kompjuterike” për vitin 2024, me operator ekonomik fitues “I.S.T” në vlerën 511,380.00 lekë, si dhe i procedurës “Blerje pajisje

informatike (monitorë dhe njësi qendrore)” për vitin 2024, me operator ekonomik fitues “G..” në vlerën 139,000 lekë, rezultoi se: Kërkesat për këto pajisje dhe specifikimet teknike nuk janë hartuar nga një specialist i fushës së IT-së. Ofertat e siguruara në kuadër të studimit të tregut janë marrë në mungesë të specifikimeve teknike të mirëpërcaktuara. Gjithashtu, për këto procedura, KBVV nuk i është referuar burimeve/udhëzimeve të AKSHI-t lidhur me çmimet dhe specifikimet teknike për pajisjet informatike.

Në vijim, u konstatua se procesverbalet e marrjes në dorëzim nuk pasqyrojnë verifikimin e plotë të specifikimeve teknike, si marka, lloji dhe brendi i pajisjeve.

Për Procedurën “Licenca software për server”:

Për këtë procedurë, nga K.B.V.V. është shpallur fitues operatori ekonomik “A.I” në vlerën 720,000 lekë. Nga auditimi rezultoi se: Në përbërje të K.B.V.V.-së nuk është përfshirë specialist i fushës së IT-së, në kundërshtim me nenin 74, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Gjithashtu, mungon argumentimi për vendosjen e kriterëve të kualifikimit për operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Ofertat e operatorëve ekonomikë, të përdorura për përllogaritjen e fondit limit, nuk përcaktojnë versionin e “Windows Server” për të cilin do të realizohet përditësimi me licencën përkatëse, çka tregon se oferta financiare është hartuar në mungesë të specifikimeve teknike të qarta.

Në lidhje me plotësimin e kriterëve të veçanta, rezulton se diploma e z. D.T është në fushën e inxhinierisë elektronike dhe komunikimit dixhital dhe jo në fushën e IT-së, në kundërshtim me kërkesat e autoritetit kontraktor të përcaktuara në ftesën për ofertë. Po ashtu, nuk plotësohet kriteri për disponimin e gjithsej 4 specialistëve IT, pasi në dokumentacionin e paraqitur dhe atë të ngarkuar në SEP evidentohen vetëm 2 specialistë IT, ku njëri prej tyre, sipas auditimit, nuk përmbush kriterin e kërkuar në bazë të diplomës bachelor dhe master.

Në këto kushte, operatori ekonomik “A.I” duhej të ishte skualifikuar nga K.B.V.V. për mosplotësim të kriterëve të veçanta të përcaktuara në ftesën për ofertë.

Për procedurën “Materiale Pastrimi” (2025)

Për këtë procedurë, nga K.B.V.V. është shpallur fitues operatori ekonomik “E.D.D” në vlerën prej 155,100 lekë. Nga auditimi rezultoi se:

Autoriteti kontraktor, në ftesën për ofertë, ka kërkuar cilësi të lartë të produkteve, por pa përcaktuar kriterë të veçanta dhe pa kërkuar paraqitjen e dokumenteve provuese për garantimin e cilësisë (certifikata cilësie), duke krijuar paqartësi në procesin e vlerësimit të ofertave.

Gjithashtu, në përbërje të komisionit të marrjes në dorëzim nuk është përfshirë punonjësi me përgjegjësi materiale, në kundërshtim me pikën 43 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Në vijim, konstatohet se mungon fleta e hyrjes së mallrave e nënshkruar nga punonjësi me përgjegjësi materiale.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr.50-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1.Rekomandimi: Titullari i Institucionit të Entit Rregullator të Ujit, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, të rishikojë dhe të standardizojë procedurat e brendshme të planifikimit të nevojave dhe të zhvillimit të procedurave të prokurimit, duke siguruar që kërkesat për blerje të inicohen nga strukturat përkatëse dhe specialistët e fushës, specifikimet teknike të hartohen në mënyrë të plotë, të argumentuar dhe në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore në fushën e prokurimeve publike, studimi i tregut të kryhet mbi oferta të bazuara në specifikime teknike të miratuara.

Në vijimësi

17.2.Rekomandimi:

Titullari i Enti Rregullator të Ujit të marrë masa që Komisioni i Blerjeve me Vlerë të Vogël të ketë në përbërje të paktën një anëtar specialist të fushës, komisioni i marrjes në dorëzim të përfshijë detyrimisht punonjësin me përgjegjësi materiale dhe një specialist të fushës, si dhe

dokumentacioni i marrjes në dorëzim të pasqyrojë në mënyrë të plotë verifikimin real të përputhshmërisë së mallrave dhe shërbimeve me specifikimet teknike, me qëllim forcimin e kontrollit të brendshëm dhe garantimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së proceseve të prokurimit.

Në vijimësi

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË REZULTOIRA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi zbatimit të dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, në lidhje me dokumentacionin shoqërues dhe praktikës së pagesës së dietave brenda vendit rezultoi se:

Në të gjitha urdhërat e pagesës për stafin e ERRU, që kanë përfituar trajtim financiar për shërbime jashtë qendrës së punës brenda vendit, mungonte autorizimi përkatës i titullarit të institucionit, ku duhej të përcaktohej koha e zgjatjes së shërbimit dhe qëllimi i tij.

Ky veprim është në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar, pika V, germa a.ii). Gjithashtu, sipas Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 12, pika 3. Në rastin konkret, nëpunësit zbatues kanë pranuar dhe urdhëruar pagesat pa dokumentacion të plotë dhe të autorizuar sipas VKM nr. 997, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar.

Vlera totale 1,374,655 lekë përbën përdorim të fondeve të ERRU pa efektivitet, duke mos respektuar parimet e përdorimit me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqet nr.42-45 të Raportit të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Titullari i ERRU, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, të sigurojë që çdo praktikë shërbimi dhe pagesë përkatëse të mbështetet në dokumentacion të plotë dhe të rregullt ligjor, përfshirë autorizimin e titullarit, programin e punës të miratuar paraprakisht, duke realizuar pagesat për dieta dhe transport brenda vendit vetëm në llogaritë bankare të personave përfitues përkatës, si dhe të analizojë shkaqet dhe të nxjerrë përgjegjësitë për përdorimin pa efektivitet dhe pa efikasitet të fondeve publike në shumën 1,374,655 lekë.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

C.1. PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE

C. 1.1. Për punonjësit marrëdhëniet e punës të cilëve rregullohen me Kodin e Punës:

Bazuar në Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe kontratën individuale dhe kolektive të punës, pasi të jetë shqyrtuar dhe vlerësuar shkeljet e evidentuar dhe të jenë identifikuar përgjegjësit në lidhje me këto shkelje, kërkojmë fillimin e dhënies së masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna” për të gjithë punonjësit e rezultuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

C.1.2 Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i

ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Entit Rregullator të Ujit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse nga “vërejtje” deri në “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës, për një periudhë deri në dy vjet”.

C2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish-punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre.

C.3. NJOFTIM I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit që janë rekomanduar masat disiplinore, Enti Rregullator i Ujit, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.